E martë, 25 mars 2025

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Për procesverbal të akuzuarit janë në sallë sot.

Përpara se fusim dëshmitarin në sallë ka disa çështje të cilat kanë nevojë të diskutohen sot. Një çështje faktikisht. Ka diçka për të thënë për dëshmitarin javën e ardhshme?

Z. PACE: [Përkthim] E di që kolegët kanë bërë pyetjet përkatëse dhe informacioni përkatës do t'i komunikohet Trupit Gjykues dhe ekipeve të Mbrojtjes sot paradite.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Atëherë jemi gati për të vijuar me seancën. Mund të futni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Maloku.

DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pas pak, z. Maloku, do të vijojmë, por edhe një herë dua t'ju rikujtoj që përpiquni pyetjeve t'u përgjigjeni qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkoni atij që ua bën pyetjen t'jua përsërisë ose na thoni që nuk e kuptoni dhe do t'ua sqarojmë pyetjen. Përpiquni të na shpjegoni se nga i dini faktet dhe rrethanat për të cilat do ju bëhen pyetje.

Ju lutem flisni afër mikrofonit, siç keni vepruar dje dhe prisni pesë sekonda përpara se t'i përgjigjeni pyetjes dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju arrijnë përkthyesit.

Edhe një herë, nëse dikush jashtë kësaj sallë ju bën pyetje se çfarë diskutohet këtu në këtë sallë për dëshminë tuaj, ju lutem na e bëni me dije.

Nëse keni nevojë për ndonjë pushim, na thoni dhe do ta organizojmë.

Do të vijojmë tani me pyetjet që do t'jua bëjë Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Z. Pace, keni fjalën.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

DËSHMITARI: NAIM MALOKU [Vijon]

Pyetje nga z. Pace: [Vazhdim]

Z. PACE: [Përkthim]

PY. Mirëdita, Dëshmitar.

PË. Mirëdita.

Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj të nxjerrim në ekran dokumentin U009-1711-U009-1740 krahas me përkthimin në anglisht që ka të njëjtin numër elektronik dhe të shohim faqet U009-1720 në të dy versionet. Siç e përmenda edhe dje, ndërkohë që jemi në seancë të hapur, dokumentet që unë kërkoj të shfaqen në kompjuter mund të transmetohen dhe për publikun. Kjo është faqja e saktë në shqip, po për anglishten të shkojmë në faqen e duhur që është 1720.

PY. Dëshmitar, njësoj si dje, në të majtë shihni dokumentin në shqip i shkruar me shkrim dore, në të djathtë është përkthimi në anglisht. Ju lutem t'i hidhni një sy shumë shpejt.

Z. PACE: [Përkthim] Tani do t'i kërkoj Sekretarit të na kalojë në faqen tjetër në të dy versionet, pra, 1721.

PY. Dëshmitar, kjo është faqja e dytë e materialit.

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen tjetër, 1722, në të dy versionet. Dhe shumë shkurt dhe në faqen tjetër 1723, në të dy versionet. Tani të kthehemi në faqen që pamë në fillim 1720, në të dy versionet.

PY. Dëshmitar, përpara se t'ua tregoja javën që shkoi a e kishit parë më përpara këtë dokument?

PË. Jo.

PY. Shohim se përmend një takim më datë 30 janar 1999 në Jabllanicë, ku këtu shkruhet që keni marrë pjesë edhe ju bashkë me personat e renditur këtu. A ju kujtohet një takim i

tillë?

PË. Z. Prokuror, ky procesverbal paraqet një takim timin në fshatin Jabllanicë, gjegjësisht në Togën 2. Unë e njof komandantin e togës edhe sot. Ka qenë një djalë i mirë nga Peja, një ushtar i mirë. Por më lejoni t'ju them juve edhe Gjykatës që këso procesverbaleve ju keni mund me gjet me qindra se nuk ka pas njësit, nuk pas togë në Zonën Operative të Dukagjinit që unë nuk kam qenë mu për këtë qëllim që shkruhet në këtë procesverbal - kontrollimin e ushtarëve, këshillimin, përgatitjen, aftësimin e tyre. Se qatë punë unë kam pas edhe për këtë qëllim kam shku në Kosovë, për me i aftësu ushtarët, me këshillu, me i aftësu për me luftu, me luftu me ta dhe pastaj me komandu me ta. Për këtë kam shku. Ky dokument për paraqet angazhim tim faktik dhe është e vërtetë se këtë punë unë e kam bë dhe për këtë punë kam shku.

Gati të gjithë këta, këta persona këtu, unë i njof. I kam njof. Por po ju them prapë edhe Gjykatës, mundni me gjet ndoshta nëse janë mbajt procesverbale të vizitave të tilla të mia që i kam bë nëpër krejt Zonën Operative të Dukagjinit. Ju mundni me gjet me qindra dhe mijëra. Nuk po them mijëra, me qindra. A e kupton?

PY. Dëshmitar edhe një herë, ajo që thoni ju vlen, por dua t'ju lutem t'i përgjigjeni vetëm pyetjes. Po t'ju kërkoj informacione të tjera mund t'i thoni ato.

Tani edhe një herë, këtu përmendet Maliq Ndreca, Lulzim

Morina dhe Nazmi Brahimaj në këtë takim. A ju kujtohet që kanë qenë aty?

PË. Po Maliqi ka qenë komandant i kësaj brigade. Toga ka qenë në kuadër të brigadës së Maliq Ndrecës dhe sigurisht ka qenë aty.

PY. Lulzim Morina dhe Nazmi Brahimaj a ndodheshin në atë takim, me aq sa ju kujtohet?

PË. Lulzim Morina ka qenë ushtar i gjeneratës së parë që e kemi aftësue në Qerret në 1998. Atë e kam njoft prej atëherë.

PY. Jo, pyetja është kjo: A ishte i pranishëm në këtë takim, në këtë mbledhje?

PË. Po nëse shkrun këtu, me siguri ka qenë.

PY. A ju kujtohet që të ketë qenë i pranishëm në mbledhje?

PË. Shumë ushtarë kanë qenë, z. Prokuror. Unë s'mundem saktësisht me e dit cili ushtar ka qenë, por nëse ky procesverbal e paraqet gjendjen faktike, atëherë është ashtu, ka qenë këtu. Po.

Z. PACE: [Përkthim] Ta largojmë pak faqen në shqip që të shohim edhe pikën numër 8.

PY. Dëshmitar, nga 1 tek 8 janë emrat, mbiemrat dhe pozitat. Me aq sa ju kujtohet juve, pozitat e personave të renditur nga pika 1 deri në pikën 8 a janë të saktë apo të pasakta? Për janarin e 1999?

PË. Në bazë të faktit që në numrin 7 "Naim Maloku eprori" është shkrimi im, është dorëshkrimi im, do të thotë, është

mbajte një listë në të cilën jemi nënshkru të gjithë. S'di a po më kuptoni? Pra, kjo vërteton për faktin se shkrimi është i imi "Naim Maloku epror" është shkrimi im këtu. Në bazë të kësaj, unë konkludoj që kanë qenë të gjithë ata që jemi nënshkru aty prezent.

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, me numër 1721.

PY. Këtu diku nga mesi, shohim, të paktën në anglisht, thotë:

"/Num/ M dhe L urdhëruan që në të ardhmen ushtarët duhet të jenë në katërshe kur bëjnë roje dhe patrullim dhe armët - se ka edhe pjesë që nuk lexohen – armët duhet që të bëhen për të gjithë brigadën. /?/ – Unë nuk jam në gjendje të bëj asgjë lidhur mbrojtjen territoriale."

Dëshmitar, a ju kujtohet kush e ka thënë këtë për ushtarët, që ka dhënë këtë urdhër për ushtarët në të ardhmen që të jenë në katërshe?

PË. Besoj që unë e kam dhënë, këshilla ime ka qenë. Rojet i kem bë në katërshe, ndërsa skuadrat i kemi organizu në pesëshe, jo ma shumë.

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen 1723 në të dy versionet.

PY. Dëshmitar, këtu shohim që të përmendet se:

"Procesverbal është mbajtur nga Ajshe Mulaj."

A e njihni Ajshe Mulën?

PË. Unë i kam njoft disa vajza në Ushtrinë Çlirimtare të

Kosovës në Dukagjin.

PY. Ajshe Mulaj ishte mes këtyre vajzave të UÇK-së, mesa ju kujtohet?

PË. Po, ka qenë. Po.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të pranohen në provë gjyqësore faqet e shfaqura në ekran që nga ky material janë me numër U009-1720 deri në 1723.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtim?

Z. DIXON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me U009-1720 deri 1723 pranohen.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Marrin numrin e provës materiale P02097. Ai tani është konfidencial.

Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Riklasifikoheni si publike, ju lutem.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Patjetër.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument dhe në vend të këtij dëshirojmë që të nxjerrim dokumentin numër U001-5634 deri në 5683 bashkë me përkthimin në anglisht që kanë të njëjtin numër me shtojcën -ET *Revised* në fund. Dua që të nxjerrim në ekran faqen me numër U001-5666 në të dy versionet, ju lutem.

Faleminderit.

PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër, majtas në shqip me shkrim dore, djathtas është përkthimi në anglisht.

Z. PACE: [Përkthim] Përpara se t'ju bëj pyetje dua që t'i kërkoj Sekretarit të na tregojë dhe faqen tjetër në të dy versionet me numër 5667. Dhe faqen tjetër, 5668. Dhe faqen tjetër, 5669. Dhe rikthehemi në 5666.

PY. Dëshmitar, këtë dokument përpara se t'ua tregoja javën që shkoi e kishit parë?

PË. Jo.

PY. Këtu në faqen ku jemi tani përmendet një mbledhje, një takim i 30 janarit 1999, ku përmendet këtu se keni marrë pjesë dhe ju krahas disa personave të tjerë përfshirë Lulzim -- Maliq Ndrecaj, Lulzim Morina dhe Nazmi Brahimaj. Ju kujtohet që, domethënë, mesa ju kujtohet juve bëhet fjalë për të njëjtën mbledhje për të cilën sapo folëm apo është ndonjë takim tjetër?

PË. Unë kam bë mbledhje, kam bë këshillime dhe mbledhje të tilla çdo ditë. Nuk më kujtohet saktë. Por nga përmbajtja e këtij procesverbali apo raporti, unë i identifikoj fjalët e mia aty se puna ime ka qenë ajo.

Z. PACE: [Përkthim] Të shohim pjesën e poshtme të kësaj faqeje, pra, në fund në gjuhën shqipe, po edhe kështu në atë në anglisht. Është mirë kështu siç është.

PY. Dëshmitar, këtu shohim fjalët që:

"Naim Maloku në fillim u interesua për t'u njohur me

secilin komandant toge dhe për numrin e tyre."

A ju kujtohet ta keni kërkuar këtë informacion kur jeni takuar në janar të 1999 në zonën e Dukagjinit në këtë mbledhje?

PË. Në çdo takim kam kërku të njifem me pjesëmarrësit në takim, pozitën që e kryejnë, rolin që e kryejnë dhe numrin e ushtarëve që i kanë. Kjo është.

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, ju lutem, në të dy versionet me numër 5667, të shohim pjesën e poshtme në të majtë në të dy versionet. Po. Faleminderit. Në shqip është në rregull. Mirë është dhe në anglisht.

PY. Dëshmitar, këtu shohim fjalët:

"Naim Maloku shpjegoi se armatimet duhet të bëhen, duhet të kombinohen nëpër pika se një ushtar nuk duhet që të mbajë tre armë."

A ju kujtohet që ta keni thënë këtë në këtë takim të janarit të 1999?

PË. Po.

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen U001-5663 në të dy versionet. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër nga i njëjti material por është një regjistrim më vete.

Z. PACE: [Përkthim] Po të shohim në shqip në anën e majtë pjesën e sipërme.

PY. Shohim se kemi datën 25 janar 1999.

Z. PACE: [Përkthim] Dhe në anën e djathtë të të dyja faqeve të të dy versioneve.

PY. Në paragrafin e dytë këtu lexojmë:

"Naim Maloku nga Shtabi i Përgjithshëm ka ardhur para dy ditësh për të na ndihmuar me çështjet organizative."

Dëshmitar, ky dokument mban datën 25 janar 1999 dhe sipas tij ju keni mbërrit nga Shtabi i Përgjithshëm para dy ditësh, domethënë, 23 janar 1999. A ju kujtohet që është e saktë kjo?

PË. E saktë është ajo, po.

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë tani në faqen U001-5671 në të dy versionet, ju lutem.

PY. Këtu shohim një regjistrim të datës 11 shkurt 1999, ku përmendet një takim. Përmendet një takim me komandantët e brigadave, ku përmendet se i pranishëm është dhe Ramush Haradinaj.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër në të dy versionet, me numër 5672. Dhe në të dy versionet të shohim pjesën e poshtme të faqes së majtë, në të dy versionet, ju lutem.

PY. Këtu shohim:

"Naim Maloku ka ardhur ndihmës në zonën tonë dhe për ne është një privilegj sepse ka rëndësi të veçantë për neve."

Ju kujtohet, Dëshmitar, kush i ka thënë këto fjalë në këtë takim?

PË. I ka thënë Ramush Haradinaj. Se ai më ka prezantu me

përfaqësuesit e brigadave që ishin aty, por edhe atyne të ftuarve nga fshatrat të cilat ende nuk ishin në kontroll të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por mendonim me zhvillu njësite edhe në ato fshatra, për shembull, Lugu i Trestenikut i thom ne. Andej, do të thotë, ka Tresteniku nuk kishte, nuk kishte njësi, njësi dhe nuk kishte pika, nuk kishte zona të vogla të kontrollit dhe mendonim me i aktivizu dhe atje.

Është prezantim i im para stafit të Zonës Operative të Dukagjinit.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim anën e djathtë në të dy versionet pjesën e sipërme.

PY. Këtu, Dëshmitar, shohim se shkruhet:

"Shaban Hasanaj gjithashtu punon për rregullimin e pozicioneve të luftës. Mendojmë se është personi i duhur për të vazhduar punët rreth fortifikimeve."

Ju kujtohet nëse Shaban Hasanaj po kryente këtë punë asokohe?

PË. Z. Prokuror, më kujtohet që me Shaban Hasanaj u takova një ditë më parë. Ai kishte qenë nji burrë goxha i moshuar, mirëpo që kishte pas përvojë shumë të madhe me Mbrojtjen Territoriale të komunës së Klinës. Kishte qenë epror i lartë. Dhe unë e kërkova që ai të kyçet me mu se mundet me qenë ndihmë e madhe e ekipit tim për të inspektu krejt Zonën Operative të Dukagjinit. Dhe mund t'ju them që ai nuk më është nda mu më. Do të thotë, kemi qenë bashkë ekip. Unë, Shaban

Hasanaj edhe pastaj pat ardh edhe një Gzim Ozdreni nga Maqedonia. Na tre kemi qenë pastaj. Po Shabani është kyç me propozimin tim aty në ekipin tim. Po.

Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen tjetër me numër U001-5673, në të dy versionet. Këtu shkurtimisht edhe faqen tjetër 5674, për të parë se ku mbaron ky regjistrim. Kthehemi në faqen e mëparshme, 5673.

PY. Dëshmitar, këtu shohim një regjistrim.

Z. PACE: [Përkthim] Në djathtë është siç shkruhet.

PY. Pra, shohim një takim që i referohet datës 15 shkurt 1999. Dhe këtu shohim, pra, në paragrafin e tretë.

"Vazhdojmë të punojmë për fortifikimin e pozicioneve të frontit çdo ditë ku eprorët Shaban Hasanaj dhe Naim Maloku po bëjnë, kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm."

Pra, ju kujtohet që ju dhe Shaban Hasanaj keni bërë këtë punë të kësaj natyre siç shkruhet këtu?

PË. Z. Prokuror, kur ma keni prezantu këtë dokument, unë e kam pranu që ky sigurisht paraqiste një përmbledhje të angazhimeve për një periudhë jo vetëm për një ditë, po për një periudhë të gjatë kohore. Dhe këto janë angazhimet që unë i kam pas në atë periudhë me z. Shaban Hasanaj derisa më ka ardh edhe Gzim Ozdreni edhe më u është kyç.

PY. Dhe që të jemi të qartë, kur flisni që ua kanë treguar këto dokumente, e keni fjalën për seancën përgatitore që bëmë javën që shkoi?

PË. Po, se unë i kam pa këto dokumente përpara.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kërkojmë që të pranohen në prova gjyqësore faqet që treguam me këto numra: U001-5663, U001-5666, 5667, 5668, 5669 dhe U001-5671, 5672, 5673, 5674. Klasifikimi i tyre mund të jetë publik nëse pranohen provat gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtim?

PËRKTHYESI: Avokatët jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqet e përmendura me numër do të pranohen në prova gjyqësore dhe do të marrin numrin e provës materiale.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Numrat që u lexuan për procesverbal së bashku me përkthimin përkatës në anglisht, do të marrin numrin e provës materiale P02098, të klasifikuara publike. Faleminderit.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument dhe të nxjerrim tani dokumentin me numër U002-2210 deri në U002-2223 krah për krahë me përkthimin në anglisht, që ka numrin U002-2210 deri në U002-2219-ET. Në të dy versionet të shohim faqen me numër U002-2217. Shohim faqen që mbaron me numrin 2217 në të dy versionet, ju lutem. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, ky është një tjetër material. Në të majtë është në shqip i shkruar me shkrim dore, djathtas në anglisht. Përpara se t'jua tregoja javën që shkoi e kishit parë këtë

dokument?

PË. Jo, Prokuror.

PY. Këtu shohim se përmend një mbledhje të zhvilluar më 30 të një muaji të caktuar të vitit 1999 dhe këtu shohim se përmendet emri juaj si epror krahas Maliq Ndrecajt e të tjerëve. Pyetja që kam është kjo: Nëse shohim informacionin e renditur nga pikat 1 deri në 7.

Z. PACE: [Përkthim] Kështu që t'i zmadhojmë pak 1 deri 7. Në mënyrë që të shihen totalisht.

PY. Ju kujtohet që këtë informacion ta ketë dhënë dikush në këtë mbledhje të vitit 1999?

PË. Mu nuk më kujtohet që dikush ta ketë dhënë këtë informacion. Po këto shtatë pikat që referohen që unë kam fol janë të sakta. Posaçërisht, kjo pika, pika 5, "Ndalohet çdo qitje e paarsyeshme". Kam qenë tepër, tepër kërkues që të mos harxhohet municioni kot. Edhe këto janë, këto janë shtatë pika ato kryesoret me të cilat unë kam shku në çdo, në çdo njësit të cilin unë e kam vizitu në kuadër të mandatit që unë e kam pas.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e kësaj faqeje në të dyja gjuhët. Klasifikimi mund të jetë publik. Pra, për sqarim, bëhet fjalë për faqen U002-2217.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Atëherë materiali U002-2217 pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë numrin e provës P02099 bashkë me përkthimin në gjuhën angleze. Dhe aktualisht klasifikimin e ka konfidencial.

Z. PACE: [Përkthim] Mund të ketë klasifikim publik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Riklasifikoheni.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Patjetër.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani dhe të vendosim U001-6143-U001-6148 dhe përkthimin në gjuhën angleze i cili mban të njëjtin numër po përfundon me -ET në fund. Dhe të shohim faqen e parë në të dyja versionet. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër, në të majtë shqipja, në të djathtë anglishtja. Përpara se t'ua tregoja unë javën e kaluar a e kishit parë ndonjëherë këtë dokument?

PË. Jo, Prokuror.

PY. Faqja që po shohim ne thotë Ushtria Çlirimtare e Kosovës komanda e Zonës Operative të Dukagjinit shërbimi logjistikës.

Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë ju lutem në faqen tjetër në të dyja versionet, është faqja që përfundon me numrin 6147. Në të dyja versionet dua që të zmadhohet pjesa e sipërme.

PY. Këtu shohim "Dëftesë në bazë të planit për financim", titulli. Ju lutem, Dëshmitar, shikoni emrin e pestë që shohim në këtë listë, këtu përmendet Naim Maloku epror ka marrë një mijë marka gjermane edhe është dhe nënshkrimi përkues.

Nënshkrimi përbri emrit tuaj a është i juaji në fakt?

PË. Po. Po, Prokuror.

PY. Ju kujtohet që të keni marrë vërtetë një mijë, rreth një mijë marka gjermane në janar? Poshtë emrit tuaj shohim Agron Ramaj?

PË. Po.

PY. Mesa ju kujtohet ju, a ka qenë Agron Ramaj në Brigadën 134 në janar 1999?

PË. Është vra pas dy dite, po. Po. Dhe ka qenë komandant brigade. Pastaj unë e kam ngrit, e kam ringrit atë brigadë. Ju kam spjegu dje në Ratishë. Nëse ka nevojë për shpjegime shtesë pse a kjo dëftesë kështu, unë e jap.

PY. Jo, faleminderit.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e materialit dhe klasifikimi mund të jetë publik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Z. DIXON: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni të pranohen të dyja faqet?

Z. PACE: [Përkthim] Po ky është një material me pesë faqe, kështu që nëse mund të pranohet i gjithi do të ishte më mirë. Bëhet fjalë për materialin që ka faqet 6143-6148 bashkë me anglishten.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, U001-

6143-6148 pranohen.

Z. PACE: [Përkthim] Që të jem dhe i qartë, unë kërkoj të pranohet i gjithë materiali. Po këto janë faqet që i tregova dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ka kundërshtime që të pranohet i gjithë materiali.

PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk shprehin kundërshtime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Materiali U001-6143-U001-6148 pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë numrin P02100, bashkë me përkthimin në gjuhën angleze dhe klasifikimi është publik.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin. Dhe të nxjerrim në ekran U001-4030-U001-4068 përbri me përkthimin në gjuhën angleze, që ka numrin U001-4032-U001-4068-ET. Dhe të shohim faqen 4068 në të dyja gjuhët. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër. Si zakonisht në të majtë shqipja, në të djathtë anglishtja. E njëjta pyetje, këtë dokument përpara se t'ua tregoja unë a e kishit parë ndonjëherë?

PË. Jo, Prokuror.

PY. Këtu flitet për një takim pune më 11 prill të 1999 ku pasur -- ndër pjesëmarrësit keni qenë ju, Major, Emrushi, Nazmiri dhe anëtarë të Brigadës 133. Në fjalinë e tretë thuhet

që ju keni thënë që do të ketë zbatim të linjës së dytë dhe të tretë të Mbrojtjes. A ju kujtohet një takim i tillë?

PË. Po, tani veç isha në Brigadën 133 në të cilën komandonte Azem Veseli. Tani mu kishte bashkangjit edhe Gëzim Ozdreni që dikun ju mund të gjeni me pseudonim Murati, diku Majori. Pra nuk është identifiku me emër për shkak se vinte nga Maqedonia, tash i thuhet Republika e Maqedonisë Veriore. Do të thotë, për mos me rreziku familjen e tij, atje ky merrte emra të ndryshëm dhe kudo që do shkoja e prezantoja me ndonjë pseudonim tjetër.

Ky takim pune është i saktë. Dhe më kujtohet që u bë takimi pasi që i kam vizitu disa pozicione të mbrojtjes se disa njësive të Brigadës 133, nuk kishin pas të rregulluara pozicionet e dyta rezervë dhe të treta ashtu siç kërkon rregulli në luftë. Edhe kjo është vërejtja ime që unë më kujtohet që e kam dhënë në atë takim pune me stafin e ngushtë të Brigadës 133. Dhe më kujtohet që ky takim pune u mbajt në Studenicë se aty ka qenë shtabi i brigadës.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen 4032 në të dyja versionet. Duhet të jetë faqja e parë tek anglishtja. Kjo.

PY. Dëshmitar, ju lutem, shihni pak emrat në të majtë të ekranit dhe vendlindjet që janë në kolonën e tretë.

Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë pak më poshtë, ju lutem.

Para se t'ju bëj pyetjen dua të shohim edhe faqen U001-4044 në të dyja versionet.

PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër po pjesë e të

njëjtit material. Edhe në herë shikoni emrat, ju lutem, shikoni dhe rreshtin e fundit që thotë "Data dhe vendi i pranimit në UÇK". A njihni ndonjë prej emrave dhe vendeve në faqet që sapo pamë?

PË. Vendet i njoh të gjitha. Emrat shumë prej tyne po. Unë e kam vërejt që Brigada 133 kishte mbajt një regjistër pak sa ma preciz dhe të saktë të të gjithë pjesëtarëve të brigadës, pra, ku ishte emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, data dhe vendi kur është kyç në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës edhe përgatitja shkollore e tyne. Ky ishte një regjistër i sistemu mirë. Më kujtohet që edhe e kam lavdërue komandantin e brigadës për mbajtjen e kësaj evidence. Po unë nuk e kam dit para se të ma tregoni ju që e keni në dispozicion të materialeve të juaja.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e faqeve U001-4032 deri në faqen U001-4066 ku përfshihet dhe faqja që e pamë me dëshmitarin, përfshihen faqet me listën e emrave edhe listat të ngjashme me listat që sapo pamë. Dhe klasifikimi mund të jetë publik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali U001-4032 deri në 4068 pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë

numrin e provës materiale P02101 dhe klasifikimi është publik.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Mund ta heqim nga ekrani dokumentin.

PY. Dëshmitar, a e njihni Faton Mehmetajn?

PË. Po.

PY. Mesa keni ju dijeni, a ka pasur ndonjë rol ai në UÇK në 1998 dhe 1999?

PË. Sa unë e di, Faton Mehmetaj ka qenë epror ose përgjegjës i sektorit të ashtuquajtur zbulim-kundërzbulim nga Zona Operative të Dukagjinit. Më duket sa unë kam dëgju për që atij i ka ndihmu dhe Fitnete Ramosaj pra. Ata të dy merreshin, diheshin nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që e kanë atë funksion.

PY. Kur keni qenë në Zonën Operative të Dukagjinit në 1999, a e ke parë ndonjëherë, a jeni shkëmbyer ndonjëherë në atë kohë?

PË. Disa herë e kam pa ose shkëmby nëpër rrugë. Por që të kam marrë pjesë në ndonjë takim ku ai ka qenë prezent, nuk më kujtohet kurrë. S'ka ndodhë.

Z. PACE: [Përkthim] Dua të shohim në ekran librin e dëshmitarit. Bëhet fjalë për materialin U002-3041-U002-3134 dhe përkthimin në anglisht që gjendet në materialin me numër U002-3080-U002-3141-ET. Dhe të shohim faqen që përfundon me numër 3110 dhe përndryshe është 70 në PDF në shqip dhe 31 në anglisht.

Jo, nuk është faqja e saktë në anglisht. Dhe një herë, ju

lutem, ju dhashë një numër tjetër, është materiali që ka numrin U002-3080. Faleminderit. Mesa duket e kisha unë gabim.

Shohim faqen 70, ju lutem, në PDF në shqip, ndërsa në anglisht faqen 31 në PDF.

PY. Do ju lexoj paragrafin e tretë dhe të katërt tek anglishtja që do jetë dhe paragrafi i tretë dhe katër në të majtë të shqipes.

Z. PACE: [Përkthim] Kështu që ta zmadhojmë pak shqipen.

PY. Dëshmitar, po lexoj dhe pastaj do t'ju bëj pyetjet.

"Unë mora urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së që të shkoj nga Istogu në Rugovë dhe pastaj të dal në Shqipëri. Unë dhe Gzim Ozdreni, që ishte një major nga Dibra e Madhe, morëm urdhrin të shkonim në Shqipëri. Paraprakisht SHP-ja e UÇK-së kishte shpallur mobilizimin e përgjithshëm të diasporës. Nga SHP-ja e UÇK-së na thanë se duhet të shkonim atje. Kur ma dha këtë urdhër Bislim Zyrapi në SHP të UÇK-së ishte dhe Agim Çeku, i cili kishte ardhur nga Kroacia. Ky urdhër më ishte dhënë nga se unë duhet të shkoja në Shqipëri të mblidhja njësi vullnetare që kishin ardhur nëpër kampe dhe të udhëheqja me njësitë në vazhdimin e Operacionit Shigjeta. Ky operacion parashihte post Koshares, thyerjen e kufirit në Pashtrik dhe në Dragash, pra, në tri vende.

"Kosharja kishte rëndësi të posaçme dhe psikologjike për gjithë UÇK-në në Kosovë. Synimi ishte lidhja e Koshares me Rrafshin e Dukagjinit, futja e armatimit nga Shqipëria dhe

futja e forcave të reja që ishin nëpër kampe të Shqipërisë (flitej për 7000, 8000 vullnetarë që kishin ardhur nga perëndimi).”

Besoj se këtë e keni përmendur dhe dje këtë ngjarje?

PË. Po.

PY. Tani unë kam këtë pyetje: A ju kujtohet ta ketë dhënë këtë urdhër Bislim Zyrapi që të shkoje në Rugovë dhe më pas në Shqipëri?

PË. Po, e kam marrë me telefon. Urdhri mu ka dhënë me telefon kur kam qenë në shtabin e Brigadës 133 në Studenicë.

PY. Tek fragmenti që lexuam thuhet kur ma dha këtë urdhër Bislim Zyrapi në SHP-në e UÇK-së ishte dhe Agim Çeku. Ai ishte fizikisht e keni fjalën në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së?

PË. Po, ishte fizikisht se Bislimi ma komunikoi edhe ndryshimin me Shtabin e Përgjithshëm, pra, në vend të Bislim Zyrapit ishte vendos Agim Çeku për shef shtabi. Ndërsa Bislimi kishte marrë detyrën që të komandon me Operacionin Shigjeta nga Kukësi, nga Shqipëria.

PY. Po Agim Çeku a ka qenë në këtë thirrje telefonike apo keni qenë vetëm ju dhe Bislim Zyrapi?

PË. Agim Çeku ka kërku që të bisedon me mu. Jemi përshëndet normalisht me ato fjalët respektuese për njëni-tjetrin. Unë isha i gëzum që kish ardh ai. Kaq, do të thotë. Po jemi përshëndet dhe jemi, kemi këmbyer fjalë respekti njëni për tjetrin. Po.

PY. Që ta sqarojmë, u përshëndetët gjatë kohës që u bë kjo thirrje telefonike kur të dha Bislim Zyrapi këto urdhrat?

PË. Po.

PY. Në këtë libër ju flisni për 7000, 8000 vullnetarë. A e dini ku ishin ata asokohe?

PË. Ishin në Burrel.

Z. PACE: [Përkthim] E heqim dokumentin nga ekrani, ju lutem.

PY. Në intervistën për ZPS-në keni thënë se keni qenë në Gjakovë rreth 15, 16 qershorit të 1999 pasi kishit qenë në Kukës dhe para se të shkonit në Pejë. A ju kujtohet ku keni qëndruar në Gjakovë në këtë periudhë kohore?

PË. Kam qëndruar në një dhomë në hotelin Pashtrik.

PY. A e mbani mend nëse ka pasur anëtarë të tjerë të UÇK-së në hotelin Pashtrik në qershor të 1999?

PË. Po, ka pas. Gati të gjitha dhomat kanë qenë të zënuna për shkak se përballë hotelit Pashtrik u vendos, ka qenë një shtëpi e kulturës aty, u vendos shtabi i Brigadës 137 Rugova - - Gjakova. Komandant i së cilës ishte Avdullah Babalija.

PY. Do ndryshoj temë tani. A njihni një person me emrin Shpëtim Golemi?

PË. Po, është Dilaver Goxhaj.

PY. A e kuptoj saktë unë që Dilaver Goxhaj është emri i vërtetë i Shpëtim Golemit?

PË. Është emri i vërtetë.

PY. Mesa dini ju, ky person a kishte ndonjë rol në UÇK në 1999?

PË. Ai ka ardh kur është vendos Agim Çeku për shef shtabi. Dhe unë nuk di se çfarë roli ka pas Dilaver Goxhaj në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

PY. Po mesa dini ju në 1999 një rol e ka pasur në Shtabin e Përgjithshëm Shpëtimi apo Dilaveri?

PË. Shpëtimi ka mund me pas një rol, një rol të lartë në Shtabin e Përgjithshëm. Logjika ime thotë që ai u dasht të jetë diku në operativë, në drejtorinë operative për shkak se ka qenë oficer i profesionit, oficer i lartë ose siç themi ne në terminologjinë ushtarake oficer madhor.

PY. Po Safet Sylën a e njihni?

PË. Po. Ky ka qenë një oficer që kishte ardh gjatë sa isha unë në Shtab të Përgjithshëm nga Zvicra. Ka qenë i vetmi oficer në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që e ka pas të kryer akademinë e ndërlidhjeve, pra, që është marrë me radiolidhje dhe me të gjitha këto dhe ka dhënë -- kemi pas një, ka qenë një pasuni e madhe për drejtorinë operative ardhja e tij për shkak se ai e bënte edhe përgjimin e komunikimeve të forcave të armikut, forcave serbe atyne policore edhe ushtarake. Dhe përmes atij përgjimi ne mësonim shumëçka në lidhje me lëvizjet e tyre ose aksionet që ata donin t'i ndërmerrnin në ndonjë pjesë të Kosovës. Po. Kontributi i tij ka qenë i jashtëzakonshëm në drejtorinë

operative të Shtabit të Përgjithshëm.

PY. Në intervistën për ZPS-në keni thënë se keni bërë kërkesë me shkrim për demobilizim --

PË. Po.

PY. -- dhe se ke dorëzuar armën tënde dhe se Agim Çeku ta dha urdhrin për demobilizimin personalisht.

Z. PACE: [Përkthim] Tani shohim materialin 126674-126682 dhe përbri të vendoset dhe anglishtja që mban numrin 126674-126679-ET. Në të dyja versionet duhet të shohim faqen 126674, faqja e parë.

PY. Dëshmitar --

Z. PACE: [Përkthim] Fillimisht të zvogëlohet pak faqja që ta shohim të plotë shqipen. Kështu.

PY. Në të majtë është shqipja, në të djathtë është anglishtja. A ju kujtohet t'ia keni dhënë ju ZPS-së versionin në shqip?

PË. Po.

PY. Nënshkrimet në faqe a janë nënshkrimet tuaja?

PË. Po.

PY. Edhe në të djathtë edhe më poshtë që ka dhe datën?

PË. Po.

PY. A është kjo kërkesa juaj me shkrim për demobilizim?

PË. Po, kërkesa ime me shkrim është, ia kam dhënë Mensur Kasumit që erdhi për të më vizituar në Gjakovë për me e dërgu ai personalisht shefit të shtabit.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen 126677 në të dyja versionet. E zvogëlojmë pak shqipen që ta shohim të plotë.

PY. Dëshmitar, a e keni dhënë ju Prokurorisë këtë material?

PË. Po.

PY. A mund të na e shpjegoni shkurtimisht çfarë është ky material?

PË. Ky vërtetim që unë e dorëzova armën, numri i armës. Do të thotë, e kam bërë para marrjes së vendimit, urdhrit për demobilizim, për shkak se unë e ceku në dokumentin e mëparshëm që edhe nëse nuk e marrë urdhrin për demobilizim, do ta shfrytëzoj të drejtën time që si vullnetar që kam ardh edhe vullnetarisht me e lëshu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Dhe për atë e kam dorëzu armën më 25 qershor para se me më ardh zyrtarisht vendimi për demobilizim. Pra, i kam njoftu shefin e shtabit që edhe nëse marrë urdhëresë negative, unë do të shfrytëzojë të drejtën time që qysh kam hi si vullnetar ashtu edhe vullnetarisht do të dalë nga radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

PY. Shohim që ka një nënshkrim teksti, është nënshkrimi Avdullah Babalija komandant.

PË. Nënshkrimi i komandantit të brigadës. Unë atij ia dorëzova armën.

PY. Mesa ju kujtohet ju, a ka pasur komandant brigade përpara se ta merrte detyrën Avdullah Babalija?

PË. Jo. Ajo kur është kriju Brigada 137 Rugova -- Gjakova ai

është komandanti i parë dhe i fundit i tij se ka pas fatin që i ka mbijetu, do të thotë, se shumë, se shumë komandantë të brigadave i kemi humb në luftë.

PY. A njihni një person me emrin Agron Kryeziu?

PË. Po, ka qenë diçka në komandë të Brigadës 137, po nuk e di çfarë funksioni ka pas.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen 127676 në të dyja versionet, 6676 në të dyja versionet.

PY. Dëshmitar, në të majtë është shqipja. Ia keni dhënë ju Prokurorisë këtë material?

PË. Po.

PY. A është ky vendimi që të ka dhënë Agim Çeku që e ke përmendur lidhur me demobilizimin?

PË. Po, ma ka dhënë saktë me 1 korrik 1999 në Pejë.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e tre materialeve që i treguam dëshmitarit, më konkretisht, bëhet fjalë për materialet që fillojnë nga faqet 126674 deri në faqen 126677. Nëse pranohen klasifikimi mund të jetë publik dhe mund t'i bashkëngjiten provës materiale P02093 që është një provë që përmban një faqe të të njëjtit material.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Në rregull. Materiali 126674, 126677 pranohen, klasifikimi publik. Dhe do t'i bashkëngjiten provës P02093.

Z. PACE: [Përkthim] Ne për çështje plotësie do kërkonim

që të pranohej edhe një faqe tjetër në mënyrë që ta shikojmë materialin të plotë. Është thjesht faqja e fundit e të njëjtit tekst.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtim?

Në rregull. Atëherë pranojmë dhe materialin 126675 dhe të bëhet pjesë e të njëjtës provë materiale.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Mund t'i bashkëngjiten provës P02093.

Z. PACE: [Përkthim] Tani mund të bëjmë pushimin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, tani do të bëjmë dhjetë minuta pushim. Mund të dilni nga salla e gjyqit dhe do shihemi në 10.10 në sallën e gjyqit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim deri në orën 10.10.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.00

--- Seanca rifillon në orën 10.12

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fusni dëshmitarin në sallë, ju lutem.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Maloku, do të vazhdojmë me pyetjet nga Prokuroria.

Z. Pace, mund të vazhdoni.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Dëshmitar, do të lexoj nga intervista, intervistat që i keni dhënë TPNJ-së dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe do t'ju bëj disa pyetje.

Z. PACE: [Përkthim] Në fillim dëshiroj të shfaqim në ekran dokumentin me numër P02087.2-ET dhe AT dhe do të kthehemi, do të shohim faqen 18 në anglisht dhe faqen 14 në shqip. Në anglisht do lexoj në faqen 18, rreshtat 15 deri 19.

PY. Ndërsa në shqip, kjo është majtas, nëse doni ta ndiqni me të lexuar, është në faqen që është aty në rreshtin 1 deri në 8. Ose mund ta dëgjoni. Është një prej përgjigjeve që keni dhënë:

"Deri në korrik 1998, unë kam pas më së shumti kontakte me gazetarët. Disa intervista janë në librin tim; disa i kam në shtëpi. Intervistat -- disa prej intervistave të mia vijnë ndesh me zëdhënësin e UÇK-së, disa elemente shumë interesante. Për shembull, kur pyetem për Rugovën unë them që ai është kryetari i Kosovës dhe unë e njoh atë, autoritetin e tij. Këtë publikisht e kam thënë më 5 korrik 1998 dhe kur pyetem nga gazetari se kush sipas teje duhet të flasë në emër të UÇK-së, unë i përgjigjem: Rugova. Këto janë, këta kanë qenë do ndryshime, mirëpo, jo ndryshime që kanë mujt me qenë në raport me forcat policore ushtarake. Ne kemi luftu për me heq forcat policore ushtarake."

Tani dua që të shohim dokumentin me numër P0290.4-ET dhe AT. Është një pjesë nga intervista që i keni dhënë kësaj

Prokurorie dhe në këtë material, kur të dalë në ekran, të kalojmë në faqen numër 8.

Z. PACE: [Përkthim] Faqja 8 në të dy rastet. Në anglisht do lexoj nga rreshtat 20 deri 25. Dhe është -- janë po të njëjtat rreshta në shqip.

PY. Pra, Dëshmitar, është një përgjigje që ju ia keni dhënë Prokurorit të Prokurorisë së Specializuar, të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në vitin 2019:

"Në një intervistë më 5 korrik '98 ishte publikuar nga një revistë "Kombi", një gazetë, unë deklarova se Presidenti i atëhershëm Rugova, që unë e njihja si kryekomandantin e UÇK-së. Dhe të tjerët kishin mendime ndryshe që Rugova si Presidenti i njohur në atë kohë i shqiptarëve dhe Kosovës nuk ishte, Por ky ishte ndryshimi në mendimet tona."

Tani, Dëshmitar, ju pyes: A ju kujtohet që në media në vitin '98 të keni thënë se Ibrahim Rugova duhet të konsiderohet si kryetari i UÇK-së apo që ju e njihnit atë si kryekomandant të UÇK-së?

PË. Po, unë jam pyet nga gazetari dhe normalisht që jam përgjigj. Ashtu, Rugova ishte Presidenti i zgjedhur me votë, qysh në vitin '90 dhe ishte, njihej, jo vetëm nga shqiptarët e Kosovës, por botërisht që ishte lider politik i shqiptarëve të Kosovës.

PY. Në përgjigjen që ju sapo thatë tani është që jua ka bërë pyetjen gazetari dhe ju jeni përgjigj. Këtu e keni fjalën për

gazetarin e "Kombit"?

PË. Gazetarin Musa Kurhasku që ka përgatit artikullin edhe ka botuar në "Kombi".

PY. Ju kujtohet që të keni thënë gjëra të ngjashme, për shembull, për Ibrahim Rugovën edhe në intervista të tjera që i keni dhënë për median në vitin '98 dhe '99?

PË. Prej fillimit dhe deri në fund unë kam pas, i kam pas këto qëndrime kur jam pyet nga gazetarët. Unë edhe në fazën përgatitore jua kam shpjegu qëllimet e intervistave të mia edhe arsyen pse unë jam prononcuar ashtu dhe që ju kam thënë se në intervistat e mia iu kam përmbajt konventave ndërkombëtare për propagandën në luftë, të cilat ndalojnë thirrjen për dhunë në civilë; thirrjen ose nxitjen për dhunë në njerëz, personat të mendimeve të ndryshme politike; thirrjen, ndalojnë thirrjen për dhunë në për dallime nacionale, gjinore, fetare, racore që ndalojnë thirrjen për dhunë mbi objektet fetare, çfarëdo feje qoftë; objekteve kulturore historike, të cilido nacionaliteti në territorin ku luftohet.

Dhe unë tonë kohën në intervistat e mia dhe në luftën time propagandistike kundër forcave serbe dhe për lirinë e Kosovës që unë e konsideroj, kjo ka qenë një prej armëve të mia të fuqishme. Iu kam përmbaj këtyre kodeve, këtij kodi. Dhe askush nuk gjeni që unë i kam thyer, i kam thyer këto rregulla në intervistat e mia.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument dhe dëshiroj që të nxjerrim edhe një herë librin e dëshmitarit me numër U002-3041 deri në 3143 me përkthimin në anglisht me numër U002-3080 deri në 3141-ET. Në të dy rastet do shohim faqen me numër 3096, që duhet të jetë faqja 56 në PDF-në në shqip dhe faqja 17 në anglisht. 56. 55 më saktë në shqip. Dhe faqja 17 në anglisht nëse nuk e kam gabim. Po, kjo është.

Do të lexoj nga paragrafi i parë në anglisht në këtë faqe. Në shqip, pjesa e majtë.

PY. Dëshmitar, është një tjetër faqe nga libri juaj me të cilin -- për të cilin kemi folur sot dhe dje. Unë do ta lexoj në anglisht, ju mund ta ndiqni ose në ekran, ose përmes përkthyesit me gojë. Këtu thoni kështu:

"Unë, në fillim të korrikut pata bërë një prononcim për gazetën "Kombi", se jam për institucionalizimin e UÇK-së, se jam kundër formimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shtabit në Tiranë (në atë kohë pat ardhur edhe Tahir Zemaj me oficerët) dhe në këtë intervistë dola haptazi me qëndrime shumë konkrete, që të mos krijohet shtabi në Tiranë se ne e kishim shtabin në Kosovë. Kishim njohuri që Bislim Zyrapi ishte bërë shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Me Bislimin kisha kontakte qysh në Tiranë dhe unë punoja me urdhra të tij. Ai edhe pat ardhur në Rekë të Keqe si u zgjodh shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. U krijua një lidhshmëri; u krijua një linjë subordinimi që nga njësitë më të vogla deri te SHP i

UÇK-së; u krijuan themelet e një ushtrie të rregullt dhe unë dola haptazi që kjo ushtri të institucionalizohej, por jo me Shtab në Tiranë, siç dëshironte Bukoshi. Bujar Bukoshi duhej të vinte në Kosovë e duhej të pranonte strukturat që ishin krijuar në Kosovë. Kjo lidhje drejt edhe me informatat që kisha unë për formimin e një qeverie. Për çdo gjë bisedat i bënte Christopher Hill. Prononcimet e mia ishin që të bëhej institucionalizimi, por jo pa marrëveshje me UÇK-në dhe në frymën e atyre përpjekjeve që i bënte Hilli në takimet për krijimin e një strukture, një subjekti, një qeverie që do të përfshiheshin të gjithë."

Dëshmitar, informacioni i marrë nga ky libri juaj, i saktë?

PË. Këtu vetëm një dallim i vogël është. Kur ka ardh Bislimi në Rekë e Keqe ka thënë që më ka tregu që është duke e ngrit drejtorinë e operatives të Shtabit të Përgjithshëm. Pra, ishin përpjekjet për t'u kriju drejtoria operative dhe ai ishte i zgjedhur. Ishte emëru ose ishte caktu dhe unë këtë e merrsha si një diçka shumë pozitive që po krijohet struktura organizative e niveleve më të lartë të ushtrisë.

Dhe përpjekja ime ishte e vazhdueshme dhe thirrja që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të institucionalizohet se vetëm në atë mënyrë ne mundeshim më shpejt me bind faktorin ndërkombëtar dhe me ardh deri te bisedimet të cilat u zhvilluam pastaj në Rambuje. Çdo luftë fillon me armë, por

përfundon në tavolinën e bisedimeve. Unë isha për atë, do të thotë. Ton kohën ka qenë vija ime, e prononcimeve. Institucionalizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kur jam caktu për anëtar -- një prej pesë anëtarëve të ministrisë së mbrojtjes në Tiranë me shkrim nga Ahmet Krasniqi muajin prill në '98. Unë e kam refuzu; unë edhe Agim Çela i kemi refuzu pozitat. Kemi thënë, unë i kam thënë edhe Ahmetit vetë, Ahmet Krasniqit: Lufta nuk bëhet në Tirana, lufta bëhet në Kosovë dhe vendi jonë është vendi i ushtarakëve është në Kosovë. Në Kosovë duhet të vijnë të gjithë. Kjo ka qenë vija ime. Dikun aty-këtu e kam ekzagjeru. Mirëpo, intervistat e mia kryesisht janë këto: Kanë qenë ofruese, kanë qenë mobilizuese, kanë pas jehonë të madhe në popullatën civile shqiptare, kanë pas jehonë të madhe në ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkrahje të madhe kanë pas edhe ky ka qenë -- synimi i paraqitjeve të mia. Unë jam pyet gjithmonë prej gazetarëve dhe nuk kam mujt me iu ik pyetjeve. Është dashtë me dhonë përgjigje.

PY. Në cilin muaj dhe vit ka ardh Bislim Zyrapi në Rekën e Keqe derisa e ngriti drejtorinë operative?

PË. Ka ardh saktë më 17 korrik 1998 se atë ditë ka fillu beteja e Rahovecit. Ndiheshin krismat dhe ai ka ardh e më ka tregue që po ka fillu ngritja e drejtorisë operative që ai do të është përgjegjës edhe normalisht që është dashtë një herë, më së pari, me i vizitue të gjitha territoret që janë nën

kontrollin e UÇK-së. Të gjitha njësitë për me e pas figurën e qartë, fotografinë e qartë se sa ka territore të cilat janë vijat, kush janë përgjegjësit, me çfarë infrastrukture ushtarake disponon Ushtria Çlirimtare e Kosovës për me mujt pastaj me operuar nga drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm. Çdokund bëhet kjo ashtu, në çdo ushtri.

PY. Dhe kjo pjesë nga libri juaj që e lexova, ju përmendni që keni dhënë prononcime për gazetën "Kombi", është po e njëjta intervistë që ju e keni përmendur edhe në intervistën për TPNJ-në dhe intervistën që i keni dhënë kësaj Prokurorie që sapo e lexuam?

PË. Jo, jo kjo intervistë -- po. Po. Ka shumë intervista ka. Janë në librin tim, janë botuar nja pesë, më duket, intervista për "Kombin", për "Zërin".

PY. Sa intervista ju kujtohet t'i keni dhënë "Kombit" në korrik të '98-s?

PË. Ka qenë vetëm një për "Kombin". Por pastaj kam dëgju që pjesë nga ajo intervistë janë marrë nga gazeta të tjera dhe me cilat është pretendu që ata kanë bë intervista me mu.

PY. Kur e keni dëgju këtë?

PË. E kam dëgju kur m'i keni prezentu ju.

PY. Kur ju kam prezantu çfarë?

PË. Një revistë të botuar në Tiranë nga Ministria e Mbrojtjes së qeverisë së Kosovës.

PY. Kur jua tregova atë revistë, çfarë ishte që ju bëri të

besonit se ishte riprodhim i asaj që ishte botuar te "Kombi"?

PË. Po ishte interpretimi i saktë, do të thotë, nga "Kombi" nuk kishte pas ndryshime në përgjigjen time, në pyetjet që m'i ka bërë gazetari i "Kombit".

PY. Do t'i kthehemi pastaj revistës pak më vonë.

Z. PACE: [Përkthim] Këtë dokument mund ta heqim nga ekrani tani.

PY. Dëshmitar, në intervistën që i keni dhënë ZPS-së dhe gjatë përgatitjes ju përmendni se e keni takuar Hashim Thaçin për herë të parë në Prapaqan në gusht të '98-s. Po ju pyes: Kjo është e vetmja herë që jeni takuar me Hashim Thaçin në gusht të '98-s?

PË. Kjo është e para herë që jam taku.

PY. Thoni Prapaqan në gusht të '98, kështu?

PË. Prapaqan në gusht '98. Nja tri ditë para se me ra Loxha.

PY. Në gusht të vitit '98, veç një herë e keni taku Hashim Thaçin apo jeni takuar me të përsëri në gusht?

PË. Në gusht jam taku edhe në Kleçkë. Ka qenë dy ditë para se me ra, para se me ra Kleçka, dy-tri ditë, në shtëpinë e Zenel Shalës ku isha i strehum si i plagosur rëndë.

PY. Ky takim që ka ndodh në Kleçkë ishte përpara apo pas takimit tuaj me Hashim Thaçin në Prapaqan?

PË. Ishte pas takimit në Prapaqan.

PY. Dhe e thatë që ishte dy ditë përpara se të merrej Kleçka. Më ç'datë, të cilit muaj është marrë Kleçka?

PË. Është marrë më -- Kleçka ka ra më 25 gusht ’98.
PY. Ishte dikush tjetër i pranishëm me Hashim Thaçin në atë rast, në Kleçkë?
PY. Ishte komandant Kumanova dhe unë besoj ai e ka sjellë, e ka marrë me vete Hashim Thaçin. Ishte vizita e tij. Mund të duket e punës në lidhje në atë për çka ka bisedu komandant Kumanova me mua.
PY. Që të jemi të qartë, që ishte “vizitë pune e tij”, për cilin bëhet fjalë, kush e kishte këtë vizitë pune?
PË. Komandant Kumanova që komandonte me pozicionet në Luzhnicë edhe Kleçkë.
PY. Si quhej në të vërtetë komandant Kumanova?
PË. Pas lufte e kam marrë vesh ka qenë Ismet Jashari.
PY. Komandant Kumanove, pra, Ismet Jashari, a është gjallë sot?
PË. Jo, ai është më ditën e sulmit në pozicionet e Luzhnicës me 25 gusht ’98.
PY. Që të jemi të qartë, ju thoni më 25 gusht ’98, atëherë ka vdekur komandant Kumanova?
PË. Po.
PY. Komandant Kumanova, çfarë tha, nëse tha ndonjë gjë, çfarë të tha ty në këtë rast në Kleçkë kur u takuat me të?
PË. Komandant Kumanova m’i ka -- është mundu me m’i shpjegu si e ka organizu mbrojtjen e pozicioneve në Luzhnicë që mos me depërtu forcat serbe për në Kleçkë edhe pozicionet e tjera.

Dhe më kujtohet shumë mirë se kemi bisedu rreth atyne -- pozicioneve edhe çka duhet ndërmarrë që të përmirësohen pozitat.

Më kujtohet shumë mirë që e lamë pas një dite, dy ai të vjen dhe të merr ashtu të plagosun dhe të shkoj në vendngjarje t'i shoh vetë pozicionet. Këto kemi bisedu, pra, këtu gjëra i kemi bisedu me të. Më kujtohet kur i kam thënë që ai ka siguru krahun e djathtë dhe të majtë të pozicioneve. Më ka thënë që andej është mal dhe nuk mund të vijnë forcat serbe. [E pakuptueshme] bash andej nga mali vijnë se këtë problem, problematikë unë e kam pas në Morinë në '98, këtë përvojë.

PY. Ndërkohë, më falni, kur ta dha komandant Kumanova këtë informacion, Hashim Thaçi ai ishte i pranishëm; a e dëgjoi edhe ai atë çfarë tha komandant Kumanova?

PË. Po, po ishin bashkë ata, po.

PY. Hashim Thaçi a tha ndonjë gjë lidhur me këtë temë, lidhur me këtë që tha komandant Kumanova sa i takon organizimit të pozicioneve mbrojtëse, apo jo?

PË. Po, nga tri herët që jam taku me Hashim Thaçin gjatë luftës në Kosovë, është e vetmja herë që Hashim Thaçi ka fol. Pra, në të dy tjerat në Prapaqan dhe pastaj në Lladrovc nuk ka fol. Aty e ka pas, më kujtohet intervistën time në "Kombi" edhe ka thënë, që kam thënë shumë fjalë të mira në të. Pra, më ka lavdu që shumë gjëra të mira kam thënë në atë intervistë, por që disa gjëra, me disa gjëra nuk pajtohet me mua. Nuk i ka

cekë cilat.

PY. Që ta sqarojmë, Hashim Thaçi të tha që pajtohem me disa nga gjërat që ke thënë, por nuk pajtohem me disa nga gjërat e tjera që i ke thënë "Kombit" në Kleçkë ta thatë, të gusht të '98-s?

PË. Për shkak se është hera e parë dhe e vetme që ka fol Hashim Thaçi me mua në luftë edhe ajo më kujtohet. Më ka thënë me shumicën e gjërave, pra, me shumë çka kam fol në atë intervistë është shumë e mirë, por vetëm me disa gjëra nuk ishte pajtu me mua, do të thotë kaq.

PY. A të kujtohet çfarë kishte veshur Hashim Thaçi në këtë rast?

PË. E ka pas, më duket, të njëjtën uniformë, uniformë ushtarake ka pas.

PY. A të kujtohet nëse kishte ndonjë gjë me vete Hashim Thaçi kur të foli në këtë rast?

PË. Nuk më kujtohet çfarë arme ka pas, me thënë të drejtën, me vete.

PY. Nuk po themi për armë, nuk thamë armë. Ndonjë, a kishte ndonjë gjë me vete, a mbante gjë në duar, a ju tregoi ndonjë gjë, jo domosdoshmërish armë.

PË. Jo, asgjë tjetër nuk e fol asgjë tjetër. Biseda ka qenë e përqendruar e komandant Kumanovës me mua.

PY. Ju thatë që Hashim Thaçi bisedoi me ju për intervistën "Kombi". Ai me vete, a kishte ndonjë kopje të kësaj

interviste?

Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj. Është sugjestionuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është sugjestionuese. Pranohet kundërshtimi.

Z. PACE: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që gjatë intervistës me ZPS-në keni thënë që kishte një kopje me vete --

Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj, kundërshtoj. Tani po përpiqet që të vejë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarit.

Z. PACE: [Përkthim] Nuk po vë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarit, por po përpiqem të bëj një sqarim.

Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë kam një parashtrim pa praninë e dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, duhet të largoheni pak çaste nga salla e gjyqit. Të largoheni tani nga salla e gjyqit në shoqërinë e Asistentes së sallës.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kundërshtim e bëra të qartë. E ka pyetur për procesverbal, a mbani mend të kishte gjë me vete Hashim Thaçi kur bisedoi me ju në këtë rast. Ai u përgjigj:

"Nuk më kujtohet çfarë arme kishte".

"PY. S'po ju them për armë. Në përgjithësi a kishte diçka me vete, a mbante gjë në duar, a ju tregoi diçka?

"PË. Jo. Asgjë tjetër."

Çfarë është kjo, pikë. Tani vjen prapë pyetja, pasi u pranua edhe kundërshtimi im, bëhet sërish pyetja:

"Dëshmitar, a ju kujtohet që gjatë seancës përgatitore..."

Dhe tani po përdor Shënimin Përgatitor numër 2 që ta orientojë në mënyrë që të kontradiktojë përgjigjen që sapo tha, kur tha, jo ai s'kishte gjë me vete, s'kishte asgjë në duar. E kundërshtoj. Nëse doni të vazhdojmë në këtë formë, atëherë duhet të na e sqarojë pse po e bën këtë për t'i rikujtuar dëshmitarin apo për të vënë në dyshim besueshmërinë e tij dhe kjo është e specifikuar në rregullën 143.

Z. PACE: [Përkthim] Nuk jemi fare në fazën për të kërkuar leje sipas rregullës 143. Unë po përpiqem t'ia kujtoj nëse i kujtohet a e ka thënë diçka gjatë seancës përgatitore. Nëse i kujtohet mirë, nëse nuk i kujtohet atëherë me lejen tuaj do dua t'i tregoj dokumentin përkatës. Nuk është prova kjo.

Është thjesht një pistë pyetjes që po përdorim ne, sepse para një jave dëshmitari ka thënë diçka dhe tani po thotë diçka tjetër.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë po -- mos e lusni atëherë që të përgjigjet siç doni ju. Bëjeni pyetjen ju thjesht dhe mos e nxisni, cysni më shumë.

Z. PACE: [Përkthim] Synimi im është që ta pyes kështu: A ju kujtohet që gjatë seancës përgatitore thatë që z. Hashim Thaçi kishte një kopje të intervistës së "Kombit" me vete kur

bisedoi me ju; kjo është pyetja që do t'i bëj dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta lejoj këtë pyetje. Por mos e thelloni më tej.

Z. PACE: [Përkthim] Patjetër.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. PACE: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, po bisedonim para një çasti për Kleçkën, gushti i '98-s kur jeni takuar me z. Hashim Thaçi dhe komandant Kumanovës. Dhe unë kam këtë pyetje:

A ju kujtohet që gjatë seancës përgatitore thatë që Hashim Thaçi kishte një kopje të intervistës për gazetën "Kombi" me vete gjatë këtij takimi?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të përgjigjesh me "po" ose "jo", dëshmitari.

DËSHMITARI: Po.

Z. PACE: [Përkthim]

PY. A jeni takuar sërish me Hashim Thaçin në '98 ose '99?

PË. Jam takuar në tetor '98 në Lladrovc.

PY. Hashim Thaçi a ka qenë vetëm kur e takuar në Lladrovc në tetor të '98-s?

PË. Jo, ka qenë me Sabit Gecin edhe me një shoqëruar që i thonin Raketa.

PY. Ku jeni takuar në Lladrovc specifikisht me këta tre persona, në cilin vend në Lladrovc?

PË. Jemi takuar rastësisht në rrugë. Ata kanë qenë duke lëvizur me veturë për fshatin Senik. Unë isha me djalin e dajës Xhevat Buçajn duke ec për t'u rehabilituar shpejt. Bëjsha disa kilometra ecje në ditë dhe jemi takuar rastësisht.

PY. Thatë që po shkonin në fshatin Selitë --

PË. Senik.

PY. -- Salitë -- Senik.

PË. Në drejtim të Senikut. Unë nuk di për ku tjetër, por në drejtim të Senikut, po.

PY. A e dini pse po shkonin në drejtim të Senikut në këtë rast?

PË. Pastaj në takim me ta mora vesh që tërhiqeshin disa të plagosur për në Shqipëri dhe Sabit Geci me ta.

PY. Përmendët Raketën që ka qenë i pranishëm, por Raketa ka qenë anëtar i UÇK-së në atë kohë, në tetor të '98-s?

PË. Ka qenë në uniformën e UÇK-së.

PY. E dinit ju në atë kohë, apo mësuat më vonë çfarë roli kishte raketa në UÇK?

PË. Mbas lufte ka qenë tërë kohën shoqërues i afërt i z. Thaçi, edhe kur ka qenë kryetar partie, kryeministër, sa e di unë edhe president, ai ka qenë një shoqërues i afërt i tij.

PY. A e dini, çfarë roli kishte Raketa gjatë luftës?

PË. Jo.

PY. Ju thatë që po shkonin me veturë. Kush e voziste veturën në këtë rast?

PË. Më kujtohet, Sabit Geci.

PY. A e kuptova drejt, pra, ju i patë këta në rrugë, kështu?

PË. Po, po.

PY. Po përveçse në rrugë, a i pe në ndonjë vend tjetër?

PË. E lamë takimin që ata të ndalemi dhe të bisedojmë bashkë në shtëpinë e Shefqet Buçajt, që ishte me nofkën komandant Mësuesi. Dhe ata shkuan aty me kerr, unë, djali i dajës shkuam në këmbë se ishte afër.

PY. Më pas u takove me Sabit Gecin, Hashim Thaçin dhe Raketën - më falni - te shtëpia e Mësuesit?

PË. Kemi ndejt të gjithë bashkë aty në odën e Shefqet Buçajt, ka qenë edhe Shefqet Buçaj aty.

PY. Në këtë rast, a bisedoi Hashim Thaçi me ju qoftë kur e takuat në rrugë apo në odë?

PË. Jo, Hashim Thaçi s'ka fol kurrë një fjalë aty se unë ishte befasi edhe për mu edhe për Sabit Gecin që takova aty, për shkak se Sabitin unë e njihsha nga Sllovenia. Pra, e njihsha prej viteve '89-'90.

PY. Po Sabit Geci, bisedoi me ty në rrugë apo tek oda e Mësuesit?

PË. Në rrugë më kujtohet iu kom drejtu sllovenisht e pastaj në odë kemi bisedu bashkë shqip kemi bisedu me Sabitin. Kishte kohë të gjatë që s'isha taku me të edhe biseda ka qenë vetëm

mes meje edhe Sabitit.

PY. Për çfarë biseduat ju me Sabit Gecin në këtë rast në odë?

PË. Kem bo edhe shaka ashtu sikurse që bënin shaka kur ishim në Slloveni. I thashë, si nuk të qëlluan një gjysmë metri më lart, po vetëm këmbëve, q'ashtu edhe e kem bisedu. Më ka ofru pastaj Sabiti me më tërheq me shku bashkë në Shqipëri për me u rehabilitu edhe unë kisha vendos të mbetem në Kosovë. Kjo ka qenë një takim gjysmë orësh me pi një kafe bashkë edhe me njëfarë forme çmallje me një shok që unë e njihsha nga Sllovenia. Mendoj që edhe z. Thaçi është befasu kur e ka pa çfarë afërsie dhe që njihemi shumë më herët me Sabit Gecin.

Z. PACE: [Përkthim] Dua të shohim edhe një herë librin e dëshmitarit. Ju lutem të vendoset në ekran materiali me numër U002-3041-U002-3143 dhe përkthimi në anglisht me numër U002-3080-U002-3141-ET. Dhe do të shohim faqen U002-3127 në të dyja versionet. Në PDF duhet të jetë faqja 87 në shqip edhe 48 në anglisht.

Eh jo, gabimin e kisha shqipen. Faqja pararendëse, ju lutem. Po, kjo është faqja.

PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër e librit tuaj. Zmadhojeni pak gjysmën e dytë të librit, ju lutem, te titulli "Kosovës i duhet uniteti i faktorëve..."

Dhe në shqip zmadhoni pjesën e djathtë. Po ju lexoj tekstin këtu dhe më pas do t'ju bëj pyetjet.

"Kosovës i duhet uniteti i faktorëve politikë e

ushtarakë.

"Z. Maloku, është thënë se jeni i plagosur. Ju lutem, që për *Deutsche Welle* të na thoni se në ç'rrethana keni marrë plagë dhe si është gjendja juaj shëndetësore?

"Maloku: Jam plagosur para një muaji në luftimet në Junik dhe gjendja ime shëndetësore momentalisht është e mirë, që së shpejti t'i kryej detyrat që më janë caktuar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

"Në komunikatën e lëshuar nga mbledhja e 21 gushtit Shtabi i Zonës së Tretë Operative për Rrafshin e Dukagjinit kërkon institucionalizimin e jetës politike dhe ushtarake në Kosovë. A do të thotë kjo edhe formimin e qeverisë së koalicionit ku do të ishin përfaqësuesit e UÇK-së?

"Maloku: Situata është e tillë edhe unë edhe më parë kam kërkuar institucionalizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Do të thotë UÇK-ja duhet të futet në kornizat e institucioneve shtetërore të Kosovës. Se çfarë qeverie do të formohet dhe si, kjo është çështje e liderëve të të gjitha partive politike. Mirëpo, kërkesa jonë dhe mendimi ynë është që UÇK-ja duhet të futet në kornizat e institucioneve të Republikës së Kosovës.

"Ç'mendoni për grupin e ri negociator; a do të respektojë UÇK-ja ndonjë marrëveshje eventuale mes Prishtinë e Beogradit?

"Maloku: UÇK-ja, së pari, duhet të futet në kornizat e institucioneve shtetërore e pastaj çdo bisedë në çdo negociatë natyrisht që të respektohet nga UÇK-ja nëse është në kornizat

e --

Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqet, në të dyja versionet në faqen tjetër, ju lutem. Zmadhojeni shqipen në të majtë, edhe në anglishten në krye të faqes.

PY. "... në kornizën e institucioneve. Krejt çështja, sipas mendimit tim, ka ngelur te liderët e partive politike dhe mosmarrëveshjet mes tyre."

Z. PACE: [Përkthim] Tani jemi në faqen 3188, ju lutem, shkojmë më poshtë tek anglishtja, ju lutem, të shohim fundin. Zmadhojnë shqipen lart dhe - më falni - në fund zmadhojeni pjesë ku shikohet teksti me shkronja të errëta.

PY. Thuhet:

"(Kjo intervistë është transmetuar në radio *Deutsche Welle* më 26 gusht 1998 në edicionin e lajmeve të orës 17.00. Intervistën e bëri autori i librit)."

Tani, Dëshmitar, unë kam këto pyetje. A ju kujtohet kjo intervistë për *Deutsche Welle* në gusht të '98-s?

PË. Po e kam dhënë me zë, do të thotë me telefon unë jam përcjellë me këtë intervistë edhe në emisionin *Deutsche Welle*.

PY. Kjo që lexova unë nga libri juaj, a korrespondon me atë që është transmetuar në atë kohë në intervistë?

PË. Kjo korrespondon edhe me qëndrimet e mia që pa unifikimin e faktorit politik edhe ushtarak nuk mund të ulemi në bisedime si palë, për t'u zgjedh -- problemi i Kosovës ose për të përfundu lufta. Ky ka qenë mendimi i imi dhe unë e kam shpreh

këtë publikisht. Kjo është intervistë e marrë direkt prej *Deutsche Welle* dhe nuk ka të shtume as të hequn asgjë.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani dhe të vendosim P01853 dhe 01853-ET. Do shohim faqen e parë në të dyja versionet.

PY. Dëshmitar, tani në ekran është një dokument tjetër. Në të majtë shqipja.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim shkurtimisht faqen e dytë tek shqipja.

PY. Dëshmitar, këtë dokument përpara se t'jua tregoja unë javën e kaluar, a e kishit parë ndonjëherë?

PË. Jo.

PY. Është gazeta "Koha Ditore", 2 shtator të '98-s dhe kjo pretendohet që është një intervistë me Jakup Krasniqin.

Z. PACE: [Përkthim] Në anglisht do shkojmë në faqen e dytë dhe do të lexoj pyetjen e fundit të kësaj faqe dhe përgjigjen që kalon më pas në faqen tjetër.

Në shqip është pak më e ndërlikuar, në fakt. Duhet të qëndrojmë në faqen e dytë dhe të zmadhojmë pyetjen e fundit në kolonën e mesit. Zmadhojeni edhe më shumë. Poshtë fotografisë, menjëherë poshtë -- këtu. Po filloj nga pyetja dhe përgjigja në fund të kësaj kolone.

Por vazhdon dhe në kolonën e tretë. Kur të përfundoj duhet të kalojmë te kolona tjetër.

PY. Po e lexoj, Dëshmitar, pastaj do t'ju bëj pyetjen.

"KD: Krijimi i këtij shtabi dhe prononcimi i disa oficerëve të UÇK-së, siç ishte edhe Maloku në *Deutsche Welle* komentohen si pasqyrë e përçarjeve në UÇK. A ekzistojnë përçarje?

"Krasniqi: Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk është i përçarë. Por, kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe angazhimi i saj fisnik, armiku po përpiqet të përhapë rrjetën e merimangës edhe në të cilin fatkeqësisht mund të gjendet edhe në këtë rrjetë, mund të gjesh disa oficerë, ish-oficerë të armatës jugosllave që duket se kanë vështirësi ta pranojnë tranzicionin nga mercenarë në luftëtarë të lirisë. Ne mendojmë se nuk ka nevojë për asnjë koment për këtë intervistë që e ka dhënë një person i papërgjegjshëm dhe i paautorizuar."

Z. PACE: [Përkthim] Në fakt, në shqip duhet të kthehemi në faqen e parë që t'ia tregojmë dëshmitarit se çfarë lexuam. Zmadhojeni kolonën e tretë në të djathtë të fotografisë. Zmadhojeni edhe më shumë.

PY. E morët edhe nga përkthimi me gojë, besoj, po kjo që lexova unë është edhe në ekran tani.

Tani, Dëshmitar, a e dinit ju që pretendohet se e ka thënë këtë gjë Jakup Krasniqi?

PË. Jo.

PY. A keni pasur ndonjëherë ndonjë diskutim me Jakup Krasniqin për intervistat tuaja publike?

PË. Jo.

PY. Faleminderit.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani edhe besoj që është momenti më i përshtatshëm për të bërë pushimin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të bëjmë gjysmë ore pushim, Dëshmitar. Njësoj si dje; 11:00 deri në 11:30. Mos flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit, ju lutem. Nëse dikush përpiqet të flasë me ju, na informoni menjëherë. Tani mund të dilni nga salla e gjyqit.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

Z. PACE: [Përkthim] Për t'ju ndihmuar, sa i takon parashikimet të kohës, më duhen edhe 30-40 minuta.

Z. MISETIC: [Përkthim] Një pyetja kam: Ky dëshmitar duhet patjetër të përfundojë deri nesër?

Z. PACE: [Përkthim] Më duhet ta verifikoj këtë. Do ta verifikojmë gjatë pushimit dhe do t'ju them, sepse në fakt më shumë problemin e kemi me një dëshmitar tjetër, jo me këtë dëshmitar.

Z. MISETIC: [Përkthim] Sepse Mbrojtja do ketë kundërpyetje të gjata edhe do kërkojmë shtim të kohës që mos të kemi problem nesër, domethënë, mos na thonë që s'keni kohë të mjaftueshme. Ne duam kohë shtesë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do jua japim kohën që ju nevojitet.

Z. PACE: [Përkthim] Unë s'kam asnjë problem që të rri dëshmitari më gjatë, por më duhet ta verifikoj gjatë pushimit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. E diskutojmë pas pushimit këtë gjë.

Bëjmë pushim deri në 11:30.

--- Pauza fillon në orën 11.00

--- Seanca rifillon në orën 11.31

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, a arritët që të konfirmoni nëse do të mund të qëndrojë dëshmitari dhe pasnesër?

Z. PACE: [Përkthim] Siç e thashë, si më përpara, nuk dimë ndonjë problem për qëndrimin e tij, por edhe nuk kemi komunikuar dot sepse ai është nën betim tani.

Sa i takon dëshmitarit tjetër, këtë që dua të them është që ai dëshmitar mund të ketë ngushticë në kohë, kufizime në kohë, kështu që mund të dojë që ta fillojë dëshminë të enjten. Pra, nëse ky dëshmitar që kemi do vazhdojë të premten, do kishte problem. Megjithatë, mbase është herët për të folur për këtë. Do mbledhim informacionet e nevojshme dhe pastaj do ta trajtojmë si problem.

Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mendoj se është herët, mendoj se ka filluar orën e katërt dhe nuk e di sa do zgjasë më shumë. Dhe problemi është që nëse zgjat më shumë se katër orë dhe na zë neve kohën Prokurori.

Z. PACE: [Përkthim] Nëse mund të them që nuk e di pse

është interpretuar që ne do marrim kohën, pra do zëmë kohën e Mbrojtjes, kohën e administrimit --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e ke, jeni gati katër orë tashmë.

Z. PACE: [Përkthim] Po. Siç e thashë duhet që të fillojmë me dëshmitarin tjetër të enjten, nëse para se të mbarojë ky dëshmitar, nëse ky dëshmitar nuk ka mbaruar deri të enjten. Por do ta trajtojmë këtë problem kur të vijë koha.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fusni dëshmitarin në sallë, ju lutem.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, mund të vijoni.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

PY. Dëshmitar, a e njihni gazetën Fakti?

PË. E kam pa mbas lufte që ka ekzistu një revistë, Fakti, që është botu në Tiranë. Por nuk kam pas numrat e atij, të asaj reviste.

PY. A ju kujtohet t'i keni dhënë interviste një reviste a një gazete të titulluar Fakti?

PË. Jo.

Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të nxjerr në ekran dokumentin me numër P00916 dhe P00916-ET, të shohim faqen 105467 në të dy versionet, ju lutem.

PY. Dëshmitar, në ekran shihni një dokument që majtas është

1 në shqip, djathtas në anglisht. A e kishit parë këtë dokument
2 më përpara se t'jua tregoja unë javën që shkoi?
3 PË. Jo.
4 Z. PACE: [Përkthim] Po të shohim pjesën e sipërme të
5 dokumentit, ku është edhe pjesa e, titulli i sipërm, shohim
6 emrin e këtij botimi, Revistë Ushtarake, dhe majtas në mënyrë
7 vertikale është shkruar data, 1 shtator 1998.
8 Tani do të kalojmë në një faqe tjetër, që është faqja
9 105481, ju lutem, në të dyja gjuhët. Po të shohim pjesën e
10 poshtme, shohim që është faqja 15 e botimit, faqen e parë të
11 të cilit sapo jua tregova. Në pjesën e sipërme të të dyja
12 versioneve. Edhe më lart në shqip, po. Ta shohim më mirë
13 tekstin në të kaltër në shqip, që është rreshti i parë. E
14 njëjta gjë dhe në anglisht, rreshti i parë.
15 PY. Mund ta lexoj. Rreshti i parë, Dëshmitar, thotë:
16 "Intervistë ekskluzive e eprorit të Ushtrisë Çlirimtare
17 të Kosovës Naim Maloku dhënë gazetës Fakt të Shkupit."
18 Ju rikujtohet tani që i keni dhënë intervistë një botimi
19 që quhet Fakt?
20 PË. Jo. Nuk i kam dhanë kurrë intervistë Faktit.
21 Z. PACE: [Përkthim] Do të lexoj pyetjen e parafundit në
22 shtyllën e mesme. Edhe përgjigjen tuaj. Mund ta zmadhojmë
23 shtyllën e mesme, ju lutem. Kjo mjafton në anglisht. E njëjta
24 edhe në shqip. Po, në rregull.
25 PY. Pra, do ta lexoj dhe kam një pyetje pastaj.

"Fakti: Cilin prej politikanëve do të kishit pranuar të udhëheqë UÇK-në?

"N. Maloku: Me udhëheqësin, eprorët, me udhëheqjen e eprorëve ushtarakë. Por unë kam dëshirë që sa më parë UÇK-ja të hyjë në një kontroll të institucioneve shtetërore. Kjo do të ishte edhe më mirë. Ndërsa sa i përket komandantit të forcave ushtarake unë mendoj se ky vend i takon kryetarit të shtetit. E kryetar e kemi Ibrahim Rugovën, i cili që tetë apo nëntë vjet bëri çmos për këtë vend dhe qëndroi në Kosovë edhe pse e kishte vështirë. Unë personalisht mendoj se ushtria i takon shtetit, e shtetin e përbën populli. Pra UÇK-ja është e popullit dhe askush nuk mund ta manipulojë me të."

Pyetja është kjo, Dëshmitar. Ajo, këto fjalë që i kanë vendosur në gojën tuaj këtu, a e pasqyron opinionin tuaj, pra mendimin tuaj asokohe siç e keni thënë dhe nëpër media të tjera, intervista të tjera që i pamë dhe sot?

PË. Kjo intervistë edhe fotoja është marrë nga gazeta Kombi, që unë e kam dhanë intervistën, ajo është origjinale. Tash, a ka ndryshu diçka në fjali kjo, nuk e di, por përmbajtja është ajo. Do të thotë, përmbajtja është e gazetës, edhe fotoja është marrë nga revista Kombi, që e kam dhanë unë më 5 korrik 1998, është botu më 5 korrik, unë dikund në fund të qershorit e kam dhanë, por është botu më 5 korrik 1998.

PY. Dhe a ju kuptova saktë që fjalët tuaja këtu në këtë faqe pasqyrojnë, pra, janë të ngjashme me atë që i keni thënë

Kombit në intervistën e atij publikimi?

PË. Shumica janë të ngjashme. Unë muj vetëm, duhet veçëm me krahasu Kombin me këtë edhe me pa se gazetari i cili e ka ribotu këtë intervistë, ka mund ndoshta me e përsërit, me e ndryshu. Por unë Faktit nuk i kam dhanë intervistë. Po e shoh nga fotoja që foton e ka marrë nga revista Kombi që asaj i kam dhanë. Dhe gazetarit Musa Kurhasku që ka qenë nga Gjakova. Ka ardh vetë në mëngjes dhe ka marrë intervistën me mu.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument.

PY. Dëshmitar, më herët sot dëshmuat se thatë se jeni takuar personalisht me Hashim Thaçin në Kleçkë në gusht të 1998, dhe në Lladrovc në tetor të 1998. A jeni takuar ndonjëherë me atë apo përndryshe a keni komunikuar me atë pas takimit të tetorit të 1998?

PË. Një herë në telefon, në telefonin e z. Krasniqi, më kanë thirr që të shkoj në zyrë, edhe jam dëgju me z. Thaçi.

PY. Si e ka emrin z. Krasniqi që ju po e përmendni në këtë rast?

PË. Z. Jakup Krasniqi, që ishte zëdhënës i UÇK-së.

PY. Përmendët se ju kanë thirr me i shku në zyrë z. Jakup Krasniqi. A mund të na e sqaroni se ku ndodhej kjo zyrë?

PË. Në shtëpinë që e thojshim, që i thonim ne shtëpia e bardh, e Shtabit të Përgjithshëm.

PY. Thatë se ju kanë thirr me i shku, me shku në atë zyrë. Por kush ju thirri?

PË. Po e dërgoi më duket nji ushtar aty, që ishte një korridor.

PY. Dhe që të jemi të qartë, kur thoni "e dërgoi", ishte ky person, ishte z. Krasniqi apo dikush tjetër?

PË. Ushtari më tha që, "po ju thirr z. Krasniqi". Për gjë tjetër nuk di.

PY. Thatë se folët me z. Thaçi. Për çfarë folët në telefon në këtë rast, ju dhe z. Thaçi?

PË. Ishte një intervistë e imja e dhënë Kosovës Sot më 28 nëntor. Doli numri festiv në 1998.

PY. Ju apo z. Thaçi, a e cekët këtë botim gjatë bisedës?

PË. Po. Ai ishte që, ai tha që është mirë të mos prononcohem më për gazeta.

PY. Z. Thaçi, a ju tha diçka tjetër në telefon në këtë rast?

PË. Po më tha që, "Mendoj që është mjaft më me paraqitjet në intervista në gazeta". Nuk ka pas tjetër ndonjë -- unë i thashë që kur të vini këtu ne muj me debatu rreth përmbajtjes edhe arsyet që më kanë shty me dhanë nji intervistë të tillë." Edhe mu më takuan gazetarët në Dragobil dhe unë jam takuar rastësisht me ta, edhe e dhashë nji intervistë.

PY. Këtu në transkript është shkruar se z. Thaçi ju tha që: "Mendoj se është e mjaftueshme që, do të thotë, që me dhënë intervista nëpër gazeta", kështu është. Çfarë, si e kuptuat ju, çfarë ka dash të thotë Hashim Thaçi me këto fjalë që jua ka thënë?

PË. Unë e kam kuptu vetëm që ka ndoshta ndonjë mospajtim me ndonjë pjesë apo fjali të intervistës time. Përndryshe, dua t'ju them juve dhe Gjykatës se atë intervistë e ka përkrah shefi i shtabit edhe Sali Veseli, që ishte shefi im. Kemi diskutu për atë intervistë edhe para se me thirr Thaçi. Para se me fol me Thaçin unë.

PY. Thatë se z. Thaçi ju tha që, "do të kishte qenë mirë që të mos jepja më intervista për gazeta." Ju kujtohet nëse dikush tjetër nga UÇK-ja t'ju ketë thënë diçka të ngjashme?

PË. Jo, kurrë.

PY. Na thoni, ju lutem, se kjo bisedë në telefon me z. Thaçi dhe z. Jakup Krasniqi kur ka ndodhur?

PË. Ka ndodh në dhjetor 1998.

PY. Mund ta sqaroni se me çfarë lloj telefoni është bë biseda?

PË. Telefon satelitor.

PY. Ju a e dini nëse ka qenë z. Thaçi që e ka telefonuar z. Krasniqi apo e kundërt?

ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kundërshtim. Dëshmitari tha që e kanë thirr me shku aty.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet kundërshtimi.

Z. PACE: [Përkthim]

PY. Edhe një herë, pyetja është: A e dini -- sipas asaj që dini ju, ka qenë z. Thaçi që i ka telefonu z. Krasniqi apo ka

qenë z. Krasniqi që i ka telefonu z. Thaçi në momentin që ju kanë thirr juve me shku në zyrën e tij?

PË. Kur kam hyrë në zyrën e z. Krasniqi ata kanë qenë duke bisedu në telefon. Dhe ma dha mu telefonin, por ishte veç biseda në zhvillim e sipër. Thashë, cili kënd e ka thirr, unë nuk e di.

Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të nxjerr në ekran dokumentin në 126674-126682. Përkthimi në anglisht 126674-126682-ET, të kalojmë në faqen 126680.

Po. Shohim faqen e parë në anglisht, ndërsa versioni në shqip mund të kalojë në faqen 126680.

PY. Dëshmitar, dokumenti në të majtë është në shqip. Ia keni dhënë ju ZPS-së?

PË. Po.

PY. Shohim se është një intervistë e juaja dhe, po të shohim pjesën e poshtme të faqes, në të dy versionet, ju lutem, shohim që është një intervistë e juaja me Gazetën Shqiptare, e datës 2 mars 1999. Ju kujtohet që e keni dhënë këtë intervistë?

PË. Po, e kam dhanë me telefon nga fshati Jabllanicë.

Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në anglishten në faqen e dytë, dhe të shohim paragrafin e katërt. Ku do të lexoj që nga "Përfaqësuesit e UÇK-së ..." në shqip, është në këtë faqe, diku nga mesi i shtyllës së tretë. Në anglisht, është në rregull. Të shohim mesin e shtyllës së tretë në shqip. Edhe

diçka më shumë. Dhe diku më poshtë. Është në rregull.

PY. Dëshmitar, do të lexoj një rresht dhe mund ta shohim, mund ta shihni ose në shqip ose të dëgjoni përkthimin.

"Përfaqësuesit" --

Më falni. Do të lexoj - po, në rregull.

"Përfaqësuesit e UÇK-së në Rambuje i ka emëruar dhe deleguar vetë SHP i UÇK-së. Pra, ata kanë shkuar në Rambuje me mandat të SHP të UÇK-së."

Pyetja që kam unë është kjo, Dëshmitar. Nga e dinit ju këtë informacion?

PË. Po ishte publikisht e ditur që -- më duket pesë përfaqësues i kishte Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Ata i ka zgjedh Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, dhe e kanë përfaqësu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në bisedimet e paqes në Rambuje.

Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 8 në versionin në anglisht, paragrafi i tretë, ku do të lexoj nga fjalia që thotë "Vijoj ende ..."

Në shqip është në faqen 126682, nga rreshti i tretë, janë tre rreshtat e fundit të shtyllës së dytë, dhe pastaj vazhdon në shtyllën në vijim.

PY. Dëshmitar, do jua lexoj në anglisht. Ju ose mund ta ndiqni në shqip, është shtylla e parë që vazhdon në shtyllën e dytë. Këtu thoni, nga fundi:

"Unë prapë u mbetem besnik prononcimeve të mia ndaj

presidentit Rugova. Unë e çmoj Rugovën si një person i cili nuk e tradhton kauzën, pra nuk e trajton kauzën kombëtare, nuk e ka këtë në gjenet e veta."

Dëshmitar, ju kujtohet që e keni thënë këtë, në këtë intervistë?

PË. Po, saktë. President Rugova ishte pjesë e delegacionit atje.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të pranohet në prova gjyqësore ky material, në përkthimin anglisht, është me numër 126680-126682-ET, dhe me faqen përkatëse 126674-126682. Në qoftë se pranohet, mund të jetë publike, edhe do të jetë pjesë e provës P02093, nga e cila është shkëputur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtim?

Atëherë, 126680 deri në 126682-ET pranohet në prova gjyqësore.

Z. PACE: [Përkthim] Së bashku me versionin në shqip.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, me shqipen, natyrisht.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë këto faqe do t'i shtohen provës me numër 02093. Faleminderit.

Z. PACE: [Përkthim] Atëherë, mund ta heqim këtë dokument dhe në vend të tij të nxjerrim dokumentin U001-5809-U001-5810, krahas me përkthimin përkatës që ka të njëjtin numër me

shtojcën ET në fund.

SEKRETARI E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, edhe njëherë numrin.

Z. PACE: [Përkthim] U001-5809-U001-5810. Faleminderit. Po, mund të qëndrojmë në këtë faqe, në faqen e parë, hëpërhë.

PY. Dëshmitar, ky është një dokument tjetër majtas, e shihni në gjuhën shqipe. E kishit parë këtë dokument përpara se t'jua tregoja unë javën që shkoi?

PË. Jo.

PY. Këtu shohim se përmend, komandën e Zonës Operative të Dukagjinit, të datës 16 mars 1999, "Raport".

Z. PACE: [Përkthim] Dhe po t'i kthehemi faqes së dytë, në të dy versionet, ju lutem. Po të shohim faqet e fundit fare të këtyre -- fjalët e fundit fare të këtyre faqeve.

PY. Shohim se është sektori i zbulimit.

Z. PACE: [Përkthim] Dua që t'i kthehemi tani prapë faqes së parë dhe do t'ju lexoj nga paragrafi i dytë. Në shqip është në rregull, dhe në anglisht. Faleminderit. Mjafton.

PY. Dëshmitar, do të lexoj dhe do t'ju bëj disa pyetje.

"Më 14.03.1999, policia ushtarake e Zhabelit në Bec i mori katër pushkë automatike dhe u kthye në bazë pa probleme.

"Mendoj se majori i paraqitur pranë komandës së zonës operative të Dukagjinit me pseudonimin Murat Dibra, të cilin e ka sjellë Naim Maloku, të mos lejohet nga ana e komandës që të shkon për veprim në rajonin e Lugut të Baranit.

"Gjatë punës së tij në terren, Naim Maloku me masat popullore gjithmonë ka biseduar në frymën e institucionalizimit dhe të funksionalizimit të resoreve të qeverisë së Kosovës. Naim Maloku i ka thirr edhe 15 oficerë për të ardhur në zonat e luftës. Në intervistat që ua ka dhënë gazetave të ndryshme si "Mladina", "Gazeta Shqiptare", etj., Naim Maloku ka pas qëndrim pro-qeveritar dhe e çmon politikën e Rugovës. Këto intervista i kanë çmuar shumë vëzhguesit ndërkombëtarë. Në këtë frymë ka propaganduar edhe në Kralan, në Buçan, Gërgoc, etj. Ka lidhje të vazhdueshme me Sadri Zenelin [Sipas përkthimit] e Jabllanicës.

Dëshmitar, këtu përmendet Murat Dibra. E dini kush është ky?

PË. Po, ky, nuk e kam sjell unë, por ai erdhi në zonën operative të Dukagjinit me një grup ushtarësh nga, që erdhën nga Shqipëria. Është ky majori, Gëzim Ozdreni, që kishte qenë 22 vite shef i Shtabit të Mbrojtjes Territoriale në Dibër të Madhe në Maqedoni, dhe vinte në Kosovë për të kontribu në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për lirinë e Kosovës.

PY. Që të jemi të qartë, pjesa që të lexova thotë pseudonimi është Murat Dibra, por në të vërtetë si e ka emrin ky person?

PË. Unë ju thash juve se dikund prezantohej si Murat, dikund si major. Ju thashë edhe në dokumentet përpara në përgjigje. Ishte Gëzim Ozdreni.

PY. Domethënë, i njëjti person.

PË. Po, i njëjti person.
PY. Ky është i njëjti person për të cilin po flasim.
PË. I njëjti person që pastaj në luftën në Maqedoni ka qenë shef i shtabit i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare tanë kohën.
PY. Ju thatë që ai erdhi vetë në zonën e Dukagjinit me një grup shqiptarësh, me një grup ushtarësh -- më falni, nga Shqipëria. A e dini sa ushtarë ishin bashkë me të?
PË. Po mund të them që ishin diku rreth 50 ushtarë. Por disa u ndalën në zona operative e Dukagjinit dhe disa shkuan pastaj në zona të tjera. Se nëpër Dukagjin kalonin kanalet kryesore të ardhjes së ushtarëve edhe armatimit edhe municioneve. Ushtarë dhe vullnetarë. Ai u ndal në zonën operative të Dukagjinit.
PY. A të kujtohet sa nga këta ushtarë qëndruan në zonën e Dukagjinit, nga totali që erdhën me të?
PË. Mu më duket që kanë qenë edhe nja katër ushtarë të tjerë nga Shkupi që iu bashkun Brigadës 134.
PY. Kur ne po themi Murat Dibra për këtë person, kur erdhi Murat Dibra në zonën e Dukagjinit, a pate komunikime ti me të?
PË. Së pari, ka pas komunikim komandanti i zonës, Ramush Haradinaj, pastaj më tha mua "merre me vete". Iu duk mjaft i vjetër, edhe tha "merre ti me vete" pasiqë me mu ishte dhe ai Shabani. Edhe ai ishte i vjetër. Të tre ne ishim tash, të dy ata ishin oficerë edhe me më ndihmu mu në inspektimin që do e bëjshim dhe vizitat nëpër njësi dhe njësitet e zonës operative

të Dukagjinit.

PY. Pasi erdhi kjo kërkesa që ta merrnit me vete, pas këtij rasti, sa herë e ke parë Murat Dibrën?

PË. Nuk jemi nda kurrë. Edhe kur kemi dalë në Shqipëri për në Koshare, unë ju thashë që urdhrin e kam marr nga Bislim Zyrapi me e marrë Gëzim Ozdrenin dhe me dalë në Shqipëri. Ky është ai Gëzim Ozdreni që unë e kam urdhrin në zonën operative të, në Brigadën 133 për të dalë në Shqipëri me të. Dhe me të e kemi riorganizu Brigadën 134 prapë se komandanti i brigadës që u, i asaj brigade që u emëru në Ratishë, ai u plagos randë. Pastaj, u riorganizu brigada, prapë në Shqipëri, por tani si batalion nën komandën e Gëzim Ozdrenit, u fut po e njëjta brigadë nën urdhrat e komandës, e komandës së Brigadës 138, dhe mori pjesë në luftime deri në fund të luftës. Pra, deri në fund të luftës Gëzim Ozdreni ka qenë tani si komandant batalioni në kuadër të Brigadës 138.

PY. Me sa keni ju dijeni, Gëzim Ozdreni ose Murat Dibra, dhe oficerët që solli me vete në zonën e Dukagjinit fillimisht, këta ishin me LDK-në apo me FARK-un?

PË. Nuk kishte oficerë të tjerë. Nuk kishte oficerë të tjerë me të. Aty në dokument, i cili nuk ka vulë të zonës, këtu në këtë që ku përmendet kjo dokument. Aty unë ndoshta kam thanë që i kam thirr, kam thirr vërtet unë oficerë të tjerë të vijnë unë. Unë tanë kohën kam thirr me ardh oficerë nga Tirana, me ardh në luftë në Kosovë. Prej fillimit.

PY. E marrim një hap më pas. Fokusohemi tek Murat Dibra njëherë. Vetë Murat Dibra, ishte oficer i FARK-ut apo i përkiste LDK-së?

PË. Unë nuk kam njoft oficerë të FARK-ut ose të LDK-së. Ne oficerët kemi qenë oficerë që kemi shpreh dëshirën me ardh në luftë, vullnetin, edhe kemi përdor rrugë të ndryshme. Nuk njof unë tjetër, ne s'kemi pas kurrë probleme mes veti oficerët profesionistë. A kanë qenë në FARK, a me kënd kanë qenë. Nuk po ju kuptoj. Ne ishim në luftë për, me nji armik. Nuk kishim armiq të tjerë ne. Ishin forcat policore ushtarake serbe.

PY. Në fragmentin që lexova unë thuhet që:

"Naim Maloku ka ftuar 15 oficerë ushtarakë të vijnë në zonat e luftës."

Pra, mund ta sqaroni këtë, a e keni, vërtet keni ftuar ju 15 oficerë, me përafërsi, të vijnë në zonat e luftës?

PË. Po unë i kam ftuar, por ata s'erdhën.

PY. Ku ishin këta oficerët që nuk erdhën?

PË. Po silleshin nëpër Tiranë.

PY. Në fragmentin që lexova unë thuhet që keni dhënë një intervistë për gazetën Mladina. Ju kujtohet t'ia keni dhënë një intervistë një gazete me emrin Mladina?

PË. Po.

PY. Ju kujtohet kur e keni dhënë?

PË. Po, ka qenë një revistë Mladina, ata e dërguan gazetarin e tyre në zonën operative të Dukagjinit. Intervistën e kam

dhanë në shtabin e zonës operative të Dukagjinit, në Jabllanicë. Gjatë kohës sa ishte delegacioni jonë në Rambuje.

PY. Që të jemi të qartë. Për cilin muaj dhe cilin vit bëhet fjalë?

PË. Bëhet fjalë për muajin mars 1998. Më falni, shkurt. Më falni, shkurt. Ju lutem. Shkurt, 1998. Diku te gjysma e dytë. 1999, më falni. Po.

PY. Në fragmentin që lexova unë, thuhet që ke dhënë intervista edhe për Gazetën Shqiptare. Ne pamë një intervistë të marsit të 1999 në atë gazetë. A ju kujtohet t'i keni dhënë ndonjë intervistë tjetër Gazetës Shqiptare?

PË. Jo, jo. Ky raporti i këtij që më ka surveju, që më paska surveju unë, e unë s'e kam dit, i dedikohet qasaj interviste të 2 marsit 1999.

PY. Aty ku lexova unë thuhet që keni propaganduar ide të ngjashme në Kralan, dhe në vende të tjera, Buçan, e me radhë. A i keni vizituar ju këto vende në 1998, ose në 1999 personalisht?

PË. Jo, jo. Kjo i dedikohet 1999. Qatë 1999. Shiqoni, 16.03.1999 është data këtu. Unë në 1999 kam shku në Dukagjin. I kam vizitu të gjitha këto fshatra, dhe unë kam mund ndryshe të jap qëndrime përveç përkrahje për krejt delegacionin që është në Rambuje. Atje ishin të gjithë çfarë kuptimi kishte unë me sulmu tash me thanë është Rugova tradhtar, ai ishte në delegacion të Rambujesë. Nji oficer i lartë i UÇK-së. Qysh

ishte marrë kjo në popullatë, në ushtarë, e në të gjithë ata? Është logjike kjo. Unë si oficer duhej përkrah, duhej thirr popullatën me e mbështet delegacionin tonë në Rambujesë. Atje ishin përfaqësues politikë të Kosovës, përfaqësues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shefi -- e udhëhiqte --

PY. Një çast, një çast, Dëshmitar, se nuk iu përgjigjët tamam pyetjes tim dhe kohën e kam të kufizuar. Faleminderit.

Këtu përmendet, po Sadri Zeneli -- Sali Zeneli, më falni kush është ky person?

PË. Sadri Zeneli.

PY. Sadri Zeneli.

PË. Po është nji person i Jabllanicës, ka qenë në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndoshta paskam pas takime ma të shpeshta me të dhe ky ka mendu që kam lidhje. Unë nuk e kam njoft kurrë para luftës Sadri Zenelin.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e këtij materiali.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

Z. DIXON: [Përkthim] Po. Ne e kundërshtojmë pranimin e këtij materiali. Përndryshe, nga dokumentet e tjera që ka parë Dëshmitari sot --

Z. PACE: [Përkthim] Më falni që po ju ndërpres, por mbase parashtrimet mund t'i bëjmë pa praninë e dëshmitarit. Për të qenë korrektë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull atëherë. Dëshmitar, do të duhet të dilni sërish nga salla për disa minuta.

DËSHMITARI: Po, po. Nuk ka problem.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

Ndryshe, pra, nga dokumentet e tjera që iu treguan këtij dëshmitari, ku ai ose ka marrë pjesë në hartimin e tyre, ose ka identifikuar ose ka treguar çfarë procesi është ndjekur për dokumentin, sepse ka qenë pjesë e punës së tij, në këtë dokument ky është një dokument që as nuk e ka parë ndonjëherë, por nuk është as në gjendje ta konfirmojë vërtetësinë e përmbajtjes së këtij dokumenti.

Është një dokument që nuk është i nënshkruar, s'ka vulë. Dëshmitari vetë e tha ky s'ka vulë të zonës. Pra, ne nuk e kemi idenë e prejardhjes së këtij dokumenti. E më gjegjësisht kujt i drejtohet ky dokument. Po ashtu, ne gjykojmë që Dëshmitari nuk është në gjendje të konfirmojë vërtetësinë e përmbajtjes. Ai thotë që nuk e ka sjellë ai majorin atje, se ata ishin atje. Nuk përmenden 50 ushtarët, nuk përmendet Ramush Haradinaj. Nuk është përmendur procesi apo rruga që ka ndjekur për të shkuar në Shqipëri.

Dhe sa i takon gazetës dhe vizitave, sipas nesh ne gjykojmë që Prokurori duhet t'i bëjë disa pyetje të

drejtpërdrejta Dëshmitarit nëse kërkon të marrë informacione të mëtutjeshme, por nuk na shërben kjo për të vërtetuar prejardhjen e këtij dokumentit.

Madje, më shumë se kaq, ky është një dokument që është pjesë e mocionit të ZPS-së për pranimin e provave gojore me numër F02997. Është materiali 216 për mocionin që lidhet me Dukagjinin. Për ne ky është një dokument që nuk duhet të pranohet përmes një dëshmitari sepse nuk është bërë autentikimi *prima facie*, meqë vetë dëshmitari nuk e vërteton dot përmbajtjen e këtij dokumenti.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace.

Z. PACE: [Përkthim] Po filloj me pikën e fundit. Ndryshoi pozicionin tani Mbrojtja. Kur kemi kërkuar ne të pranohet një dokument përmes mocionit për prova jogojore thonë atëherë pranohet përmes dëshmitarit. Tani dalin me një parashtrim ndryshe.

Sa i takon autentikimit të këtij dokumenti i referohem vendimit të Trupit Gjykues F02644, paragrafi 11. Ka edhe dokumente të tjera të kësaj natyre, ku vetë Trupi Gjykues ka thënë që:

"Pranimi i dokumentit mund të bëhet dhe pa qenë nevoja të vërtetojmë kush ka qenë autori i këtij, i një dokumenti."

Dëshmitarit i treguam fragmentin, ai dha dëshmi lidhur me këtë dokument. Po, vërtet ai tha që s'e kam sjellë unë Murat Dibrën, por ama ai tha që s'janë ndarë nga njëri-tjetri qysh

prej momentit kur është caktuar Murat Dibra në zonën e tij bashkë me dëshmitarin.

Po ashtu, dëshmitari -- ose dokumenti thotë që dëshmitari ka ftuar 15, thuhet këtu, ushtarë apo oficerë, Dëshmitari tha nuk kam ftuar, nuk kam ftuar 50, tha kam ftuar 15. Por e pranon që e ka bërë këtë gjë, domethënë. Gjithashtu, ai e pranoi që i ka dhënë një intervistë gazetës Mladina dhe Gazetës Shqiptare.

Kështu që relevanca e këtij dokumenti që pretendohet se e ka burimin nga shërbimi informativ, është e rëndësishme për provat tona, edhe është e rëndësishme për të vërtetuar që UÇK-ja bënte gjurmimet e veta edhe përgatiste raporte lidhur me to.

Pra, nuk kemi, nuk kemi nevojë ta pranojmë përmes mocionit jogojor, mund ta pranojmë dhe përmes dëshmitarit këtë dokument sepse plotëson të gjitha kriteret përkatëse për t'u pranuar.

Z. DIXON: [Përkthim] Unë nuk thashë që duhet pranuar përmes mocionit jogojor. Ne e kemi kundërshtuar këtë dokument sepse është kërkuar të pranohet edhe përmes mocionit jogojor.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet kundërshtimi. Do të pranohet dokumenti, sepse përmbush standardet *prima facie* të 138 sa i takon relevancës së vlerës provuese dhe autenticitetit.

Vazhdoni. Na duhet dëshmitari një herë.

Sillni dëshmitarin në sallë.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti U001-5809-U001-5810 --

[Dëshmitari vijon dëshminë]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] -- dhe përkthimi në anglisht do të marrë numrin e provës P02102, dhe klasifikimin e ka konfidencial.

Z. PACE: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Riklasifikojeni.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z. Pace.

Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

PY. Dëshmitar, a e njihni Bajram Mazrekaj nga Vokshi?

PË. Po, Bajram Mazreku ka qenë nji prej komandantëve të Vokshit, të shtabit të Vokshit.

PY. E keni takuar në 1998 ose në 1999?

PË. E kam taku në 1998. Më duket në korrik 1998.

PY. Flasim për diçka tjetër tani.

Z. PACE: [Përkthim] Shohim sërish librin e dëshmitarit në ekran. Me numër U002-3041-U002-3143, dhe përkthimin në anglisht me numër U002-3080-U002-3141-ET. Të shohim faqen U002-3116.

Duhet të jetë faqja 76 më duket tek shqipja, në PDF. Mund ta kemi edhe gabim sidoqoftë. Jo, është 75. Në anglisht 37 në PDF.

PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër e librit tuaj, do lexoj nga fillimi i faqes tek anglishtja.

Z. PACE: [Përkthim] E zmadhojmë, ju lutem, dhe ju lutem Sekretarit të më ndjekë edhe mua me leximin. Do të fillojmë me këtë, "Sa i përket çmobilizimit". Në shqip është në të majtë. Po. Fillojmë leximin.

PY. Po lexoj disa paragrafë dhe pastaj do t'ju bëj pyetjet.

"Sa i përket çmobilizimit tim, mund të them se ndodhem në disa rrethana jo fort të këndshme për mua, sepse siç thashë nuk më priti urdhri për angazhim të caktuar decidiv, në ndonjë detyrë qysh kur isha në Shqipëri. Unë nuk u largova nga lufta. Iu bashkëngjita Brigadës 138 "Agim Ramadani". Bisedova me Bislim Zyrapi që asokohe ishte në Kukës. Mirëpo, edhe ai kishte do probleme të natyrës së tillë. Një ditë para futjes së trupave të NATO-s në Kosovë, pra pasi u nënshkrua marrëveshja në Kumanovë, Bislim Zyrapi më tërhoqi nga Kosharja dhe me urdhër të tij shkova në Kukës.

"Bislimi kishte planifikuar që me helikopterin e parë nga Shqipëria kur erdhën oficerët anglezë në Shtabin e Përgjithshëm të vija dhe unë. Detyrat dhe motivet nuk i di, por në bisedë telefonike me shefin e Shtabit të Përgjithshëm Agim Çeku (erdhi në prill dhe u bë shefi i shtabit), ai

refuzoi futjen time dhe të Shaban Musliut me helikopterin anglez. Prandaj, unë mbeta në Kukës.

"Forcat e NATO-s u futën në Kosovë dhe unë e luta Fadil Demirin që të më dërgonte deri në Gjakovë. Nëpër Dobrunë të Hasit dhe Qafë të Prushit unë u futa në Gjakovë tri-katër ditë pas vendosjes aty të forcave italiane. Në Gjakovë secili kishte detyrën e vet.

"Shkova tek Ramush Haradinaj dhe ai më tha se nuk kishte kompetenca për të më dhënë detyra të tjera ngase unë isha i Shtabit të Përgjithshëm. Ai kryente detyrat e veta ushtarake në terren.

"Në Gjakovë qëndrova disa ditë. Aty secili punonte punën e vet. Ndihmova pak në organizimin civil në mbrojtjen e fabrikave. Pata një emision për Radio Gjakovën dhe me një fjali filloi puna e përditshme. Erdhi Mensur Kasumi pastaj nga Shtabi i Përgjithshëm (Mensuri ishte bashkëluftëtar i imi që nga Kroacia, ai ishte bashkëluftëtar i Fehmi Lladrovcit, dhe kishin luftuar bashkë në Bosnjë, dhe erdhi në Kosovë me Bislim Zyrapin në zonën operative të Shalës), dhe ai më tha se po bëhej një riorganizim i Shtabit të Përgjithshëm, dhe se ai nuk kishte dëgjuar asgjë të ishte thënë për përfshirjen time. Unë fola atë mbrëmje me Mensur Kasumin gjatë e gjerë për jetën tonë, njohjen tonë që nga shtatori i 1991, në njësitin e Gospiqit. Atë ditë i shkrova kërkesë për çmobilizim. Urgjentisht kërkova të demobilizohesha brenda shtatë ditësh,

dhe i dhashë kërkesën Mensurit që t'ia jepte ai Shtabit të Përgjithshëm."

Tani do t'ju lexoj në të njëjtën faqe rreshtat e fundit dhe pastaj kam disa pyetje.

Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, në anglisht zmadhoni rreshtat e fundit, ndërsa në shqip duhet të jetë pjesa tjetër e faqes. Po, këtu.

"... praktikisht u demobilizova nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës më 1 korrik të 1999. Shtabi i Përgjithshëm thjesht nuk më ftoi për ndonjë bisedë apo për ndonjë, as më ftoi as në takime as në bisedë. Kjo nuk është me rëndësi, por unë u çmobilizova, shkova tek familja ime në Slloveni, pastaj shkova në kontrollim të plagëve në Mainz, afër Frankfurtit në Gjermani, dhe në muajin gusht tërhoqa familjen time nga Sllovenia dhe u sistemova në Prizren. Kjo është e tëra."

Tani, Dëshmitar, pyetja ime e parë kjo: Nga fillimi kur lexuam, ju keni thënë që Bislim Zyrapi kishte probleme të një natyre të ngjashme. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues cilat ishin këto probleme të natyrës së ngjashme?

PË. Ai kishte përgatit, sa di unë, do të thotë, kishte përgatit edhe ishte prej fillimit në përgatitjen dhe udhëheqjen e operacionit Shigjeta, pjesa e Pashtrikut, se në operacionin Shigjeta hynte dhe Brigada 138 që veç ishte në Koshare. Edhe disa ditë para se të planifikonte Bislimi me e thy frontin, qysh më pat thanë Bislimi, ma pat interpetu

Bislimi, erdhën Fatmir Limaj dhe Hysni Syla dhe e morën komandë mbi atë sektor. Dhe kjo ishte nji pakënaqësi e Bislimit që ai u tërhoq në Tiranë fillimisht, pastaj u kthy prapë në Kukës.

Dhe kjo ishte ai problemi që edhe ai mendonte të demobilizohej prej UÇK-së që ashtu edhe u bë. Nuk di për, duhet të ishin këto, këto ishin, këto problematika.

PY. Në tekstin keni thënë që Agim Çeku e refuzoi, ju refuzoi ju dhe Shaban Musliun, pse?

PË. Unë nuk e di çfarë detyre kisha pas unë po të isha shku në Shtabin e Përgjithshëm, çfarë porosie kam pas me dërgu, por vetëm e di që Agim Çeku ka thanë jo s'kemi nevojë për ata të dy, por ka kërku disa uniforma sa di unë, dhe uniforma të reja dhe ku di unë diçka tjetër, dhe ashtu u bë pra, po. Unë kam shku në Kukës për të shku në Shtab të Përgjithshëm.

PY. Në këtë tekst, po e keni thënë dhe gjatë dëshmisë më herët, keni përmendur Mensur Kasumin. Me sa keni ju dijeni, çfarë roli kishte Mensur Kasumi në UÇK?

PË. Mensur Kasumi ka qenë fillimisht në zonën operative të Shalës. Dhe kur ka ardh në Gjakovë më viziton, për çka bëhet fjalë edhe këtu në libër. Ai thonte që është në Shtab të Përgjithshëm, por nuk e di çka. Nuk më kujtohet çfarë pozite ka pas. Dhe më pat tregu që po riorganizohet Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, tash mbas luftës.

PY. A e ke takuar Mensur Kasumin kur ke qenë në Shtabin e

Përgjithshëm në nëntor të 1998, janar të 1999, e ke takuar ose ke pas ndonjë komunikim me të?

PË. Jo, s'kam pas komunikim. Ai ka qenë në zonën operative të Shalës dhe nuk di çfarë funksioni ka pas.

PY. Me sa keni ju dijeni, a kishte ndonjë nofkë apo pseudonim Mensur Kasumi në 1998 ose në 1999?

PË. Jo, nuk më kujtohet.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më ka ngelur dhe shumë pak minuta. Do përfundoj leximin e tekstit, është rreshti i fundit në faqen 3166 [Sipas përkthimit] dhe kalon më pas tek faqja 3177.

Ju lutem ta zmadhoni rreshtin e fundit tek faqja e anglishtes dhe në shqip besoj. Po vijoj leximin dhe i lutem Sekretarit të seancës të më ndjekë me lexim.

PY. "Në mesazhin e largimit, Ramush Haradinaj -- më falni, përpara të gjithëve, më provokoi për arsyet e mia, më nxiti me arsyet e mia të çmobilizimit. Ai tha se unë po çmobilizohesha për shkak të disa mosmarrëveshjeve me kreun udhëheqës të Shtabit të Përgjithshëm. Unë pastaj dhashë arsyet e mia sepse kisha mbetur i pasistemuar. Thashë se mbeta i pasistemuar kryesisht për shkak të prononcimeve të mia gjatë luftës që ndoshta ka rënë ndesh me qëndrimet e udhëheqësisë politike të UÇK-së e jo për çështje ushtarake."

Tani po lexoj paragrafin e pestë ku thotë "Arsyeja e tretë ..."

"Dhe arsyeja e tretë pse jam prononcuar (nuk do çoja -- nuk do ndryshoja asnjë deklaratë të timen edhe sot e kësaj dite) është se unë doja që të shprehja vendimet që kanë dëmtuar luftën dhe ka dëmtuar krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë doja të informoja opinionin publik shqiptar, qoftë opinionin politik dhe ushtarak, se këto nuk ishin vendimet e mia, por se ishin vendime të të tjerëve. Unë isha një oficer dhe unë doja ta hiqja fajin nga vetja."

Dëshmitar, a ju kujtohet t'i keni thënë këto gjatë intervistës që është përfshirë në librin tuaj?

PË. Po.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam më pyetje për dëshmitarin, por dua të kërkoj pranimin e faqeve të librit, nëse më lejoni.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Po, z. Pace.

Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e librit të dëshmitarit që e kam përdorur dje dhe sot gjatë pyetjeve të mia. ERN-ja e librit në gjuhën shqipe është U002-3041-U002-3143 dhe kërkojmë pranimin e faqeve të librit për të cilat kemi dhe përkthimin në anglisht në listën tonë të provave materiale, dhe bëhet fjalë për faqen 3041, 3045, 3080, 3141.

Libri ka 111 faqe në shqip, por ne kërkojmë pranimin e vetëm 67 faqeve të librit. Pesë faqe janë ballina, janë dhe faqet kryesore, janë faqet e para të librit që s'kanë ndonjë

farë përmbajtjeje. Dëshmitari ka dhënë vërtetësinë e librit, ka thënë edhe ku mund të kishte ndonjë ekzagjerim në këtë libër, edhe ka dhënë informacione shtesë gjatë dëshmisë së tij që plotësojnë pjesë të caktuara të librit përkatësisht në faqet që i treguam dje edhe sot.

Pjesët që nuk i kemi treguar dëshmitarit kryesisht ishin për çështje të kufizimit të kohës, janë të nevojshme sidoqoftë për të dhënë kontekst më të plotë për këtë Dëshmitar, dhe janë po ashtu relevante për besueshmërinë e këtij dëshmitari dhe për çështjen e ZPS-së, veçanërisht për rolin që ka pasur dëshmitari në UÇK, formimin dhe strukturën e UÇK-së, pjesëmarrjen e UÇK-së në beteja, organizimin e UÇK-së në veprimtari në zonën operative të Dukagjinit, negociatat e Rambujesë.

Dhe kjo është në përputhje me konstatimet që bëri Gjykatësi Mettraux gjatë Konferencës për Ecurinë e Çështjes më 19 shkurt 2025, sa i takon pranimit të librave nga ana e ZPS-së.

Ky ishte argumenti im.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime për librin?

Z. DIXON: [Përkthim] Të na sqaroni dhe një herë ju lutem numrin e faqeve. 67 faqet që kërkojnë të pranohen janë faqet në anglisht dhe në shqip, këto faqe kërkoni të pranohet apo kërkoni të pranohet i gjithë libri në shqip? Se nuk e kuptuam.

Z. PACE: [Përkthim] Janë 67 faqe që janë përkthyer. Dhe ne duam që të pranohen këto 67 faqe në anglisht dhe në shqip. Pra, nga 111 faqe që ka libri, ne kërkojmë pranimin e vetëm 67 faqeve.

Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Libri pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të lexoj numrat edhe një herë për të kuptuar nëse janë të sakta. U002-3041 deri në U002-3045, dhe U002-3080 deri në U002-3141, si përkthimi në anglisht dhe faqet përkatëse në shqip, do të marrin numrin e provës materiale me numër P02103. Dhe mund të, dhe është e klasifikuar si konfidenciale tani.

Z. PACE: [Përkthim] Mund të jenë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të riklasifikohet si publike.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Patjetër, do ta riklasifikojmë si publike, z. Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, do të ndjekim të njëjtin rend për Mbrojtjen. Kur të jeni gati mund të filloni atëherë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

PY. Mirëdita, z. Maloku. Më quajnë Luka Misetic.

PË. Mirëdita. Më vjen mirë, faleminderit.

PY. Jam avokati mbrojtës i z. Thaçi dhe kam disa pyetje për ju. Në fillim dua t'ia nis me disa pyetje lidhur me të shkuarën tuaj. Jeni kyçur në UÇK në mars të vitit 1998, nuk është se u ndoq ndonjë proces zyrtar për kyçjen tuaj në UÇK, kështu?

PË. Jo, ishim vullnetarë të gjithë.

PY. Dhe askush nuk duhej të jepte aprovimin e vet për kyçjen tuaj në UÇK, kështu?

PË. Jo. Kështu është, po.

PY. E kam kuptuar saktë që ju nuk hasët në asnjë pengesë për kyçjen tuaj në UÇK për shkak të faktit se ishit oficer profesional, oficer karriere?

PË. Jo, nuk kisha ndonjë problem. Vetëm ato që i thashë fillimisht. Kishte disa rezerva, ato janë spjegu. Të disa individëve, keni parasysh tash ato, ishin normale në atë kohë.

PY. Ta shohim pak këtë një çast.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të nxjerrim në ekran pjesët e librit që tani kanë numrin P2103. Po kërkoj faqen në anglisht, 002-3086, e njëjta dhe në shqip. Po, kjo është faqja në anglisht. Edhe në shqip, ju lutem. Në rregull.

PY. Ka një paragraf këtu, z. Maloku, që thotë --

PË. Po.

PY. -- do filloj të lexoj paragrafin:

"LKÇK-ja mendonte se ishte më e fortë se UÇK-ja. Mendonim se kishim më tepër ushtarë, dhe kërkonim [Sipas përkthimit] që

fillimisht të bëhej bashkimi i saj" --

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të nxirrni faqen në anën tjetër në shqip. Po, kjo është. Pra, thuhet:

"Në LKÇK mendonin se ishin më të fortë se UÇK-ja. Mendonin se kishin më tepër ushtarë dhe kërkonin që fillimisht të bëhej bashkimi politik i këtyre strukturave ushtarake, e pastaj edhe bashkimi ushtarak në terren. Unë ua prezantova të gjitha palëve në bisedime, se ne oficerët ushtarakët shqiptarë përkrahim luftën e jo këtë apo atë formacion ushtarak, apo edhe politik.

"UÇK-ja në atë kohë nuk mendonte të kishte një komandë të përbashkët komandimi me LKÇK-në, por që formacionet ushtarake të LKÇK-së të shkriheshin në UÇK. Edhe pse unë kontaktoja hapur me të gjitha palët, pra me përfaqësuesit e UÇK-së, të LKÇK-së dhe ata të Këshillit për Mbrojtjen Kombëtare, megjithatë te të gjithë ata dukesha si i dyshimtë në qëllime dhe në kërkesa."

Pyetja e parë që kam është: A na e përshkruani, ju lutem, se për cilat grupe e keni fjalën pikërisht kur flisni për UÇK-në, LKÇK dhe Këshilli për Mbrojtjen Kombëtare? Çfarë grupesh ishin këto, cilat ishin?

PË. Në fillim, ka pas dy formacione ushtarake në terren në Kosovë. Ka pas nji formacion ushtarak i organizuar nga Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, nga LKÇK-ja, dhe nji formacion ushtarak nga UÇK-ja. Ato të dyja i kishin

përfaqësuesit e vet në Tiranë. Kishte edhe vija furnizimi. E LKÇK-së shkonte ma tepër kah Kukësi. Ilir Konushevci i furnizojke të dy palët, pra ishte qëllimi veç me fut armë në Kosovë.

Në takimin në paragrafët para kësaj të këtij libri, unë e shpjegoj që në takimin në Zagreb me oficerët shqiptarë në Opati që u ktheva pas dy javëve në Tiranë, dhe i njoftova për krejt problematikën, Agim Çeku dhe të tjerët posaçërisht Agim Çeku, më këshilloi që të takohesha me Sejdi Veselin i cili ishte përfaqësues i LKÇK-së në Tiranë dhe t'i thoja që duhesh tash në fillim të bëhet bashkimi i krejt forcave ushtarake të rezistencës, të krejt lëvizjeve të rezistencës në Kosovë, për shkak se nëse lejohen këto të zhvillohen paralelisht ma shumë, atëherë mund të vjen problematika sikur që i kemi pa në Kroaci me Paragën edhe ato, por edhe në Bosnjë.

Po kjo ishte, unë, kjo ishte një farë roli im që të bisedoj me të gjithë dhe t'jua spjegoj problematikat që mujn me u zmadhu në të ardhshmen në qoftë se nuk krijohet ky bashkim. Nuk jam i vetmi unë që kam ndiku në këtë, por ai bashkim ka ndodh gjatë muajit mars, prill 1998, dhe më kurrë s'ka pas problem. Dhe kurrë s'ka pas më formacione që janë thirr si formacione LKÇK, por vetëm UÇK. Unë kam qenë ndoshta nji shumë i vogël në atë drejtim, ka pas edhe të tjerë të cilët janë kyç në atë, me atë përpjekje.

PY. Në rregull. Kur përmendni pra, Këshilli për Mbrojtjen

Kombëtare, për kë e keni fjalën këtu?

PË. Ai ishte nji këshill i cili ishte formuar në Tiranë para luftës në Kosovë, dhe që financohej nga qeveria e Kosovës. Mendonte ai Këshill që duhet me qenë ai kupola e organizimeve ushtarake në Kosovë si këshill kombëtar. Ata nuk kishin formacione ushtarake në terren, pra nuk ishin prezent me formacione ushtarake në terren, nuk ishin prezent me bazat të logjistikës, nuk kishin financime logjistike. I kishin disa oficerë, Fuad Ramiqi e të tjerë, por që edhe me ta na rrishim. Pra, oficerët rrishim të gjithë bashkë. Nuk kishim ndonjë dallim mes vetes.

PY. Do t'ju lutesha që të na jepni emra për secilin prej grupeve. Pra, për momentin që flasim tani përfaqësuesit e UÇK-së, të LKÇK-së dhe të Këshillit për Mbrojtjen Kombëtare, për cilat persona konkretisht me emër, e mbiemër e keni fjalën, pra kush përfaqësonte UÇK-në, kush përfaqësonte LKÇK-në, dhe kush përfaqësonte Këshillin për Mbrojtjen Kombëtare në Tiranë asokohe?

PË. Prej UÇK-së, më dihet. Ishte Bislim Zyrapi nji lidhje e të gjithë neve oficerëve me nji shtab. Aty e kam shpjegu. Për LKÇK-në nga LKÇK-ja ishin ardh Agim Ramadani, Hafir Hoxha edhe Xhafer Gashi nga Zvicra, dhe e kishin bo kampin e parë për ushtrimin e ushtarëve në Dajti. Ndërsa Këshilli Kombëtar ishin Fuad Ramiqi, Gani Buqinsa, Ibrahim Shala. Por vetëm Fuadi ishte ushtarak, e të tjerët ishin persona që ishin ma tepër

politikë.

PY. Po në këtë paragraf ju thoni, pra identifikoni të tri grupet dhe thoni që:

"... u dukesha si i dyshimtë te të gjithë ata në qëllime dhe në kërkesa."

Nuk besoj, nuk po thoni që edhe Bislimit, i dukeshit i dyshimtë edhe Bislim Zyrapit?

PË. Po jo. Jo Bislimit, por kur një njeri bisedon me të gjithë, unë këtë e mora prej Agim Çekut, këtë kërkesë, që të vej kontakte me të gjithë. Dhe normalisht se kur bisedon me të gjithë, dhe unë isha i hapur, bisedojsha nëpër kafene në Tiranë. Nuk kisha kurrfarë roje, nuk kisha kurrfarë, nuk ishin takime të fshehta, dhe unë mendoja që po ju dukesha atyne si, çka është ky njeri tash që bisedon me të gjithë, a po më kupton.

PY. Në rregull.

PË. Këto problematika, avokat, i kanë pas të shprehura edhe në Kroaci në fillim. Unë kam qenë nga fillimi, nga 3 shtatori i kyçur në luftën në Kroaci. Por në Bosnjë kanë pas problematika edhe ma të mëdha. Përvoja e jonë e të gjithë ushtarakëve shqiptarë në Kroaci dhe posaçërisht në Bosnjë, na ka detyrue që ne me bo përpjekje dhe me u kyç edhe vetë në, që në këto fillime mos të ketë organizime ma të mëdha ushtarake, mos të dalin formacione të pavarura ushtarake, por të bëhet bashkimi i forcave ushtarake se ishte shumë me rëndësi që

fillimi të fillon mbarë. Pra, që të është një Ushtri Çlirimtare e Kosovës, me nji emblemë, edhe që të mos ketë probleme të cilat i kanë pas shtetet e tjera.

PY. Ju kuptova. Kur keni hy në Kosovë, UÇK-ja ishte organizuar nëpër grupe të vogla, kështu është?

PË. Nëpër grupe të vogla ishte në Kosovë, po. Por vinin vullnetarë shumë.

PY. Dhe TPNJ-së i keni thënë, dhe kjo është në provën materiale P02087.3 në faqen 15, se:

"Asokohe ishte e pamundur që të kishte një komandë qendrore."

Kështu është?

PË. Po. Në ato -- them për fillimin, pra them për marsin, prillin, sa isha unë. Ishte e vështirë. Na kemi bo këtu shifet, kemi bo takime edhe me Bujar Bukoshin, por ka qenë kërkesa e oficerëve, gjithnjë e oficerëve që ishim ardh. Edhe në rrugën e LKÇK-së, edhe UÇK-së, edhe të pavarur, por ishte kërkesa jonë me u taku të gjithë ne, edhe me qeverinë, në mënyrë që të krijohet nji unitet dhe mos të lejojmë që të krijohen formacione të pavarura dhe me linja të ndryshme komandimi brenda territorit të Kosovës.

PY. Po. Dhe pasi keni hyrë në Kosovë, keni mbërritur në Smolicë, kështu?

PË. Po -- jo, në morinë fillimisht, dy ditë, dhe pastaj në Smolicë.

PY. Dhe pasi keni mbërrit, i keni mbledh banorët aty dhe ju keni thënë që po jepni ndihmën me organizu UÇK-në në atë zonë, kështu?

PË. Po.

PY. Dhe kemi ngritur një qendër stërvitore të UÇK-së aty?

PË. Po.

PY. A është e saktë se këtë e keni bërë me nismën tuaj, pa marrë urdhër nga askush nga UÇK-ja për të bërë këtë?

PË. Unë e gjeta shtabin e Smolicës aty, Hasan Hasani ishte komandant shtabi. Banorët ishin të armatosur, të fshatit, edhe unë propozova që të krijohet kampi i stërvitjes, për shkak se të nesërmen e qëndrimit tim aty i rreshtova të gjithë ushtarët e Smolicës. I ndava në anën, në njërën anë të gjithë ata që nuk kanë pas, nuk kanë kry shërbimin ushtarak në ish-armatën jugosllave. Në anën tjetër ata të cilët kishin kry shërbimin ushtarak, dhe propozova që për këta të cilët nuk kanë pas kurrfarë njohurie ushtarake, me u krijue kampi për stërvitjen e tyre. Dhe i krijuam dy segmente të stërvitjeve. Unë ato me grupin ma të madh ushtrimet dhe njohuritë fillestare, ndërsa Afrim Basha i cili kishte përvojë nga lufta në Kroaci dhe në Bosnjë, ai e merr nji njësit për veprime të shpejta, nji njësit special ma të veçantë me djem të rinj dhe që kërkonte stërvitje ma kërkuese fizikisht.

Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të nxjerrë dokumentin me numër P02090.2 në ekran, në faqen 15 në anglisht

dhe në shqip.

PY. Z. Maloku, do t'ju tregoj një pjesë të intervistës që i keni dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem në faqen -- jo, duhet të jetë Pjesa 2. Ah, ju kërkoj ndjesë, ju kam lexuar numrin e gabuar. Është P02090.3, që është Pjesa 2 e ZPS-së, është faqja 15 në të dy versionet.

PY. Z. Maloku, do fillojmë në numrin 7 -- në rreshtin 17, në shqip, është rreshti 15 në anglisht. Ndjesë. Po, faqja 15, rreshti 17, dhe faqja 15, rreshti 15 në anglisht [Sipas përkthimit]. Pyetja që ju bëhet:

"Kur hytë në Kosovë në prill 1998, te kush raportuat?"

Ju jeni përgjigjur:

"Nuk raportova tek askush. Vetëm Bislimi e dinte që unë po shkoj në Kosovë.

"PY. Kur ngritët programet stërvitore, te kush raportuat?

"PË. Unë nuk raportoja tek askush. Unë isha rangu më i lartë -- isha rangu më i lartë dhe ushtari më i kualifikuar në rajon.

"PY. Pra, kush raportonte te ju në atë kohë, duke qenë se ishit rangu më i lartë?

"PË. Është e vështirë që ju ta kuptoni këtë. Ky ishte rebelim i popullit. Fshatrat po organizoheshin. Në Smolicë unë gjeta një si bazë, një shtab, dhe Hasan Hasani ishte komandant

i shtabit të Smolicës dhe ishin disa ushtarë që morën armët. E kjo atëherë duhet të organizohej në një farë mënyre."

Pra, ju këtu po thoni se nuk i keni raportu askujt. Atëherë çfarë lloji marrëdhënieje kishit ju me Hasanin e përmendur këtu që mbërritët edhe ngritët këtë program stërvitor?

PË. Hasani ishte komandant shtabi aty. Unë shkova si oficer profesionist. Afrim Basha edhe ai ishte oficer i luftës në Kroaci edhe në Bosnjë. Dhe ata ishin të gëzum që dy ushtarakë po vinin në ato fillet e ngritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë rajon. Por ata ishin, na pritën shumë mirë, se ishte, erdhën dy njerëz të cilët do të na mësojnë për me luftu. Ishin populli, mbledhshin armë. Fshatrat shkonin në Shqipëri armatoseshin, pra. Ishin të vetmit oficerë ushtarakë që erdhën në atë rajon. Ishte nji --

PY. Ta bëj ndryshe pyetjen. ZPS-së i thoni se nuk kishit një epror sipër jush të cilit t'i raportonit. Por ky ju raportonte juve, apo asnjëri prej jush nuk i raportonte njëri-tjetrit?

PË. Unë e kryjsha punën time. I stërvitja ushtarët. Ndihmojsha në ngritjen organizative të ushtrisë, të ushtarëve, ngritjen profesionale të ushtarëve. Së pari Smolicës, kur dëgjun fshatra të tjera filluan të vijnë djemtë e atyne fshatrave, dhe të vazhdojnë stërvitjet, të stërviten edhe ata. Edhe ashtu që fillun të zgjerohet territori edhe duke formu pastaj shtabet e fshatrave, Stubëll, Berjah, Nevokaz, Dobrosh,

Nec, Ramoc. Po të gjitha ato fshatra, derisa morëm Junikun.

PY. Do t'i kthehem kësaj pas pak. Por, Hasani ju raportonte a jo?

PË. Nuk kishim lidhje komandimi, raportimi, ishim duke, ishte populli duke u vetëorganizu. Ishin të tanë vullnetarë, ishin vullnetarisht vijshin nga fshatrat e tjera njëherë me u trajnu aty, dhe pastaj me shku me i marrë armët dhe e ngrit shtabin e fshatit.

PY. Ju sapo e përshkruat dhe i dolët para pyetjes time. Pra, si u zgjerua kjo nga prilli deri në qershor të 1998, ku secili prej këtyre fshatrave ka ngrit njësite të veta.

PË. Edhe shtabin e vet. Edhe shtabin e fshatit, secila.

PY. Atëherë, TPNJ-së i keni dhënë --

Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe e kam fjalën për dokumentin me numër P02087.2 në faqen 12 në anglisht.

PY. Pra, shprehimisht i keni thënë TPNJ-së -- po citoj, pra ju bëhet pyetje se:

"Çfarë linje komandimi e kishit?

Dhe ju jeni përgjigjur:

"Kisha kujtuar se isha në UÇK, por s'kisha një komandant sipër meje, isha i pavarur."

E saktë është kjo?

PË. Po. S'kishim komandë. Ishte, ngrihej Ushtria Çlirimtare nga poshtë, nga fshatrat. Unë ndihmoja me u organizu shtabet.

PY. Dhe tani që flasim për krijimin e nënzonave, i keni thënë

ZPS-së që ju u caktuat zëvendëskomandant nga komandantët e fshatrave, kështu?

PË. Po. Pasi ka ardh Sali Veseli në fund të majit, është shpjegu edhe në pyetjet e mahershme. Pasi ka ardh Sali Veseli në fund të majit, janë taku 20 shtabet, 20 komandantët e shtabeve të 20 fshatrave në Dobrosh edhe aty është vendos me u organizu, me u zhvillu tash, ushtarakisht thuhet me u zhvillu brigada. Dhe aty jam zgjedh unë zëvendëskomandant prej fshatrave, prej komandantëve të shtabeve të fshatrave.

PY. Këta komandantë vetë ishin caktu prej fshatarëve, apo jo?

PË. Sigurisht.

PY. Pra, do të ishte e saktë në qoftë se do thoshim që e gjithë organizata ishte krijuar nga poshtë lart?

PË. E gjithë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe krejt territoret e Kosovës, është kriju në qetë formë, nga poshtë lart.

PY. Zona e Dukagjinit në vetvete --

PË. Po.

PY. -- i keni thënë ZPS-së në dokumentin numër p02090.3, faqja 16, është krijuar në qershor të 1998, është e saktë?

PË. Po, saktë. Pasi u kriju brigada në Junik, komandant i brigadës Sali Veseli që ishte i Smolicës, pra ishte aty i atij rajoni, dhe ishte oficer ma madhor se unë. Ai ishte me akademi të lartë ushtarake të kryme. Ai vetëm i dha urdhrnat për emërimin e komandantëve të batalioneve dhe shkoi në Gllogjan,

ishte shtabi i Gllogjanit. Ku rreth atij shtabi ishin 40 shtabe të fshatrave, dhe aty ai vendosi me e organizu tash zonën operative. Ai u zgjodh shef i shtabit të zonës.

Pra, i njëjtë sikur 20 fshatra këtu, tash ai i tubon. Komandantët e shtabeve të 40 fshatrave që ishin rreth Gllogjanit, edhe nis me ngrit komandën e zonës operative, që në atë kohë e quajshim rajonit të Dukagjinit.

PY. Dhe nuk ishit në dijeni të ndonjë urdhri nga ana e Shtabit të Përgjithshëm për të krijuar zonën e Dukagjinit, kështu?

PË. Unë nuk njof që ka pas Shtab të Përgjithshëm. Po ju them qysh ka shku organizimi i ushtrisë edhe në krejt Kosovën. Pra, 20 fshatra e formun brigadën dhe u zgjodha unë zëvendëskomandant. Shkoi Sali Veseli si njeri ma i aftë për ngritje operative të ushtrisë, që kishte ardh deri atëherë në Kosovë. Pra, deri në atë moment. Ai ishte oficeri ma i lartë dhe ma i zoti që kish hy në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në terren. Ai shkoi tash me formu në të njëjtën mënyrë në Gllogjan, pra me ngrit 20 fshatrat tona edhe 40 fshatrat e rreth Gllogjanit bëheshin 60 fshatra. Ishte një territor i mjaftueshëm me u ngrit si zonë operative.

PY. I ke thënë ZPS-së, dhe është në P02090.3, në faqen 9, dhe po citoj:

"Nuk kemi marrë urdhra nga Shtabi i Përgjithshëm edhe kur kam qenë aktiv. Nuk më kujtohet të kem marrë ndonjë prej

urdhrave."

Pra, nga momenti kur keni hy në Kosovë, e deri së paku kur jeni lënduar nuk ju kujtohet të keni marrë asnjë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm, kështu?

PË. Z. Avokat, urdhrin e parë që unë e kam marrë nga nji autoritet në Shtab të Përgjithshëm është urdhri kur jam lëviz nga drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm, në Zonën Operative të Dukagjinit që kjo ka ndodh në janar 1999. Pra, urdhri i vetëm që unë e kam marrë. Unë i kam thanë edhe ZPS-së. Nuk mundeni me i kuptu këto. Është vështirë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është ngrit nga poshtë-lart. Nuk ka pas urdhra. Ka pas votime me gisht, propozime, pajtime që Naim Maloku me qenë zëvendëskomandant. Pajtime që Ramush Haradinaj 40 fshatra me qenë komandant zone. Pra, nuk ka pas urdhra, ndërtim të strukturës nga lart-poshtë.

Unë, e tërë nuk kam pas kurrfarë probleme gjatë intervistave të mia. Vetëm kam dasht që me u institucionalzu. Pse? Që me pas institucioni me u marrë. Unë jam ushtarak. A po më kuptoni? Ma lehtë është për nji ushtarak kur ka urdhra nga lart, dhe i caktohen detyrat, se sa kështu. Pra, nuk ka me u kuptu, është vështirë me u kuptu kjo.

Edhe nji herë po e përsëris. Urdhri i parë dhe i vetëm që unë e kam marrë është kur jam lëviz nga drejtoria operative në Zonën Operative të Dukagjinit. Edhe atë me vullnetin tim se ma së pari më ka pyet, se unë jam vullnetar. Nuk ka urdhra, te

vullnetarët nuk ka urdhra decidiv dhe patjetër me u zbatu. Mu më ka thirr z. Krasniqi në prezencë të Ramush Haradinajt, edhe më ka thanë, "Zona Operative e Dukagjinit po të kërkon. A po don ti me shku?" Pra nëse unë i kisha thanë "jo", nuk ka pas rregullore ose fuqi, askush që me më detyru mu me shku në dikund që unë nuk e marr.

Dhe është vështirë me u kuptu, besomëni, a po kupton? Është vështirë.

PY. E kuptoj. E kuptoj. Faleminderit, Faleminderit për përgjigjen. Do të vazhdojmë pas pushimit të drekës.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani, Dëshmitar, do bëjmë pushimin e drekës. Faleminderit për praninë tuaj këtu. Mos bisedoni me askënd për këtë çështje jashtë kësaj salle. Mund të dilni nga salla me Shoqëruesen e sallës. Do të kthehemi në orën 14.30.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu ndërprerjen e seancës deri në 14.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërkohë mund të sillni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Mund të vazhdoni, z. Misetic.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Mirëdita, z. Maloku.

PË. Mirëdita. Faleminderit.

PY. Flasim për një temë tjetër tani. I keni thënë Prokurorisë se keni pasur disa radio dore që kishin rreze shumë të shkurtër, saktë?

PË. Po. E saktë.

PY. Sa i takon telefonave satelitor në provën materiale P02090.4 në faqen 9, ju keni thënë se keni pasur përdorur një telefon satelitor pas qershorit të 1998 për një periudhë të shkurtër për të kontaktuar me Ahmet Krasniqin, saktë?

PË. Po jo vetëm me Ahmet Krasniqin, por edhe me të tjerë. Neve telefonat satelitor na kanë ardh dikund pas qershorit 1998. Kanë fillu në qershor dhe kanë hy pastaj gradualisht jemi pajisë me ta.

Z. Avokat, nëse më lejoni. Tek telefonat satelitorë, sa di unë, dikun tek në nëntor, dhjetor kemi arrit me i lëshu deri në nivel të komandantëve të brigadave, pra, që me i pas edhe brigadat për me komuniku.

PY. Po. Këtu doja të dilja në fakt. Ju është bërë një pyetje. Do jua lexoj edhe përgjigjen.

PË. Po.

PY. Pyetjet:

"Ahmet Krasniqi që emri i të cilit është në këtë listë u qëllua për vdekje në shtator të 1998, apo jo?

Ju jeni përgjigjur:

"Po, unë kam pasur kontakte me atë që prej Kosovës. Kam qenë në pozita të kisha kontakte sepse pas qershorit për një periudhë të shkurtër kam pas mundësi të përdorë telefon satelitor."

A është e saktë kjo?

PË. Po.

PY. Po. Dhe arsyeja pse e përdorët për një periudhë shumë të shkurtër telefonin satelitor pas qershorit të 1998 është pikërisht sepse në atë kohë Tahir Zemaj dhe oficerë të tjerë erdhën në Dukagjin, apo jo, prandaj e përdorët për periudhë kaq të shkurtër?

PË. Jo, se unë u plagosa më 25 korrik 1998, unë u plagosa rëndë. Tre muaj e gjys pastaj unë nuk kisha nevojë për telefon satelitor. Kishin nevojë për shërim dhe për strehim, pra, s'kisha unë, s'kisha nevojë për të.

PY. Po. Mbase u keqkuptuam. Unë po them këtë sipas asaj që i keni thënë Prokurorisë, ju e keni përdorur telefonin satelitor pas qershorit dhe e keni theksuar keni thënë "për një periudhë të shkurtër".

PË. Po.

PY. Dhe unë po them nga fundi i qershorit e deri kur u plagosët ju në 15 korrik keni pas mundësi --

PË. Po, po. Po.
PY. -- ta përdornit telefonin satelitor --
PË. Po, e kemi pas. E kemi pas.
PY. -- se e solli Tahir Zemaj telefonin?
PË. Jo, telefonin. Telefonin satelitor ma ka sjellë Muhamet Kelmendi në Smolicë në qershor 1998. Me Ahmet Krasniqin kam fol dikun në qershor 1998 nga telefoni i Tahir Zemës. Unë e kam pas telefonin satelitor timin. Brigada e ka pas. Brigada e ka pas edhe ai telefon ka mbet edhe pasi jam tërheq unë si i plagosur. Nuk po di a jam i qartë.
PY. Po. Në intervistën për TPNJ-në, në deklaratën për TPNJ-në - në provën materiale P02087.2 në faqen 12 - keni thënë se njësitë prej 22 oficerëve dhe 150 ushtarësh ishin nën komandën e Tahir Zemajt dhe veshën uniformën e UÇK-së po linja komanduese shkonte për qeverinë Bukoshi, a është saktë?
PË. Ata erdhën me uniformë të UÇK-së. Nuk kishte të bëjë tjetër formacion. Mirëpo linja, linja e komandimit ishin me Ahmet Krasniqin.
PY. Po. Po ashtu keni thënë në të njëjtën kohë ju besonit se ishin në UÇK, po nuk kishit komandant mbi vete. Keni thënë që ju keni qenë i pavarur, saktë?
PË. Saktë.
PY. Sipas dëshmisë suaj të reflektuar në provën P02087.2 në faqen 16 në anglisht, ju keni thënë që keni mbetur pa linjë, pa zinxhir komandues deri në nëntor të 1998, saktë?

PË. Gjithmonë ashtu e kam kuptu.

PY. Në të njëjtën deklaratë në faqen 17, keni thënë se nga prilli i 1998 kur mbërritët në Kosovë deri kur u plagosët në korrik të 1998, Ramush Haradinaj nuk kishte asnjë autoritet përkundrejt jush, thjesht e respektonit njëri-tjetrin dhe s'ju ka lëshu asnjë urdhër, saktë?

PË. E saktë. Po.

PY. Tani dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me diçka që ia keni thënë ZPS-së. Po i referohem provës P02090.3 në faqen 7, fillon në rreshtin 17 të anglishtes. Ju keni thënë se:

"Si rregull, një zonë operative mund të kërkonte ndihmë nga një zonë tjetër operative që t'i dërgonin njëri-tjetrit forca edhe grupe militantësh."

Saktë?

PË. Jo militantësh, ushtarësh. Më falni, nuk kemi pas ne militantë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë ushtri dhe kemi pas ushtarë. Të gjithë kanë qenë vullnetarë. Kanë ardh me vullnet dhe janë bë ushtarë.

PY. E kuptoj. Po unë citova, po mund të ketë pas një problem përkthimi, domethënë, se kështu është në anglisht militant.

PË. Po. Mund të ndodhë aty. Po, po.

PY. Ju keni thënë që ky komunikim mes zonave ka ndodhur përmes kontakteve miqësore, njohjeve jo formale, saktë?

PË. Ashtu është. Po.

PY. Po pasi u kyçët në Shtabin e Përgjithshëm? A vijuan zonat

të komunikonin drejtpërdrejti me njëra-tjetrën mesa keni ju dijeni?

PË. Unë s'isha -- isha dy muaj tani në Shtab të Përgjithshëm. Po sigurisht, sigurisht zonat kanë komuniku mes vete. Ka pas disa komandantë të zonave, kanë pas ma shumë lidhje miqësore njëni me tjetrin. Për shembull, unë e di, që kur e kam pas sulmin masiv në brigadën e Junikut më kanë ardh në ndihmë prej Gllogjanit dy, tri njësi. Ose kur në Voksh është sulmu Vokshi dhe është ndërpre linja e komunikimit të Vokshit me pjesë tjera të komandës së Gllogjanit, Vokshin e kemi marrë ne brigada, Brigada e Junikut. Dhe i kemi ndihmu atje. Pra, ishte ndihmë por me njësite të vogla. Nuk kemi pas ne, nuk kemi pas ne mundësi me dërgu batalione, kompani, kemi dërgu nga dhjetë ushtarë, 15 ushtarë, 20 që janë ardh në ndihmë kur njëna zonë ka pas probleme. Zakonisht kanë ardh në ndihmë në zonën Operative të Dukagjinit se aty kanë qenë luftime të vazhdueshme gjatë tanë kohës.

PY. Në rregull. Ju keni thënë që në 25 korrik të 1998 u plagosët rëndë.

PË. Po.

PY. Mes 25 korrikut të 1998 dhe fillimit të nëntorit të 1998 nuk keni qenë i përfshirë në veprimtaritë e UÇK-së në Kosovë, saktë?

PË. Kam qëndru në Kosovë duke u shëru por nuk kam qenë i kyçur se s'kam pas mundësi fizike me ndihmu. Kam qenë i

strehum nëpër vende të ndryshme, në familje, maleve.

PY. Okej.

Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të shohim librin tuaj. Vetëm të gjejë pak numrin e provës. Më duket se ka marrë numrin e provës P02103 në faqen U002-3099.

PY. Në libër flisni për periudhën pas ofensivës serbe të verës, pra, bëhet fjalë për shtatorin e 1998 dhe thoni.

"... praktikisht Serbia fitoi, mori 470 fshatra në Kosovë. Rrafshi i Dukagjinit ra. Ramush Haradinaj mbeti me 52 ushtarë. Tahir Zemaj u tërhoq nga Rrafshi i Dukagjinit dhe shkoi në Shqipëri me gjithë ushtrinë e tij.

"Në atë kohë u vra dhe Ahmet Krasniqi dhe në këtë kohë shumë persona në Kosovë mendonin se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte shkatërruar."

Ju kujtohet kjo në libër?

PË. Patjetër.

PY. A është e vërtetë që nga fundi i shtatorit të 1998 kishin ngelur shumë pak njësite të UÇK-së në Kosovë?

PË. Ne, është lista ka qenë me Tribunalin e Hagës për Jugosllavi. 52 ushtarë kanë mbet në Zonën Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj me vëllazën, kushërinj, dajë edhe disa ushtarë, ushtarë dhe dy-tri ushtare vajza kanë qenë. 52 ushtarë është lista atyne ushtarëve që kanë mbet në Zonën Operative të Dukagjinit.

PY. Po. Po unë po ju pyes një pyetje më të përgjithshme. Tani

që të na jepni ju vlerësimin tuaj si ka qenë situata e UÇK-së, gjendja e UÇK-së në shtator të 1998, në fund të shtatorit të 1998?

PË. Po ishte dy muaj, dy, tre, tre muaj ofensivë e pandërpreme në të gjitha territoret. U dogjën 470 fshatra edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte në një gjendje mjaft të vështirë. Disa kanë mendu jashtë që edhe mori fund Ushtria Çlirimtare. Ky është vlerësim i imi. Vlerësimi i imi dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës mbeti në njësite të vogla, jo e tërhequn krejt prej Kosove. Disa janë tërheqë me i strehu familjet jashtë shtetit, jashtë Kosovës, disa maleve. Pra, kanë mbete në njësite të vogla. Nuk kemi pas, nuk kemi pas njësi të mëdha ose linja të komandimit, të komunikimit. Pra, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka mbet e shpërnda.

Unë e jap një intervistë për *New York Times* kur them që të mos befasohet faktori ndërkombëtar që ushtarët po kthehen, për shkak se po kthehen në fshatrat e veta edhe në zonat e veta.

PY. Mirë. Në këtë periudhë kohore kur keni qenë i plagosur ju na e shpjeguat që jeni takuar me z. Thaçi për herë të parë në Prapaqan.

PË. Po.

PY. Në atë kohë, z. Zyrapi ta ka prezantuar z. Thaçi dhe të ka thënë që është Gjarpri, saktë?

PË. Po, po.

PY. Në atë kohë ju nuk e dinit se çfarë pozite kishte z. Thaçi, apo jo?

PË. Jo.

PY. Gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë - dhe në Shënimin Përgatitor numër 1 që ka numrin e provës P02091, në paragrafin 12 - ju thoni se nuk e keni ditur pse ka qenë në Prapaqan z. Thaçi, saktë, nuk e keni dit arsyen?

PË. Saktë. Po.

PY. Dhe ndonëse më vonë keni parë në artikuj gazetash, debate televizive se z. Thaçi pretendohej atje me z. Zyrapin për të larguar Tahir Zemajn, kjo është diçka nuk e keni dëgjuar vetë kur keni qenë në Prapaqan, apo jo?

PË. Jo. Këto kanë qenë artikuj gazetash, informata që qarkullojnë që në 20 vite, që prej pas luftës. Dhe janë dhënë versione të ndryshme. Edhe çka është bisedu edhe si e si tjetër. Po unë atëherë kur isha në Prapaqan nuk e kam dit qëllimin e vizitës tyre në Prapaqan.

PY. Keni diskutuar hollësisht me Prokurorinë disa intervista që keni dhënë në verën e 1998. Dhe sot paradite Prokuroria ju tregoi një të korrikut të 1998 ku kishit thënë që për ju, z. Rugova ose të paktën sipas tekstit, këtë që i keni thënë ZPS-së keni thënë që z. Rugova ishte kryekomandanti i UÇK-së. Kështu?

PË. Po.

PY. Dhe keni diçka të ngjashme dhe për TPNJ-në, ish-

tribunalin. I keni thënë ZPS-së se nuk keni pasur asnjë problem pasi e keni bërë këtë prononcim, apo jo?

PË. Saktë.

PY. Edhe kjo thuhet në provën materiale P0209.4.

PË. Saktë. Saktë.

PY. A është e vërtetë që disa muaj më pas që i takon nga nëntori ju në fakt ju u rritët në detyrë dhe u bëtë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm?

PË. Saktë.

PY. Vazhdojmë tek tema e marrëdhënieve mes UÇK-së dhe LDK-së. I keni thënë ZPS-së se në përgjithësi nuk keni dijeni të ketë pas tensione mes LDK-së dhe UÇK-së në verën e 1998, a është kështu?

PË. Saktë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal kjo thuhet në provën materiale P02090.3 në faqja 3.

PY. Përkundrazi --

PË. Z. Avokat, nëse më lejoni, a bën vetëm dy minuta, ju lutem? A bën?

PY. Patjetër. Patjetër, vazhdoni.

PË. Brigada e Junikut, komandanti i shtabit të fshatit të Junikut ka qenë kryetar i degës LDK-së për Junik. 19 fshatra tjera, komandantët e shtabeve të fshatrave kanë qenë kryetarët e nëndegëve të LDK-së në të gjitha fshatrat. A e besoni këtë? Dhe unë po ju them është e pamundur të ju shpjegohet dhe i kam

thënë edhe ZPS-së, nuk mundni me i kuptu këto. A kupton? Krejt struktura e degës së LDK-së në Junik dhe e nëndegëve të LDK-së nëpër fshatra kanë qenë struktura komanduese e brigadës së Junikut. Qashtu e kemi themelu brigadën. Ata më kanë zgjedhë mu zëvendëskomandant. Ata e kanë zgjedhë Sali Veselin komandant. Nuk ka pas probleme.

Lufta, Kosova ju ka nënshtru luftës speciale. Armiku ka bë luftë speciale prej që është nis UÇK-së viteve 1992. Shërbimet sekrete serbe janë mundu vazhdimisht me kriju konflikt mes UÇK-së dhe LDK-së. Këto është nga jashtë. Jo, është luftë speciale kjo.

Nuk kanë pas probleme. E dhashë shembullin tim. Mundni me pyet Gjykata ku don. Komandanti i batalionit në Junik edhe i shtabit ka qenë kryetar dege, ndërsa të gjitha, krejt struktura e LDK-së në të gjitha fshatrat kanë qenë komandantë të shtabeve të fshatrave. Dhe na i kemi pas vizitë Fehmi Aganin në muajin qershor në Junik, që ka qenë njëriu i dytë në LDK. Më falni. Të lutem.

PY. Faleminderit për sqarimin. Dua të flasim për kohën kur keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm. I thatë Prokurorisë që mesa keni ju dijeni vetëm në nëntor të 1998 u formua, pra, në nëntor të 1998 u formua Shtabi i Përgjithshëm, saktë?

PË. Po. Po unë si ushtarak e kam kuptu që mund të quhet shtabi vetëm prej dhjetorit 1998, nga mbledhja e parë e Shtabit të Përgjithshëm. Prej aty i kam thënë edhe ZPS-së edhe

tash në kohën përgatitore, që unë e konsideroj shtabin prej mbledhjes së parë që u bë. Drejtorët e drejtorive, shefi i shtabit edhe shtatë komandantët e zonave nga mbledhja e parë që u bë në fillim në dhjetor. Unë e konsideroj, unë, si ushtarak, si profesionist, e konsideroj që prej atij momenti ka fillu me funksionu një shtab, që e ka selinë, që dihet ku e ka selinë edhe që komunikon me drejtori operative ka fillu me komunikue me zona operative.

PY. Ju keni thënë që kjo ka ndodhur dikund mes 5 dhe 15 nëntorit kur u kthye Bislim Zyrapi nga Shqipëria bashkë me disa oficerë të tjerë si, për shembull, me Sali Veselin.

PË. Po.

PY. Të kujtohet kjo pjesë që ia ke thënë Prokurorisë?

PË. Po.

PY. Nga e dini ju që Bislim Zyrapi u kthye mes 5 dhe 15 nëntorit?

PË. Po.

PY. Nga e dini ju këtë, nga e dini? Nga e dini që ka ndodhur në këtë periudhë kohore mes 5 dhe 15 nëntorit?

PË. Se e kam taku në Lladrovc atë. Ai është ardh, ka dëgju që jam aty i strehum te dajat e mi edhe më ka taku.

PY. Po nga e dini ju që ai nuk kishte hyrë në Kosovë para 5 nëntorit?

PË. E di se më ka tregu që nuk ka qenë në Kosovë.

PY. Të njëjtën gjë ia keni thënë Prokurorit Publik. Dhe kjo

është në provën P02089. Në faqen SPOE0067218, kur të pyetën:

"Kur është ... formuar Shtabi i Përgjithshëm dhe kush ka qenë komandanti i shtabit?"

Jeni përgjigjur:

"Shtabi i Përgjithshëm u formua dikund mes 10, 15 nëntorit ..."

Ju kujtohet kjo?

PË. 15. Më 15 u thashë datat. Më 15 dhjetor kam shku unë në shtab. Dhe unë e konsideroj si shtab kur u mbajt mbledhja e parë me komandantë të zonave në dhjetor.

PY. Pra, a është e saktë atëherë nëse themi -- më falni. Atëherë a mund të ketë ekzistuar drejtoria e policisë ushtarake para formimit të Shtabit të Përgjithshëm?

PË. Nuk më kujtohet.

PY. Nuk të kujtohet. Të kujtohet kur është formuar po nuk të kujtohet a ka pasur --

PË. Nuk më kujtohet.

PY. -- një syresh më përpara, apo jo?

PË. Nuk më kujtohet a ka pas drejtori të policisë ushtarake në Shtab të Përgjithshëm para dhjetorit 1998.

PY. I keni thënë ZPS-së, në provën P02090.3 në faqen 14, se gjatë kohës me Shtabin e Përgjithshëm, vetëm kur keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm e keni mësuar emrin e z. Thaçi, saktë?

PË. Saktë.

PY. Dhe vetëm atëherë e mësuat që ishte drejtuesi apo shefi i

drejtorisë politike, saktë?

PË. Saktë. Ai u emnue në dhjetor sa di unë.

PY. Edhe një herë, i keni thënë Prokurorit Publik Shtetëror të Kosovës në provën P02089 faqja SPOE00677221, se me sa kishit kuptuar ju -- më falni, do ta riformuloj. Ju është bërë pyetje:

"Çfarë roli ka pasur Hashim Thaçi në 1998-1999?"

Dhe ju u përgjigjët dhe i thatë Prokurorit Publik se:

"Nuk ka qenë në Kosovë pjesën më të madhe të kohës, ka qenë shefi i drejtorisë politike pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe kishte kompetenca për orientimin politik të UÇK-së dhe për kontaktet me ndërkombëtarët."

Kështu?

PË. Po, ashtu ka qenë.

PY. Tani dua të diskutojmë atë që keni diskutuar me Prokurorin sot paradite lidhur me një intervistë që ia keni dhënë, që thatë se ia keni dhënë gazetës Kombi.

Më falni, do ta bëj ndryshe pyetjen. A ju kujtohet që ka pas një mosmarrëveshje në gusht të 1998 -- ose do ta them ndryshe. A ju kujtohet që ka pasur diskutime në gusht të 1998 lidhur me personin që do të përfaqësonte shqiptarët e Kosovës gjatë negociatave me Milosevic?

PË. Po, ka pas disa, disa përpjekje për të unifiku faktorin, faktorin politik shqiptar. Lexohej në gazeta sa isha i plagosun ose në mjetet e informimit që kishte disa përpjekje.

E di që Hill, a ka qenë shef i zyrës apo ambasadori i Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Maqedoni, s'më kujtohet, po ai përmendej shumë që bënte kontakte, kontakte me kriju një unifikim, me u kriju një qeveri e përbashkët, me u bashku spektri politik i Kosovës, komunikimet me UÇK-në.

Pra, ishin përpjekje. Ishin përpjekje ato që të krijohet një trup përfaqësuese e përbashkët e shqiptarëve kështu. Ashtu unë, unë kam mujt me i kuptu nga ato vende ku isha i strehum.

PY. Do t'ju tregoj një dokument atëherë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të vendoset në ekran dokumenti me numër 1D00100, faqja 2 në të dyja gjuhët.

PY. Është një përmbledhje e shtypit nga radio Evropa e Lirë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, kalojmë në faqen e dytë.

PY. Thotë se: "Rugova emëron ekipin negociator ..." Që t'ju orientoj, është një raport i datës 14 gusht 1998, është koha kur jeni plagosë.

"Kryeshtetasi në hije i Kosovës Ibrahim Rugova tha në Prishtinë më 13 gusht se ka caktuar një ekip negociator për bisedime me autoritet serbe. Trupi i ri përfaqëson Lidhjen Demokratike të Kosovës të Rugovës, Demokristianët dhe Social Demokratët. Ai përbëhet nga Fehmi Agani, Fatmir Sadiu, Edita Tahiri, Tadel Radiqi dhe Iliaz Kurtesi. Adem Demaçi dhe Mehmet Hajrizi, të cilët janë të afërt me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ... e refuzuan ftesën e Rugovës për t'ju bashkuar."

"UÇK-ja ka lëshuar një deklaratë për një rithirrje

taktike në përgjigje të ofensivës serbe. Teksti gjithashtu e bën të qartë që ekipi i Rugovës nuk flet për gueriljet, në emër të gueriljeve. Por, në shpalljen e vet UÇK-ja tha se gueriljet i kishin kërkuar Adem Demaçit që të ishte përfaqësuesi i tyre kryesor dhe të hiqte dorë nga pozitat në arenën politike të Kosovës."

Tani a ju kujtohet që UÇK-ja ta ketë emëruar Adem Demaçin në mes të gushtit për të qenë përfaqësuesi i vet në bisedimet me qeverinë serbe?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tani tek prova tjetër me numër P00487-ET.8. Në anglisht është në faqen 2761, është e njëjta faqe edhe në shqip.

PY. Kjo që po ju tregoj është një komunikatë e lëshuar nga Nazif Ramabaja më 17 gusht të 1998.

Z. MISETIC: [Përkthim] Këtu është.

PY. T'i hidhni një sy. Pra, ka dalë nga zona e Dukagjinit dhe do t'ju pyes nëse e njihni këtë komunikatë.

PË. Jo.

PY. A ishit në dijeni se komunikatat lëshoheshin nga brenda zonës së Dukagjinit duke shpallur mbështetje për ekipin negociator të z. Rugova, ndërkohë që kishte një papajtueshmëri midis Shtabit të Përgjithshëm dhe z. Rugova se kush do ta përfaqësonte UÇK-në gjatë këtyre negociatave?

PË. Jo, nuk kisha njohuni të tilla unë për këto komunikata se

janë lëshu në zonë të Dukagjinit.

Z. MISETIC: [Përkthim] Të nxjerrim provën P00914 në ekran, ju lutem, në faqen SPOE00081915 në të dy versionet.

PY. Në ekran po shihni se pas lëshimit të asaj komunikate një ftesë u dërgua nga z. Nazif Ramabaja komandantëve apo shtabeve të fshatrave duke i ftuar ato në një mbledhje më 20 gusht të 1998. Ku ka tre pika. Një është riorganizimi i njësive operative, mbrojtjes territoriale, e dyta është kuadri profesional apo joprofesional, "mendimi juaj" dhe, e treta, përkrahja e vijës institucionale.

A ju kujtohet të jetë zhvilluar një mbledhje më 20 gusht të vitit 1998 në zonën e Dukagjinit?

PË. Sa kujtoj unë, dikun ka 17 gusht, unë me të gjithë të plagosurit e spitalit të Krushevcit jemi transferue në Breshanc të Suharekës. Më kujtohet data 17 për shkak se atë ditë ka vdek edhe Skënder Çeku që u plagos në Loxhë. Edhe kështu që në 17 gusht unë kam qenë i plagosun në Breshanc, pastaj më kanë transferu dhe tërheqë në Kleçkë. Kam qenë i plagosur. Nuk kam dit çka ndodhë në Dukagjin.

PY. Dua t'ju tregoj diçka që ua ka treguar dhe Prokurori sot në mëngjes.

Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, të kthejmë në ekran, ju lutem edhe njëherë provën me numër P02103, ju lutem, në faqen U002-3127 në versionin në shqip, që është faqja 87 versioni në shqip dhe faqja 48 në anglisht. Po.

PY. Thuhet:

"Kosovës i duhet uniteti i faktorëve politikë e ushtarakë."

PË. Po, saktë.

PY. Dhe pastaj në pikën e dytë aty thuhet:

"Në komunikatën e lëshuar nga mbledhja e 21 gushtit, shtabi i Zonës së Tretë Operative për Rrafshin e Dukagjinit kërkoi institucionalizimin e jetës politike dhe ushtarake në Kosovë. A do të thotë kujtohet edhe formimin e qeverisë koalicionit ku do të ishin edhe përfaqësuesit e UÇK-së?"

Dhe ju përgjigjeni:

"Situata është e tillë dhe unë edhe më parë kam kërkuar institucionalizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që do të thotë që UÇK-ja duhet të futet në kornizat e institucioneve shtetërore të Kosovës. Se çfarë qeverie do të formohet dhe si, kjo është çështje e liderëve të të gjitha partive politike. Mirëpo, kërkesa jona dhe mendimi ynë është që UÇK-ja duhet të futet me korniza të institucioneve të Republikës së Kosovës."

Pastaj vijon pyetja tjetër:

"Ç'mendoni për grupin e tij negociator dhe a do të respektojë UÇK-ja ndonjë marrëveshje eventuale midis Prishtinës dhe Beogradit?"

Dhe ju përgjigjeni:

"UÇK-ja së pari duhet futet në kornizat e institucioneve shtetërore e pastaj çdo bisedë e çdo negociatë natyrisht që do

të respektohet nga UÇK-ja nëse është në kornizat e" - dhe ju lutem kaloni në faqen tjetër në anglisht – "institucioneve. E gjithë çështja sipas mendimit tim është se kjo ka mbetur nga udhëheqësit e partive politike dhe mospajtimeve mes tyre."

Pyetje:

"Çfarë mendimi keni ju për përzgjedhjen e Adem Demaçit si përfaqësues politik i UÇK-së?"

Ju thoni:

"Edhe pse unë s'jam përfshirë në raste në të cilat është bërë përzgjedhja e Adem Demaçit, mendoj se ai duhet ta përdorë autoritetin e tij që të ofrojë mundësi të ndryshme për udhëheqësit politikë, pra, të jetë konstruktiv në themelimin e institucioneve shtetërore kosovare."

Pra, ju thatë sot paradite që këtë intervistë e keni dhënë më 26 gusht *Deutsche Welle*?

PË. Po. Po.

PY. Jua rifreskon kujtesën që ju asokohe mund të keni qenë në dijeni lidhur me mosmarrëveshjet se kush do ta përfaqësonte UÇK-në në negociata dhe që zona e Dukagjinit po mbante një qëndrim që binte ndesh me qëndrimin e mbajtur nga Shtabi i Përgjithshëm?

PË. Intervista ishte direkte edhe unë jam, i kam dhënë qëndrimet e mia që pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pa përfaqësues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk mund të krijohet ekip negociator për paqen në Kosovë. Kjo shihet dhe

nga kjo, nga kjo intervistë e imja.

PY. Në mes të asaj që ju tregova ju thoni se jeni takuar me z. Thaçi më datë 22 apo 23 gusht, kështu është?

PË. Po.

PY. Në Kleçkë?

PË. Në Kleçkë.

PY. A është e saktë se biseda me z. Thaçi ishte e mirësjellshme dhe me respekt të ndërsjellë?

PË. Unë sa kam pa prej sjelljeve të tij, gjithmonë kam pas respekt prej nga Hashim Thaçi. Edhe në Prapaqan me një respekt u sjell për mu, ndaj meje edhe në Kleçkë. Besoj që ka ardh me pa gjendjen time shëndetësore se aty ka ardh komandant Kumanova, sa e di unë, për dhe veç me të kemi bisedu për çështjet e organizimit të mbrojtjes së rajonit se pritej ofensiva aty.

Por edhe pastaj kur jemi taku në Lladrovc, po nuk kam vërejt kurrë që ka ndonjë mendim jo respektues ndaj meje, ndonjë qëndrim.

PY. Jeni takuar me të, thoni më datë 22 a 23 dhe pastaj shohim në ekran se i keni dhënë i keni dhënë një intervistë *Deutsche Welle* më datë 26.

PË. Po.

PY. Pra, a do mund të thoshim që s'ka pasur asgjë në bisedën tuaj me z. Thaçi e cila mund t'ju pengonte ju, t'ju frenonte, si të thuash, të jepnit deklarata publike?

PË. Nuk kisha dhënë një deklaratë të tillë po qe se kisha pas çfarëdo dyshimi ose çfarëdo dije që ka aq shumë mospërputhje ose mospajtime. Unë e kam mendu që këto janë qëndrime të cilat mund të ndodhë që për diçka pajtohemi, për diçka jo, por ndonjë rezervë me pas unë në qëndrimet e mia nuk kam pas kurrë ose ndonjë dyshim që muj me qenë i kritikum ashpër ose i largum nga struktura e UÇK-së. Këto janë mendime të ndryshme.

Që sipas mendimit tim, unë kam mendue që e bëjnë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovë para faktorit edhe kombëtar edhe ndërkombëtar si një ushtri e cila në veten e vetë ka edhe shprehje të mendimeve të ndryshme. Por kundërshtia ndaj forcave okupuese edhe përpjekjet për çlirim, aty nuk kemi dallime. Kam mendu që vetëm unë i ndihmoj do të thotë.

PY. Po. Siç ju pyeta edhe më përpara në fund ju ngritën në detyrë në Shtabin e Përgjithshëm --

PË. Po. Sigurisht, po.

PY. -- në nëntor të 1998? Është e saktë se pas mbylljes së konfliktit në qershor, ju u bëtë këshilltar i z. Thaçi?

PË. Po, saktë.

PY. A mund të na thoni se kur ju caktoi këshilltar, një prej këshilltarëve të tij z. Thaçi?

PË. Kam qenë këshilltar për siguri nga shtatori diku. Nuk e di datën sa, po në shtator edhe deri në nënshkrimin e marrëveshjes për demobilizimin e UÇK-së.

PY. Flisni për shtatorin e 1999-s?

PË. 1999, po.
PY. U ngatërrova pak tani. Po demobilizimi si marrëveshje është nënshkruar në qershor të 1999, mos është pak e ngatërruar kjo?
PË. Jo, jo. Nuk është e ngatërrume. Është nga UÇK kur krijohet TMK-ja. TMK-ja krijohet dikun nëntor, tetor, nëntor.
PY. Po. Pra edhe një herë, kur ka qenë periudha kur ju keni qenë këshilltar pas formimit të TMK-së apo para?
PË. Para. Para se me u formu TMK-ja. Ishte ende UÇK. Para se me u formu TMK-ja.
PY. Marrëdhënia juaj me z. Thaçi asokohe ishte profesionale me respekt të ndërsjellë?
PË. Po. Si kisha mund të jem këshilltar në kabinet të tij po mos të ishte marrëdhënia e mirë edhe nevoja e tij për këshillat e mia profesionale?
GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Misetic, që t'ju kuptoj mirë datat.
Z. Dëshmitar, ju u bëtë këshilltar në shtator të vitit 1999 --
DËSHMITARI: Po.
GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] -- dhe qëndruat këshilltar deri kur saktësisht?
DËSHMITARI: Nuk më kujtohet data e saktë kur është nënshkrue marrëveshja për kalimin nga UÇK në TMK. Saktë vërtetë s'më kujtohet. Po e di që deri atë ditë unë kam qenë

këshilltar.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Z. Maloku, a është e mundshme që mund ta keni ngatërruar pak datën sa i takon fillimit të postit tuaj si këshilltar? Mbase ka qenë më herët se shtatori i vitit 1999?

PË. Unë jam kthy nga shërimi në Mainz të Gjermanisë në Kosovë me familjen time diku më 8 gusht dhe jam vendosur në Prizren. Bislim Zyrapi në atë kohë ka qenë zëvendësministër i mbrojtjes. E tash me data a është fundi i gushtit a fillimi i shtatorit a shtatori. Me të vërtetë kanë kalu 26 vjet po kështu është. Por që kam qenë në kabinet të z. Thaçi, kjo është e vërtetë.

PY. Prokurorit i thatë sot paradite se herën e fundit që e keni parë z. Thaçi gjatë konfliktit ishte në tetor të vitit 1998, kështu?

PË. Po, q'ashtu është. Po.

PY. Dhe sqaruat se i vetmi kontakt me z. Thaçi pas tetorit të 1998 ishte me një telefonatë me të në dhjetor të 1998, kështu?

PË. Po.

PY. Që doemos do të thotë që nuk jeni takuar me z. Thaçi në asnjë vend pranë shtëpisë së bardhë të Divjakës në nëntor të vitit 1998, kështu?

PË. Nuk më kujtohet që e kam pa fizikisht z. Thaçi në Kosovë gjatë asaj kohe.

PY. Gjatë kësaj telefonate të vetme, ju thoni që z. Thaçi ju ka thënë diçka, pas a shumë, se "mjaft më me këto intervista", kështu?

PË. Po.

PY. Por ju thoni se nuk e dini me saktësi se çfarë e kishte shtyrë z. Thaçi t'jua bënte këtë kërkesë, apo jo?

PË. Jo, ishte pas një interviste timen më 28, që u botu më 28 nëntor në gazetën Kosova Sot.

PY. Po, por Prokurorisë i thatë se nuk e dini se çfarë me saktësi në atë intervistë kishte pas --

PË. Jo, nuk e di. Po nuk e kam gjet.

PY. -- që e kishte shty atë?

PË. Nuk e kam gjet atë intervistë për me e studiu prapë.

PY. Gjithsesi, është e vërtetë që ju vazhduat të jepnit intervista edhe pas kësaj telefonate me z. Thaçi, apo jo?

PË. Po, po. Po, sigurisht. Po.

PY. Pra, dukshëm ju nuk e keni ndjekur këtë porosi apo, pra, nuk e keni ndjekur këtë fjali të z. Thaçi si një farë urdhri apo si një farë porosie?

PË. Jo. Unë i kam sjellë këtu të gjitha gati intervistat e mia edhe pas dhjetorit 1999 -- dhjetorit 1998 edhe ato janë prezente besoj se dhe ju i keni ato, do të thotë, unë nuk -- sa herë më kanë thirr gazetarët edhe sa herë mu kanë ofru dhe kanë kërku prononcim prej meje unë pa kurrfarë ngurrimi i kam dhënë qëndrimet e mia pa kurrfarë mendimi që do të kem ndonjë,

mund të ndodhë ndonjë vërejtje. Unë tash me dhënë një intervistë për do çështje të përbashkëta mes meje e jush, muj mos me pas në të gjitha përgjigjet pajtime, mirëpo jo të natyrës që me u prish raportet mes nesh. Pra, kjo ka qenë.

Kurrë nuk e kam hetu gjatë tanë kohës që prononcimet e mia muj me më prish raporte me njerëzit, qoftë ushtarë ose qoftë edhe të strukturave më të larta komanduese brenda UÇK-së. Ka mujt me pas ndonjë vërejtje si ndonjë mospajtim me diçka që e kam thënë, por ato janë të natyrës normale dhe i kam marrë si normale se s'jam ndal askund.

PY. Atëherë të kalojmë në një temë tjetër. Prokurorisë i thatë se gjatë kur keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm kishte mbledhje informuese të përmuajshme midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të zonave operative, apo jo?

PË. Po.

PY. Mbledhja e parë u zhvillua në nëntor të 1998-s?

PË. Jo, dhjetor. Dhjetor, fillim dhjetori. Nuk e di, më duket para 5 dhjetorit, mes 1 dhe 5 dhjetorit.

PY. Pati mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm me komandantët e zonave përpara vajtjes suaj në Shtabin e Përgjithshëm, me aq sa keni dijeni?

PË. Jo.

PY. Tani Prokurorisë i keni thënë se nuk keni dijeni nëse shtabi i Dukagjinit raportonte në Shtabin e Përgjithshëm përpara dhjetorit të vitit 1998, apo jo?

PË. Ashtu është.

PY. Dhe në deklaratën tuaj flisni për dy mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm, një në dhjetor të 1998 dhe një në janar të 1999, apo jo?

PË. Po. Në kohën sa kam qenë unë në drejtorinë operative të Shtabit të Përgjithshëm.

PY. Por ju nuk keni marrë pjesë në asnjërën prej atyre dy mbledhjeve?

PË. Jo, unë nuk isha. Pozita ime nuk ishte e tillë që duhej të merrja pjesë në atë mbledhje. Ishte mbledhja, në atë mbledhje merrke pjesë shefi i shtabit, drejtorët e drejtorive të shtabit edhe komandantët e zonave operative.

PY. Pra, nuk keni informacion se çfarë ndodhte ekzaktësisht gjatë atyre mbledhjeve, apo jo?

PË. E di vetëm në mbledhjen e parë për shkak se në drejtorinë operative procesverbalet dhe çka do që është, çdo gjë që është bë në atë mbledhje është kompletu një raport, është përmbledhë krejt në një raport që pastaj Sali Veseli e ka kontrollu, nënshkru dhe e ka dorëzu shefit të shtabit ose zëvendëskomandantit Krasniqi. Për atë e di përafërsisht që ka ardh ka drejtoria operative, aty janë bë, është bë përpilimi i raportit.

Ndërsa për mbledhjen e dytë nuk e di për shkak se çfarë ka ndodhë, për shkak se unë jam transferu në Zonën Operative të Dukagjinit.

PY. Prokurorisë i thatë - dhe e kam në dokumentin P02090.3, në rreshtin 11 – se në përgjithësi ju nuk e dini nëse Shtabi i Përgjithshëm priste që zonat operative t'i respektonte urdhrat e tij, kështu?

PË. Nuk e kuptova pyetjen, zotni? Nuk po --

PY. Jo, më mirë të lexoj --

PË. Nuk e kam të qartë. Po, po nuk e kam të qartë.

PY. Të lexoj pyetjen që ju bëri Prokurori dhe përgjigjen tuaj

"PY. Shtabi i Përgjithshëm priste që urdhrat e tij të zbatoheshin nga zonat operative, apo jo?"

Dhe ju i jeni përgjigjur:

"Nuk e di. Gjatë atyre dy muajve në një farë mënyre ja kemi dalë që të organizojmë diçka, nën vartësinë time. Ishte dimër dhe ... kishte më pak incidente konflikti, më pak përleshje dhe komunikimi ishte më i mirë.

"Tani se çka ka ndodhë më vonë, nuk e di. Për shembull, në fund të prillit Zona Operative e Dukagjinit ishte e shpartalluar plotësisht nga ofensiva dhe unë lëvizja sa në një vend në një tjetër, pra, nga Crna Gora në Roxhaj në Rugovë. Dhe kështu që unë nuk duhet që të shkoja prapë në Dukagjin. Pra, ishte një shpërbërje e plotë dhe linjat e komunikimit ishin të prishura, po kështu edhe zinxhiri i komandimit."

A është e saktë?

PY. Por në prill kur ndodhi pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, atëherë u bë luftë totale e forcave serbe ndaj

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullatës civile dhe normalisht që linjat e komunikimit atëherë mes zonave operative edhe Shtabit të Përgjithshëm kanë qenë shumë dëmtuara apo të kufizuara.

PY. Ta them ndryshe. TPNJ-së, siç e shikojmë në dokumentin P02087.3, në faqen 14, i keni thënë:

"E kam deklaru dhe publikisht nëpër debate në televizor, në Top Channel, në prill të këtij viti. Dhe e konfirmoj dhe sot atë që kam thënë që kam thënë që shtabi kryesor i UÇK-së nuk kishte kontroll mbi UÇK-në. Ata kanë folur në emër të UÇK-së, ama kontroll mbi UÇK-në nuk kanë pasur se ishte e pamundur të kishin kontroll mbi të sepse pati një rritje të madhe të numrit të ushtarëve."

Ju kujtohet që i keni thënë kështu TPNJ-së?

PË. Sigurisht që po. Unë dua t'ju sqaroj këtu se kur po flisni me komunikim i Shtabit të Përgjithshëm. Shtabi i Përgjithshëm nuk ka rol komandues në asnjë ushtri. Shtabi i Përgjithshëm ka rol drejtues, drejtues. Komunikimin me zona operative e ka bërë drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm, jo Shtabi i Përgjithshëm, drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm. Dhe vendimi që të jetë komunikimi ditor mes zonave operative edhe drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm është marrë në mbledhjen e parë në dhjetor me komandantët e zonave operative.

Drejtoria operative e ka pas për detyrë komunikimin me

zona operative. Ato komunikime, ato njoftime që i merrshim prej zonave operative i transferonim në dhomën operative. U ngrit dhoma operative, harta topografike e Kosovës. Informatat që i merrshim për lëvizjet e trupave serbe ose për zgjerimet ose ngushtimet e territoreve të zonave, i vendosnim në atë hartë topografike. Në mur ka qenë tabela ku shënoheshin humbjet ditore, raportet ditore të humbjeve të armikut të pretenduara të armikut që na vinin si informacione nga zonat operative, në njerëz, në teknikë edhe humbjet e ushtarëve tanë në njerëz edhe në teknikë.

Këto informacione i merrshim ne, për me e dit saktë se çka po ndodhë me zonat operative edhe me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Pra, ky ishte një komunikimi i parë të cilin drejtoria operative nis me e krijue linjën e komunikimit me zona operative për këto informacione.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një pushin dhjetë minuta, Dëshmitar, tani. Mund të dilni nga salla ku do t'ju shoqërojë Shoqëruesja e sallës.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë ndërprerjen e seancës këtu për dhjetë minuta.

--- Seanca ndërpritet në orën 15.32

--- Seanca rifillon në orën 15.42

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z. Misetic

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Maloku, do qëndrojmë në periudhën mes nëntorit të '98-s dhe marsit të '99-s. Emërimet në zonat operative bëheshin vetë brenda nga zonat, apo brenda për brenda zonave?

PË. Zona -- gjithmonë, na jena mundu me kriju rregull siç respektohet nëpër ushtri të rregullta. Pra, gjithmonë pozicioni i dytë e emnon atë që është dy plozione ma poshtë. Për shembull, zona operative, po e zëmë e Llapit e propozon një person për komandant brigade dhe shefi i shtabit e emënon, pra, pozicioni i dytë mbi të e emnon, pra. Ndërsa komandant i zonës operative kur emërohet, atëherë për të plotësu atë rregull procedural është mendu në dhjetor që z. Jakup Krasniqi me e pas edhe rolin e një zëvendëskomandanti i cili i emnon apo i shkarkon komandantët e zonave operative. Se është dasht me propozim të shefit të shtabit të emënohet apo zëvendësohet komandanti i zonës operative apo lëvizja e oficerëve siç është bërë lëvizja e ime nga Shtabi i Përgjithshëm në zonën operative.

Kështu është -- kështu jemi mundu me i kriju pasi që nuk kishim, nuk kishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës në kuadër të institucionet nuk ishte ngrit nga poshtë lartë, ishte vullnetare dhe duhej gjet një mënyrë sesi me iu përmbajt

emënimeve edhe shkarkime. Kjo është ajo që une e kam kuptu këto pozicionime në Shtabin e Përgjithshëm.

PY. Do t'ju lexoj diçka që i keni thënë ZPS-së javën e shkuar. Është e reflektuar në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 8. Thuhet që:

"Keni riformuar Brigadën 134, edhe ishin vetë personat që kishit ju nga brigada e Junikut, kjo ishte një brigadë që ishte -- u shpërbë kur ju u plagosët".

PË. Po.

PY. Dhe thuhet:

"Në nëntor të '98-s shtabi i kësaj brigade u vendos në Gllogjan dhe filloi të organizohej atje. Në shkurt të '99-s, 8 -- kishte vetëm 8 ushtarë dhe më pas u bënë 200 ushtarë sepse u kthyen edhe ushtarë që kishin qenë në Shqipëri. Ju ndihmuat për ristrukturimin e gjithë Brigadës 134. Propozuat Ismet Ahmetin --

PË. Po.

PY. -- që kishte qenë në Smolicë si komandant brigade. Ramush Haradinaj ishte personi i vetëm që mund ta emëronte Ahmetin në atë pozitë dhe ai e bëri këtë gjë."

Pyetje ime është kjo: Pse ishte Ramush Haradinaj personi i vetëm që mund ta emëronte komandantin e Brigadës 134?

PË. Mendoj që Zona Operative e Dukagjinit nuk e ka respektu, nuk iu ka përmbajt shumë rregullit. Më kujtohet te Zona Operative e Llapit gjithmonë propozojshin për komandant

brigade dhe shefi i shtabit e emërojke. Ndërsa në Zonën Operative të Dukagjinit i zgjedhshin rajoni i brigadës ku zhvillohej brigada. E zgjedhshin një komandant, ja propozojshin Ramushit, komandantit të zonës dhe ai e emnojke. Pra, këtë rregull e ka pas, ky rregull ka funksionuar në Zonën Operative të Dukagjinit.

Që thatë në nëntor është ardh, po është kthy në nëntor brigada e Junikut në Gllogjak. Është emnu komandant brigade Agron Rama. Është vra Agron Rama në fund të janarit '99-s edhe një numër tjetër i ushtarëve të brigadës. Të tjerët kanë shku në Shqipëri me i bart të plagosurit se nuk kishim trajtim sekondar edhe terciar në spitale ushtarake më në Zonën Operative të Dukagjinit, pra duhej bart të plagosurit.

Ata u rikthyen në shkurt dhe unë fillova ringritjen prapë të asaj brigade. Dhe propozova Ismet Ahmetin me qenë komandant brigade. Kjo është ajo.

Pra, nuk i kanë respektu të gjithë komandantët e zonave rregullat të cilat kanë mendu shefi i shtabit me i instalu në emënimet edhe shkarkimet e komandantëve të brigadave.

Komandantët e batalioneve nuk janë emnue me urdhna. Pra, nuk ka pas. Ka një -- vetëm të komandantëve të brigadave edhe të komandantëve të zonave operative.

PY. Flasim për një temë tjetër tani. Më 9 qershor të '99-s u nënshkrua Marrëveshja e Kumanovës. Saktë?

PË. Po.

PY. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje, veprimtaritë tuaja u ndërprenë, reshtën, apo jo?

PË. Po.

PY. Dhe ju thatë më 12 qershor të '99-s keni qenë në Kukës dhe keni parë një deklaratë të Gjeneralit Jackson ku tha se në Kosovë kishte hyrë KFOR-i.

PË. Po.

PY. I thatë ZPS-së se asokohe ju nuk kishit më asnjë përgjegjësi. Saktë?

PË. Po.

PY. Arsyeja pse nuk kishit më përgjegjësi ishte se s'kishte më luftime, apo jo?

PË. Po, q'ashtu është.

PY. A është e saktë që forcat serbe ishin tërhequr nga Kosova deri nga 20 qershori i '99-s?

PË. Unë nuk e di saktë planin, po ishte një plan me Marrëveshjen e Kumanovës ishte edhe plani si të tërhiqen forcat ushtarake policore serbe nga Kosovë, dhe ato janë tërheq sipas atij planit që ka dalë nga Marrëveshja e Kumanovës. Mendoj që unë me dikund 17 ose 16 qershor jam hy jam ardh në Gjakovë dhe aty s'ka pas forca policore ushtarake serbe.

PY. Tani dua t'ju tregoj një dokument. Të shohim a përputhet me përvojën tuaj në qershor '99-s.

Z. MISETIC: [Përkthim] Vendosim në ekran materialin

DHT095947 deri në DHT05050 në faqen DHT05048.

PY. Kjo që po ju tregoj është një rregullore e UNMIK-ut 2000/66 lidhur me benefacion -- mbi benefecionet e invalidëve nga lufta në Kosovë. Shohim pikën 1.5. Thuhet:

"Sipas kësaj rregullore, konflikti i armatosur në Kosovë vlerësohet të ketë ndodhur midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999."

E patë? Pika 1.5

PË. Po. E pashë, po.

PY. A përputhet kjo dhe me përvojën tuaj në Kosovë, pra, që konflikti dhe luftimet në Kosovë kishin përfunduar deri më 20 qershor '99?

PË. Kanë përfundu deri atëherë. Unë tash me data mbas 25 vjetëve është pak vështirë me e ditë, por, po

Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim DHT050 [Sipas përkthimit], DHT0504, ju lutem. Kjo është një rregullore tjetër e UNMIK-ut. Shohim faqen DHT05031 në anglisht dhe në shqip. Shohim pikën 3.1. Fjalia e fundit ku thuhet po ashtu që "konflikti i armatosur ka ndodhur në periudhën mes -- në periudhën, më falni, ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999."

PË. Po.

PY. A përputhet kjo pra, dhe me --

PË. Po.

PY. -- kujtesën tuaj --

PË. Po.

PY. -- që luftimet përfunduan deri më 20 qershor?

PË. Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj pranimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut si pjesë e provave gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtim?

Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim për këto dy rregullore të UNMIK-ut.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali DHT047 deri në DHT05050 në faqen DHT05048 pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i parë që ka numrin DHT05047 deri në DHT05050 dhe përkthimi në shqip do të marrë numrin e provës 1D00254. Dhe klasifikimin e kanë publik.

Dokumenti i dytë, DHT --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'kam marrë ende vendim për dokumentin e dytë.

[Mikrofoni çaktivizuar].

Dokumenti DHT05030 deri në DHT05042 në faqen DHT05031 pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumentet marrin numrat e provës 1D00255 dhe klasifikimi është publik. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Z. Maloku, dua t'ju bëj disa -- dua të diskutojmë disa nga pyetjet që ju kanë bërë gjatë intervistës me ZPS-në.

Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja që të shfaqej në ekran prova materiale me numrin P02090.6, është faqja 15 në anglisht, rreshti. Edhe shqipja me të njëjtin numër.

PY. Ju është bërë pyetje këtu në rreshtin 1. Jo, më falni, nuk është faqja e duhur.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faqja 15 duhet të jetë. Faqja 15, rreshti 1. Po.

PY. Ju është bërë pyetje këtu:

"UÇK-ja nuk donte një Kosovë multi-etnike, saktë?"

Përgjigja juaj:

"Jo, ne ramë dakord për një Kosovë multi-etnike edhe në traktatin e Rambujesë që asnjë parti nuk mundej edhe sipas ligjit që të regjistrohej në Kosovë nëse nuk ishin për Kosovën multi-etnike. Nuk është e mundur as të regjistrohet një parti sipas vetë ligjit. Është e mundur të regjistrohen parti, por jo parti që janë kundër një Kosove multi-etnike".

A është e vërtetë që ju jeni -- e keni kundërshtuar pretendimin e Prokurorit kur ju tha që UÇK-ja ka qenë kundër një Kosove multi-etnike? Pra ju nuk u pajtuat me këtë propozim të Prokurorit, saktë?

PË. Po është jo këtu. Besoj që po.

PY. A është e vërtetë që në intervistë -- në intervistën që i keni dhënë revistës *Mladina* ju keni thënë në dokumentin 126693-126697-ET, faqja 126697, ju bënë pyetje:

"Duket sikur serbët në Kosovë" --

Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem ta vendosim në ekran.

Z. MISETIC: [Përkthim] Patjetër. Mund ta vendosim në ekran atëherë. Është në sllovenisht gjuha origjinale, apo jo?

DËSHMITARI: Po.

Z. MISETIC: [Përkthim] Atëherë ju lutem vendosni në ekran Shënimin Përgatitor 2, në numrin e provës P126.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë çfarë gjuhësh do të vendosim në ekran? Do të vendosim sllovenishten dhe anglishten?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po, sllovenishten dhe anglishten në ekran. Anglishtja ka numrin 126693 deri në 126697-ET në faqen 126697.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Na jepni dhe numrin, ju lutem.

Z. MISETIC: [Përkthim] Shënimin Përgatitor numër 2, 126650-126700.

Z. PACE: [Përkthim] Në fakt unë tani e gjeta materialin dhe e kam përpara, kështu që për mua nuk është më nevoja ta shfaqim në ekran sepse e gjeta.

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, sidoqoftë tani e vendosim. 126697. Po. Diku në mes ose poshtë në kolonën e majtë. Mendoj që anglishtja në fakt është gabim. Dhe duhet faqja 8 e PDF-së. Dhe një faqe tjetër. Lart. Po, këtu. Këtu.

PY. "Duket sikur serbët në Kosovë shumë shpejt do të jenë në të njëjtin pozicion si serbët në Knin Krajina".

Përgjigja juaj është kjo:

"Do të përpiqemi në çdo mënyrë të mundshme që serbët e Kosovës të mos jenë në të njëjtin pozicion si ata që janë në Knin Krajina. Për gjatë gjithë viteve të luftës ne kemi parë sulme mbi shqiptarët, por pavarësisht kësaj, ne nuk kemi hyrë në zona ku është popullata e kombinuar, e miksuar. Sidoqoftë ne do të përpiqemi - dhe ky është dhe synimi i shtabit tonë kryesor, qendror - ne të sigurojmë që serbët e Kosovë të mos largohen nga Kosova. Ne nuk jemi vetëm Ushtria Çlirimtare Shqiptare e Kosovës, por jemi dhe -- ne nuk jemi - më falni - ne jemi vetëm UÇK-ja."

Pra, këtë e keni thënë në shkurt të '99-s. Pra, a ka qenë edhe mendimi juaj që një ndër objektivat kryesore të Shtabit Qendror ose Shtabit të Përgjithshëm ishte të garantonte që popullata serbe e Kosovës të mos largohej nga Kosova?

PË. Po, ky ka qenë synim, synim edhe orientim politik i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo intervistë është dhënë në kohën kur delegacioni jonë ishte në Rambuje dhe kjo është e saktë çka unë e kam thon këtu. Dhe nuk ishte -- ishte, deklaratë e bazume në qëndrimet që i kishte edhe Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkoj pranimin e kësaj interviste si provë gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

[Përkthim] Gjithë -- të gjitha faqet?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po, por për plotësi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 126650 deri në 126770 --

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, ky është shënimi përgatitor. Unë dua këtë përkthimin e artikullit.

Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]. [Përkthim] Më korrigjoni nëse s'e kam kuptuar atëherë mirë numrin. Bëhet fjalë për materialin me numër 1266697?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po, për këtë bëhet fjalë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja 8 e PDF-së?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Nëse e kam mbajtur shënim saktë, është materiali 126693-126697-ET edhe sllovenishtja është 126697 dhe është pjesë e Shënimit Përgatitor numër 2.

Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kështu është.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin 1D00256, klasifikimi është konfidencial.

Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jenë publike.

Z. PACE: [Përkthim] Po nëse doni të përfshini dhe shqipen duhet të shënoni numrin 93 dhe 97 që s'e kundërshtojmë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Për ne e rëndësishme këtu

ishte sllovenishtja si origjinale, por nuk ka asnjë problem, mund të shtojmë edhe shqipen.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë edhe një herë. Në këtë rast ERN-ja është 126693-126697-ET edhe shqipja ka numrin 126693-126697. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. MISETIC: [Përkthim] Herën tjetër do ta vë veshin më shumë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. MISETIC: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, pyetja tjetër që ju ka bërë Prokurori të cilën dua ta trajtojmë bashkë është --

Z. MISETIC: [Përkthim] Në provën me numër P02090.6, faqja 18, në fillim të rreshtit 23.

Ju pyesin:

"Dhe udhëheqja e UÇK-së, ata deshën ta drejtonin Kosovën pasi u largua Serbia, apo jo?"

Ju i jeni përgjigjur:

"Jo. Qëllimi i UÇK-së ishte të lironte, ta lironte atë zonë, ta çlironte atë zonë dhe më pas të formoheshin partitë politike që do të drejtonin Kosovën. Kjo ishte në përputhje prandaj UÇK-ja nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë dhe ne ramë darkod për çarmatosjen dhe për ardhjen e UNMIK-ut dhe të NATO-s."

Pra, edhe sipas jush asnjëherë nuk ka qenë objektivi i

UÇK-së, i udhëheqjes së UÇK-së - më falni - që të drejtonte Kosovën pas konfliktit, saktë?

PË. Saktë.

PY. Pyetje e radhës që ju bën Prokurori është kjo.

"Po çfarë ndodhi është që në fakt disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të Kosovës ishin përgjegjës për Kosovën si shtet, apo jo?"

Ju jeni përgjigjur:

"Po, sepse sipas Marrëveshjes së Rambujesë, ky ishte si rezultat i një marrëveshjeje me komunitetin ndërkombëtar që UÇK-ja do të çarmatosej dhe do të transformohej në një parti politike. Ky ishte rezultati i një marrëveshje ndërkombëtare. Ne e respektuam këtë marrëveshje që ta çarmatosnim UÇK-në dhe të krijonim një parti politike."

Pra, mënyra si e keni kuptuar ju, komuniteti ndërkombëtar po inkurajonte UÇK-në të transformohej nga një formacion ushtarak në një forcë politike. Kështu e keni kuptuar?

PË. Sa kujtoj unë marrëveshja ka qenë kështu në Rambuje, por shumë parti politike u krijuan pas luftës me pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për shembull, unë me Bislim Zyrapin, Ekrem Rexhën, Drinin, kishim krijuam Partinë Qendra Liberale e Kosovës. Drejtoria Politike, Hashim Thaçi, që ishte me të tjerë, me disa të tjerë e formuan Partinë Demokratike të Kosovës se në fillim ishte Partia për Prosperitet Demokratik. Ramush Haradinaj, që ishte komandant zone me Ahmet Isufin,

ishte po ashtu komandant zone, e formun Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Pra, nuk ishte një parti politike që e kishte pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishin shumë parti politike. Edhe LDK-ja kishte brenda partisë, pra pjesëtarë ose oficerë që ishin, edhe i kemi edhe sot deputetë, Anton Çuni, për shembull, që ka qenë komandant Koshara, ai është deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Por ne u transformuam, UÇK-ja u transformua nga Ushtri Çlirimtare e Kosovës në -- disa shkun në polici, disa shkun në TMK dhe disa të tjerë normalisht nëpër parti politike.

PY. Ju, siç e thamë, ishit këshilltar i z. Thaçi për një farë periudhë në vitin '99.

PË. Po.

PY. A ju kujtohet që z. Thaçi, pra, në bazë të përgjigjes që i dhatë ju Prokurorisë, a ju kujtohet që z. Thaçi ju ka informuar se ishte Madeleine Albright në Rambuje ajo që i tha z. Thaçi, pra që për ta konvertuar UÇK-në në një forcë politike? Ju kujtohet që ju ka thënë kur ishit këshilltar i tij?

PË. Po. Kanë shkru shumë gazeta për Rambujenë. Ka qenë temë që është përcjellë në media. Unë nuk e di tash ku kam lexu çka, por Rambujeja është përcjellur, është debatu, dhe pastaj është shkru. Ka pas debate. S'po më kujton që e kam marrë këtë informacion vetëm prej Thaçit.

Z. MISETIC: [Përkthim] T'ju tregoj atë që jua ka treguar

Prokurori nga fundi i pyetjeve të tij që është prova me numër P012103. Ju lutem, faqen në anglisht me numër U002-3117, e njëjta dhe në shqip.

PY. Sërish është një libër që e keni parë disa herë, z. Maloku. Prokurori ju lexoi një pjesë. Unë do ta përfundoj leximin e asaj pjesës dhe t'ju bëj disa pyetje.

Z. MISETIC: [Përkthim] Në pjesën e sipërme -- të poshtme, më falni, të faqes.

PY. Prokurori ju ka lexuar dhe ju ka thënë që:

"Kam arsye për deklaratat dhe pse i kam bërë. Ka tre arsye kryesore që ju kam shtyrë që të bëni deklarata në këto ngjarje dhe situata ushtarake në terren."

Po të shihni se çfarë ka lexuar Prokurori pse ju vijuat të mos ishit i sistematizuar -- i sistemuar, më falni.

"Arsyeja e parë është se teksti i çdo ushtrie i ndalon ushtarakët që të bëjnë, që të japin deklarata lidhur me çështje që kanë të bëjnë me deklaratat ushtarake dhe unë i kam kryer detyrat e mia si oficer duke i bërë këto deklarata.

"Dhe për arsyen e dytë pse unë kam bërë deklarata gjatë luftës. E dua shumë profesionin time dhe i dija ca gjëra.

"Dhe arsyeja e tretë është pse i kam bërë deklaratat sepse doja që të hiqja përgjegjësinë nga vetja për vendimet të cilat e kanë dëmtuar luftën, e kanë dëmtuar edhe ngritjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Doja ta informoja publikun shqiptar, opinionin publik, si opinionin politik ashtu dhe atë

ushtarak se këto nuk ishin vendimet e mia, por ishin vendime të të tjerëve. Si oficer doja që të hiqja çdo faj nga vetja. Dy gabime themelore u bënë asokohe: gabimi që propozimi i Holbrook për zhbllokimin e Grykës së Llapushnikut nuk u mor në konsideratë asokohe, (pra në kohën e qershorit verifikuesit duhej që të vinin në Kosovë për ofensivën e parë dhe kjo nuk ndodhi); dhe gabimi i dytë ishte mosnënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë në Rambuje, e cila na ka kushtuar shtrenjtë, duke qenë se i dha Serbisë katër kohë -- katër javë kohë për t'u përgatitur për ofensivën."

E shihni këtë?

PË. Po.

PY. Këto janë dy gabimet që ju keni renditur.

PË. Po.

PY. Sa i takon të dytit, mosnënshkrimit të Rambujesë, Marrëveshjes së Rambujesë në Rambuje, ju nuk e dini vetë personalisht se çfarë ka ndodhur në fakt në Rambuje dhe përse nuk u nënshkrua, apo jo?

PË. Jo, Ishte një -- u la për -- u prolongu praktikisht vendimi për -- marrëveshja u nënshkru, por u dha pajtimi për t'u nënshkru, por u prolongu për katër javë, për tri-katër javë. Edhe mendoj që ndodhi një rast në Likovc që komandantët e zonave e kundërshtuan Marrëveshjen e Rambujesë dhe delegacioni jonë u detyru me ardh në Kosovë për mu konsultu prapë me komandantë të zonave, sa kujtoj unë.

Edhe unë në intervistën e 2 marsit, kam kërku që delegacioni të kthehet dhe ta nënshkruj dhe s'ka nevojë të vjen në Kosovë. Mendoj që ato katër javë i kanë dhënë Serbisë mundësi për me i kry tri mobilizime me i disloku në Kosovë 45.000 trupa, me i pru 2000 paramilitarë vetëm nga Beogradi, me i lirue 600 të burgosur kriminelë me i kalue të gjitha procedurat, ligjin, kuvendin, marrëveshjet me ta dhe paramilitarë me i pru në Kosovë.

Pra, këtë e kam marrë atëherë, e marr edhe sot si një gabim shumë të madh që o kthy delegacioni nga Rambujeja me presionin e komandantëve të zonave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mendoj që në atë kundërshtim, pra sa jemi njoftu, nuk kanë marrë -- nuk janë pajtue për atë ndryshim tre oficerët. Nuk a pajtu Sali Veseli, Bislim Zyrapi edhe komandanti i zonës operative të Pashtrikut, Ekrem Rexha. Dhe e ndi veten shumë mirë që ata tre oficerë nuk kanë dhanë pajtimin që delegacioni jonë nga Rambujeja të kthehet në Kosovë dhe t'i jepet Serbisë mundësi dhe kohë për t'u përgatitur aq mirë, do të thotë, për ndërhyrjen e NATO-s.

Ky është mendimi im. Këte nuk e kam ndryshu dhe mendoj edhe sot q'ashtu, po. Këto janë dy gabimet të cilat unë i kam identiffiku si ma të mëdha gjatë luftës. Kjo e dyta na ka kushtu shumë. Unë po ju them që deri me 24 mars '99, dikun përafërsisht në Kosovë ka pas 2000, në fund të luftës edhe 13.000. Më falni, po.

PY. Ju kuptova. Faleminderit për sqarimin tani për atë që thatë në libër.

Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti tjetër që do ju tregoj është me numër SITF00265677 deri në 00265678 në faqen SIT00265677. Përkthimi në shqip është DHT05051 deri në DHT05051-AT në faqen 05051.

PY. Kjo që do ju tregoj është një deklaratë publike e lëshuar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës me datë 2 gusht të vitit 1999. Kjo është një deklaratë politike e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

Z. MISETIC: [Përkthim] Në paragrafin numër 4, po të presim edhe përkthimin në shqip që të shfaqet në ekran.

PY. Paragrafi numër 4 thotë:

"Qeveria e Përkohshme e Kosovës shpesh indinjatën për vrasjen e civilëve në Kosovë pavarësisht kombësisë së viktimave. Këto krime janë bërë peng i klauzolave politike që janë lidhur me fatin e UÇK-së dhe policinë e Kosovë. Në rast se do t'i kishim duart e lira për të operuar, QPK-ja", Qeveria e Përkohshme e Kosovës, "dhe policia e UÇK-së do të vepronin me efikasitet në parandalimin e krimit në Kosovë. Qeveria e Përkohshme e Kosovës u bën sërish thirrje qytetarëve të Kosovës që të venë anash armiqësitë dhe t'i drejtohen drejt ndërtimit të Kosovës dhe zgjidhjeve të drejta dhe politike të çështjeve politike".

Tani kjo deklaratë a përputhet me atë për të cilën ju

sapo dëshmuat, se siç e kuptonit ju, UÇK-ja dhe udhëheqësit e saj, përfshirë dhe Hashim Thaçin në veçanti, donin që të ekzistonte një Kosovë multi-etnike.

PË. Ashtu ka qenë orientimi gjithmonë i drejtorisë politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

PY. Faleminderit.

Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, kërkoj që të pranohet ky dokument në provat gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtim?

Z. PACE: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë dokumenti me numër SITF00265677 deri në 00265667 me këtë numër pranohet

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës materiale 1D00257, aktualisht klasifikuar si publike.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Maloku, faleminderit shumë për përgjigjet tuaja. Unë kaq pyetje kisha. Faleminderit.

DËSHMITARI: Faleminderit juve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë mendoj se është më mirë ta ndërpresim këtu seancën për sot sesa thjesht të flisni pesë minuta.

Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Unë mund të them që pyetjet e mia do të jenë më të shkurtra.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Dëshmitar, do të mbarojmë këtu për sot. Do të rikthehemi nesër në orën 9.00. Ekipe të tjera të Mbrojtjes do t'ju bëjnë pyetje nesër. Faleminderit që ishit këtu me ne sot. Mos harroni që të mos flisni me askënd lidhur me dëshminë tuaj këtu me persona jashtë kësaj salle. Nëse dikush jua kërkon këtë, na e bëni me dije. Një mbrëmje të mirë. Faleminderit.

DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Pace.

Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Nëse mundet të dimë se sa do të jetë koha e kundërpyetjeve dhe në bazë të kësaj varet edhe çfarë parashtrimesh do bëj apo jo lidhur me dëshmitarin tjetër kësaj jave.

Z. DIXON: [Përkthim] Fillimisht kisha menduar një orë e gjysëm duke marrë parasysh gjithçka, por, besoj se do të jetë gjysma e kësaj kohe nesër paradite.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë kisha menduar një orë e gjysëm. Besoj se do jetë rreth një orë. Po mbase dhe më duhet dhe një orë e gjysëm, varet nga përgjigjet.

Kam dhe një problem tjetër për të ngritur nëse mundet pas kësaj pike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Edhe unë kam pakësuar kohën

time. Deri tani them, e kam menduar tre orë por mund të jetë dhe tri orë. Por nuk dua që të angazhohem për më pak se tre orë deri tani.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

Z. ROBERTS: [Përkthim] Një çështje të shkurtër lidhur me mocionet e rregullës 155. E para ka të bëjë, i keni kërkuar -- kemi kërkua zgjatje të afatit. Ju keni marrë vendim lidhur me këtë më herët. Kërkojmë një zgjatje të numrit të fjalëve nga 6000 deri në 7000 [Sipas përkthimit] fjalë, duke pasur parasysh natyrën e dëshmitarëve dhe një në veçanti, që nuk do ta përmend tani, na duhen më shumë fjalë se zakonisht.

Tjetra ka të bëjë me F3056, që ka të bëjë me mocionin e rregullës 153/155 që ZPS-ja e ka dorëzuar. Kërkojmë zgjatje të afatit për t'ju përgjigjur kësaj sepse ka të bëjë me një dëshmitar shumë kompleks i cili kërkon më shumë afat, më shumë kohë. Deri tani afati është 4 prill, ne kërkojmë zgjatje të afatit deri më datë 14 prill, në mënyrë që të mos ngrihem disa herë edhe një rritje të numrit të fjalëve të lejuara deri në 8000 fjalë. E kam informuar paraprakisht Prokurorinë. Shpresoj që do të jenë në gjendje që të përgjigjen tani.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Z. PACE: [Përkthim] Ne nuk kemi kundërshtim për asnjë prej këtyre kërkesave.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju miratohen këto kërkesa atëherë.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju falënderojmë shumë.

Z. PACE: [Përkthim] Po në bazë të asaj që dëgjuam, duhet se mund të ndodhë që dëshmia e dëshmitarit nuk do të përfundojë nesër. Megjithatë, kur të vijë momenti do ta zgjidhim. Por, atëherë, duke pasur parasysh rrethanat e dëshmitarit të ardhshëm, përfshirë dhe dëshminë përmes videolidhjes, është e nevojshme që dëshmia e atij dëshmitari të fillojë dhe të përfundojë ditën e enjte këtë javë.

Që do të thotë se dëshmia e këtij dëshmitari, nëse nuk përfundon deri në fund të ditës nesër do të kërkonim që të fillojmë të enjten me dëshmitarin e radhës, përpara përfundimit të dëshmisë së këtij dëshmitari.

Mirëpo, kjo është problem nëse nuk përfundon dëshmia. Nesër do ta duhet të komunikojmë me këtë dëshmitari të shikojmë sa e mundshme është për të, të vazhdojë javën e ardhshme.

Nëse nevojitet që të punohet të premten, sigurisht do të na duhet ta dimë një përgjigje deri atëherë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të fillojmë të shikojmë sesi, sa i gatshëm është që të vazhdojë javën tjetër dhe pastaj do të vendosim tjetër.

Nëse s'ka gjë tjetër bëhet këtu ndërprerja e seancës deri nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

--- Seanca mbyllet në orën 16.26